



Bashkimi Evropian
Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve

KOSOVA 2019

Raporti Përfundimtar

Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare

6 tetor 2019



**Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian
Kosovë* 2019**

Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare – 6 tetor 2019



**MISIONI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE
I BE-së**

KOSOVË* 2019

**ZGJEDHJET E PARAKOHSHME
PARLAMENTARE**

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

*Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe mendimin e GJND për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	PËRMBLEDHJE.....	2
II.	REKOMANDIMET PRIORITARE.....	7
III.	PREZANTIMI I MISIONIT	8
IV.	KONTEKSTI POLITIK	9
V.	IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE TË MËHERSHME TË EU EOM ..	10
VI.	KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR	10
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE.....	14
VIII.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE.....	15
IX.	REGJISTRIMI I VOTUESVE.....	19
X.	AMBIENTI I FUSHATËS	21
XI.	FINANCIMI I FUSHATËS	24
XII.	MEDIAT.....	28
XIII.	PJESËMARRJA E GRAVE.....	34
XIV.	PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	36
XV.	VËZHGIMI NGA SHOQËRIA CIVILE	38
XVI.	VOTIMI DHE NUMËRIMI.....	38
XVII.	AMBIENTI PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE	40
XVIII.	TABELIMI.....	41
XIX.	ZGJIDHJA E KONTESTEVE ZGJEDHORE.....	43
XX.	SHPALLJA E REZULTATEVE	51
XXI.	TABELA E REKOMANDIMEVE	52
	SHTOJCAT I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË CERTIFIKUARA.....	71
	SHTOJCAT II: SHKURTESAT	73
	SHTOJCAT III: MONITORIMI I MEDIAVE	75

Ky raport përmban gjetjet e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së (EU EOM) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019. EU EOM është mision i pavarur nga institucionet e Bashkimit Evropian, dhe për këtë arsye ky raport nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

I. PËRMBLEDHJE

Zgjedhjet e 6 tetorit ishin zgjedhjet e katërta parlamentare që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Që të gjitha u mbajtën para kohe. Fushata ishte e gjallë dhe konkurruese duke i lejuar garuesve të bëjnë fushatë lirshëm në pjesën më të madhe të Kosovës. Pati mungesë të konkurrencës në trevat e banuara me serbë të Kosovës dhe ambienti i fushatës u cenua nga frikësimi, duke vënë në shënjestër kandidatët dhe përkrahësit që nuk ishin rreshtuar me Srpska Lista. Keqpërdorimi i resurseve publike dhe mungesa e transparencës rreth financimit të fushatës rezultuan në një fushëlojë të pabarabartë në të gjithë Kosovën. Procesi i zgjedhjeve para ditës së zgjedhjeve ishte i administruar mirë dhe transparent. Dita e zgjedhjeve ishte e rregullt, dhe vëzhguesit e EU EOM e vlerësuan pozitivisht votimin dhe në një masë më të vogël edhe numërimin. Rezultatet preliminare të publikuara pas ditës së zgjedhjeve përgjithësisht u besuan nga subjektet politike, mirëpo besueshmëria e procesit të numërimit dhe tabelimit pas ditës pas zgjedhjeve u prek negativisht nga mungesa e marrjes së vendimeve me kohë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), trajtimi joefikas i ankesave nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe vendimet e diskutueshme nga gjykata. Këto patën ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve dhe vonuan ndjeshëm certifikimin e tyre. Përsëritja e problemeve sistemike në procesin zgjedhor, të cilat ishin identifikuar edhe nga misionet e mëparshme të vëzhgimit, duhet të adresohen urgjentisht si prioritet pas formimit të qeverisë së re, në mënyrë që ta sjellin Kosovën në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

- Korniza ligjore zgjedhore mbetet e njëjtë si në zgjedhjet e vitit 2017, meqë nuk ka pasur reforma. Mangësitë e identikuara në **kornizën ligjore** përfshijnë dispozitat për thirrjen e zgjedhjeve të parakohshme me paralajmërim jashtëzakonisht të shkurtër dhe që i lejojnë KQZ-së t'i shkurtojë afatet, përfshirë kohëzgjatjen e periudhës zyrtare për fushatë zgjedhore, duke rritur kështu riskun e komprometimit të të drejtave zgjedhore. Afatet e tilla të kufizuara kohore nuk garantojnë përgatitje të duhura zgjedhore, përfshirë regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, kontrollin publik të listës së votuesve dhe kundërshtimet e mundshme të listave të kandidatëve. Aspekte të rëndësishme të procesit janë të rregulluara me legjislacionin sekondar, gjegjësisht Rregulloret e KQZ-së. Kjo e kombinuar me mospërputhjet dhe paqartësitë e bën procesin të cënueshëm nga ndryshimet e minutës së fundit duke minuar sigurinë ligjore.
- Të 25 subjektet politike që aplikuan për **regjistrim për pjesëmarrje në zgjedhje** u certifikuan. Më pas, KQZ gjithashtu certifikoi 25 listat e kandidatëve me 1,067 kandidatë, duke përfshirë 724 burra dhe 343 gra. Të gjitha listat e kandidatëve me më shumë se dy kandidatë respektuan kuotën e detyrueshme gjinore prej 30 për qind. Nuk ka kufizime të paarsyeshme në certifikimin e subjekteve politike ose të pranueshmërisë së kandidatëve dhe në përgjithësi, procesi i certifikimit ishte gjithëpërfshirës, pa ndonjë polemikë të rëndësishme.
- Kosova ka sistem pasiv për **regjistrim të votuesve**, ku lista preliminare dhe përfundimtare e votuesve përpilohet nga KQZ bazuar në ekstraktin e të dhënave që e siguron Agjencia e Regjistrimit Civil. Lista përfundimtare e votuesve u certifikua nga KQZ më 19 shtator dhe përfshiu 1,937,868 votues. Saktësia dhe besueshmëria e listës së votuesve është problem i

kahmotshëm për zgjedhjet në Kosovë. Kosova ka më shumë votues të regjistruar sesa popullsia e vlerësuar rezidente. Kjo anomali shpjegohet pjesërisht me faktin se pjesa dërrmuese e diasporës kosovare u përjashtuan nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011, ndonëse ata mbeten të regjistruar në mënyrë të ligjshme në regjistrin civil. Tutje, lista e votuesve përfshin shumë persona që kanë ndërruar jetë meqë nuk ekziston sistemi efektiv për heqjen sistematike të tyre nga lista.

- **Administrata zgjedhore** në të gjitha nivelet funksionoi në mënyrë transparente gjatë gjithë procesit zgjedhor. Mekanizmi ekzistues i emërimeve për të tre nivelet e organeve të menaxhimit të zgjedhjeve ofroi përfshirje domethënëse të subjekteve politike përkatëse, duke përfshirë ato që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë. Mbledhjet e KQZ-së ishin të hapura për publikun dhe vendimet në përgjithësi u publikuan në uebsajtin e KQZ-së. Vendimet zakonisht u morën me konsensus, megjithatë, në disa raste nuk u arrit konsensusi dhe ishte e nevojshme të zbatohet votimi me shumicë të thjeshtë. Këto përfshijnë vendimet për përbërjen në KKZ-ve, caktimin e pozitave të kryesuesve në KVV dhe dokumentet e identifikimit të lejuara për verifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve.
- Në disa raste, KQZ me qëllim iu shmang përgjegjësisë për të marrë vendime dhe lejoi që Sekretariati i KQZ-së të vendosë për disa aspekte të rëndësishme dhe politikisht të ndjeshme të procesit. Këto përfshijnë pranimin e fletëvotimeve të kontestuara të votimit jashtë Kosovës të dërguara me postë nga Serbia dhe pranimin e fletëvotimeve të dërguara me postë që arritën pas afatit ligjor të 5 tetorit. Kjo shkaktoi presion politik të pavend mbi Sekretariatit e KQZ-së.
- Ka mungesë të qartësisë në ligjin mbi **dokumentet e identifikimit që kërkohen** për të vërtetuar identitetin e votuesve në ditën e zgjedhjeve. KQZ e sqaroi këtë çështje më 9 shtator duke adoptuar udhëzim administrativ sipas të cilit mund të pranohen vetëm dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Kosova. Ky vendim u kundërshtua dhe u ankimua pa sukses nga Srpska Lista. KQZ miratoi udhëzimin 26 ditë para ditës së zgjedhjeve, duke siguruar kështu kohë të arsyeshme për ata që nuk kishin dokument të vlefshëm identifikimi të Kosovës që të pajisen me një të tillë.
- Përkundër kornizës kohore të shkurtër prej 41 ditësh, të gjitha **përgatitjet zgjedhore** përfunduan me kohë dhe zgjedhjet ishin të përgatitura mirë teknikisht. Megjithatë, pati një përjashtim të dukshëm, ku formularët e rezultateve nga vendvotimi dhe formularët e përputhjes së rezultateve përmbanin gabime shtypi. Për shkak të mungesës së kontrollit të cilësisë, Sekretariati i KQZ-së nuk e zbuloi këtë gabim shtypi përpara ditës së zgjedhjeve, e si rezultat më shumë se 450 formularë të rezultateve u plotësuan gabimisht dhe ishte e nevojshme të rinumërohen vendvotimet përkatëse.
- Ekziston mungesë e masave mbrojtëse kundër identifikimit të rremë në sistemin e **votimit me postë jashtë Kosovës** dhe disa palë të interesuara shprehën shqetësime për besueshmërinë e procesit. Votuesit mund të aplikojnë në formë elektronike duke bashkëngjitur vetëm një skanim të dokumentit personal të identifikimit dhe fletëvotimet nuk ishte e nevojshme të dërgohen me postë në adresat e votuesve jashtë vendit, meqë ato mund të shkarkoheshin nga uebsajti i KQZ-së. Regjistrimi dhe votimi i votuesve jashtë Kosovës u ndikuan negativisht nga korniza kohore e ngjeshur. Votuesit kishin vetëm 12 ditë për të aplikuar për regjistrim në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe për shkak se KQZ-ja nuk

ishte në gjendje t'i shqyrtonte me kohë të gjitha aplikimet, lista e votuesve nuk ishte në dispozicion për kontroll publik para se të fillonte votimi. Një numër i madh i fletëvotimeve përmes postës mbërritën pas afatit ligjor.

- **Liria e fushatës** u respektua në një fushatë të gjallë dhe konkurruese në pjesën më të madhe të Kosovës. Periudha zyrtare e fushatës u kufizua nga KQZ në vetëm 10 ditë krahasuar me 30 ditë për zgjedhje të rregullta. Megjithatë, disa nga partitë më të mëdha filluan fushatën disa javë para fillimit zyrtar të periudhës së fushatës. Një varg tubimesh intensive u mbajtën nga të gjitha subjektet kryesore politike shqiptare të Kosovës. Temat kryesore të fushatës ishin pretendimet e korrupsionit dhe nepotizmit, dhe marrëdhëniet e ardhshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Partitë më të mëdha përqendruan fushatat e tyre në kandidatët e tyre për pozitën e kryeministrit, dhe pati fare pak programe thelbësore të botuara.
- Në disa raste pati keqpërdorim të **resurseve qeveritare** në nivel qendror dhe lokal në përpjekje për të arritur avantazh politik. Ka pretendime se u ofruan ngritje në detyrë në sektorin publik, zgjatje të kontratave të përkohshme ose pozita të reja, për mbështetje nga punonjësit dhe familjet e tyre. Në mënyrë të ngjashme, ndërmarrjet publike të energjisë elektrike dhe minierave shpallën një numër të madh të konkurseve të reja të punës pak para zgjedhjeve. Disa komuna promovuan projektet e tyre të infrastrukturës lokale për të fituar mbështetje për kandidatët e tyre në Kuvend.
- Kishte mungesë të konkurrencës në **fushatën në trevat me shumicë serbe**. Srpska Lista u mbështet theksueshëm nga qeveria e Serbisë që kishte për synim de-legjitimimin e partive tjera të serbëve të Kosovës. Këto parti patën vështirësi të zhvillojnë fushatë efektive në të gjitha komunat e Kosovës me shumicë serbe, pjesërisht për shkak të mungesës së fondeve dhe pjesërisht për shkak të pretendimeve për frikësime. Kishte raste të shumta të dokumentuara të anëtarëve të familjeve të kandidatëve nga opozita, dhe votuesve në përgjithësi, që ishin përballur me kërcënime për largim nga puna ose pezullim nga pozitat e financuara nga qeveria e Serbisë ose nga pozitat komunale. Megjithatë, u shënuan pak raste të raportimit të kanosjes fizike. Liritë themelore të zgjedhjes dhe shprehjes në komunitetin serb të Kosovës as nuk u respektuan sa duhet nga partia udhëheqëse, as nuk u mbrojtën plotësisht nga autoritetet dhe institucionet.
- Ligji parashikon kuotë **gjinore** prej minimum 30 për qind si për listat e kandidatëve ashtu edhe për ndarjen e ulëseve në Kuvend. Kërkesa sipas kuotës u respektua në të gjitha listat e kandidatëve të subjekteve politike. Gratë mbeten të nën-përfaqësuar brenda partive politike dhe administratës zgjedhore, veçanërisht në nivelet më të ulëta, dhe aktualisht nuk ka masa të diskriminimit pozitiv që kanë për qëllim forcimin e pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor. Dispozitat ligjore mbi barazinë gjinore nuk janë integruar sa duhet brenda ligjeve të ndryshme duke shkaktuar pasiguri lidhur me zbatimin e tyre të rregullt.
- Korniza rregullative nuk siguron transparencë, integritet dhe llogaridhënie të **financimit të partive dhe fushatave**. Transparenca e financave të fushatës u zvogëluar më tej nga mungesa e implementimit të kërkesave ligjore. Gjegjësisht, KQZ-ja dhe disa parti kufizuan raportimin vetëm në shpenzimet e bëra gjatë dhjetë ditëve të fushatës zyrtare. Për më tepër, auditimi dhe deklarimi i raporteve financiare të fushatës nuk do të bëhet para qershorit 2020 dhe auditimi nuk përfshin identifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të paraportuara. Shumë bashkëbisedues të EU EOM shprehën shqetësime lidhur me interesat e ndërthurura

politike dhe financiare që i bëjnë partitë në pushtet llogaridhënese ndaj donatorëve të pasur dhe rezultojnë në keqpërdorim të buxhetit për prokurimin publik.

- **Mediat** përfitojnë nga korniza e shëndoshë ligjore për mbrojtjen e lirive të mediave dhe ishin në gjendje që t'i mbulojnë lirshëm zgjedhjet. Megjithatë, nuk ka masa mbrojtëse ligjore të mjaftueshme që mbrojnë pavarësinë e transmetuesit publik. Rregullimi përndryshe adekuat i mediave për fushatën zgjedhore u dobësua nga një boshllëk që i lejoi partive politike të blinin kohë të pakufizuar të mbulimit me pagesë. Pati mungesë të mbikëqyrjes efikase dhe efektive nga Komisioni i Pavarur i Mediave, organi rregullues i mediave audio-vizive, i cili nuk sanksionoi ose korrigjoi asnjë shkelje të mediave gjatë fushatës zgjedhore.
- **Mediat dhe rrjetet sociale** i mundësuan votuesve qasje në informacion mbi pikëpamjet e ndryshme politike. Gjatë fushatës zgjedhore dhjetëditore, transmetuesi publik, RTK, ofroi mbulim kryesisht të ekuilibruar të garuesve në kanalet e veta të transmetimit, ndërsa tregoi mbulim të njëanshëm në uebsajtin e lajmeve dhe faqen në Facebook në favor të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), parti në pushtet që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Me gjithë mbulimin mjaft të ekuilibruar të lajmeve, mbulimi i përgjithshëm i zgjedhjeve nga mediat audio-vizive private u karakterizua me debate zgjedhore gjithëpërfshirëse, por jo shumë informuese, të cilat nuk kontribuan shumë për të informuar votuesit për programet e ndryshme partiake. Mbulimi i zgjedhjeve u dëmtua gjithashtu nga përdorimi i gjerë i përmbajtjes me pagesë nga subjektet politike, nga e cila përfituan partitë më të pasura duke cenuar fushë-lojën e barabartë. Mediat online dhe platformat sociale ofruan përmbajtje dhe reklama politike me pagesë pa siguruar transparencë dhe llogaridhënie të plotë.
- **Dita e zgjedhjeve** ishte e rregullt dhe e qetë, dhe vëzhguesit e EU EOM nuk raportuan ndonjë incident madhor. EU EOM dërgoi 108 vëzhgues në terren të cilët vëzhguan procedurat e hapjes, votimit, mbylljes dhe numërimit në 416 vendvotime në të gjitha 38 komunat. Zhvillimi i përgjithshëm i procesit të votimit u vlerësua pozitivisht në më shumë se 95 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Vëzhguesit nga subjektet politike dhe shoqëria civile ishin të pranishëm në më shumë se 90 për qind të vendvotimeve të vizituara, duke rritur besimin e palëve të përfshira në proces.
- Ndërsa vlerësimi i përgjithshëm i **procesit të votimit** ishte pozitiv, vëzhguesit e EU EOM gjithashtu vërejtën disa parregullsi. Ajo më e rëndësishmja - ndihma e tepërt për votuesit – u vëzhgua në shumë nga vendvotimet e vizituara, ku u ofrohej ndihmë votuesve që me sa dukej nuk kishin nevojë për ndihmë. Numri i votuesve që u ndihmuan për plotësimin e fletëvotimit në disa vendvotime shkon madje deri në 22 për qind. Performanca e stafit në KVV u përkeqësua dukshëm gjatë **procesit të mbylljes dhe numërimit** dhe vetëm 28 nga 39 numërimet të kryera në vendvotim u vlerësuan pozitivisht. Kjo kryesisht për shkak të faktit se procedurat mjaft komplekse të mbylljes dhe numërimit shpesh nuk u ndoqën me përpikëri.
- Nga aspekti pozitiv, KQZ-ja siguroi transparencën e procesit të numërimit duke publikuar në internet **rezultatet preliminare** për subjektet politike të zbërthyer sipas vendvotimeve brenda disa orësh pas përfundimit të numërimit të votave në qendrat e votimit. Sistemi i KQZ-së për votimin brenda Kosovës i cili bëri të mundur publikimin në internet të rezultateve preliminare dhe jozyrtare me kohë u vërtetua si tejet i rëndësishëm për të siguruar besueshmërinë e procesit të shpalljes së rezultateve. Subjektet politike në

përgjithësi u besuan këtyre rezultateve, megjithëse me shqetësime që u shkaktuan nga çështja e formularëve të rezultateve me gabime shtypi.

- **Procesi i tabelimit të rezultateve dhe i numërimit** të votave me kusht, votave të personave me nevoja të veçanta dhe votave me postë nga votuesit jashtë Kosovës ishte i centralizuar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në Prishtinë. Sipas vëzhguesve të EU EOM, puna në QNR ishte e organizuar mirë, stafi ishte kompetent dhe vëzhguesit kishin qasje domethënëse në të gjitha fazat e procesit. Megjithatë, procesi zgjati jashtëzakonisht shumë. Arsyeja kryesore për këtë vonesë ishte nevoja për të rinumëruar 2255 ose 88 për qind të të gjitha vendvotimeve për shkak të parregullsive të vërejtura në formularët e përputhjes së rezultateve.
- EU EOM analizoi 258 nga 396 vendvotime të cilat u rinumëruan para publikimit të rezultateve përfundimtare për shkak të mospërputhjeve të vërejtura në mes të numrit të votave të marra nga subjekti politik dhe numrit të votave të marra nga kandidatët e tij. Në 165 vendvotime rinumërimi çoi në ndryshime në numrin e votave të marra nga subjektet politike dhe në 250 vendvotime në numrin e votave të marra nga kandidatët individualë. Ndonëse shumica e këtyre ndryshimeve mbase do të mund të shpjegoheshin me dallimet në përcaktimin e vlefshmërisë së votave ose gabimet pa dashje, ka pasur disa raste që tregojnë qartë manipulimin e qëllimshëm të rezultateve.
- Proceset në QNR ishin transparente. Aty ku kishte rinumërim, edhe formularët origjinalë të rezultateve nga vendvotimi edhe formularët e plotësuar rishtas pas rinumërimit u publikuan në internet. Megjithatë, KQZ-ja nuk arriti t'i publikojë në mënyrë progresive rezultatet e përgjithshme për mbarë Kosovën, gjë që do ta kishte përmirësuar ndjeshëm transparencën e rezultateve gjatë procesit të tabelimit dhe rinumërimit.
- Më 13 tetor, ambientet e Ministrisë së Infrastrukturës, ku po bëhej verifikimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, u evakuuan dhe u vulosën nga Policia e Kosovës, pasi që u raportua se disa nga 26 punonjësit e KQZ-së ishin ankuar për reaksione alergjike nga puna me zarfet e ardhura nga Serbia. Incidenti u hetua nga Prokuroria dhe Policia e Kosovës. Mirëpo hetimi nuk ishte mbyllur para certifikimit të rezultateve përfundimtare dhe autoritetet nuk dhanë ndonjë informacion zyrtar në lidhje me statusin e hetimit. **Fletëvotimet e dërguara me postë nga Serbia** u përpunuan dhe u numëruan dhjetë ditë pas incidentit, por përfundimisht u anuluan gjatë procesit të ankesave dhe parashtrësive.
- Pas publikimit të rezultateve përfundimtare më 7 nëntor, Nisma-AKR-PD kundërshtoi rregullsinë e fletëvotimeve për votimin jashtë Kosovës me anë të postës të ardhura nga Serbia. PZAP vendosi t'i anulojë këto fletëvotime përmes postës dhe më pas Gjykata Supreme e mbështeti vendimin e PZAP-së dhe e refuzoi parashtrësën e paraqitur nga kandidatët e Vetëvendosjes. Këto vendime u panë si të njëanshme politikisht nga një numër i bashkëbiseduesve të EU EOM meqë nuk ekziston ndonjë marrëveshje për shkëmbimin postar ndërkombëtar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe një praktikë e ngjashme e marrjes së fletëvotimeve për votimin jashtë Kosovës me anë të postës ishte pranuar në zgjedhjet e mëparshme. Kjo pati ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet e zgjedhjeve meqë për shkak të anulimit të fletëvotimeve përmes postës nga Serbia, koalicioni Nisma-AKR-PD e kaloi pragun prej pesë për qind. Do të duhej të theksohej që kjo çështje kishte shkuar në PZAP tashmë dy herë më herët gjatë procesit të tabelimit dhe rinumërimit, mirëpo u bë e

diskutueshme që u shqyrtua nga PZAP-ja vetëm pas publikimit të rezultateve përfundimtare më 7 nëntor, kur ndikimi në rezultate ishte tashmë i njohur.

- Më 27 nëntor, d.m.th. 52 ditë pas ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja certifikoi **rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve**. Në aspekt të përqindjes së totalit të votave të vlefshme të marra nga subjektet politike, pati vetëm dallime shumë të vogla midis rezultateve të certifikuara përfundimtare, rezultateve përfundimtare të publikuara më 7 nëntor dhe rezultateve preliminare të votave brenda Kosovës, të cilat u publikuan menjëherë pas ditës së zgjedhjeve. Sidoqoftë, përderisa rezultatet preliminare dhe përfundimtare treguan se koalicioni Nisma-AKR-PD ishte nën pragun prej pesë për qind, sipas rezultateve përfundimtare të certifikuara, të cilat përfundimisht përjashtuan fletëvotimet përmes postës nga Serbia, koalicioni e kaloi pragun me 21 vota. Pjesëmarrja e përgjithshme arriti në 44.56 për qind dhe 3.8 për qind e të gjitha fletëvotimeve të hedhura ishin të pavlefshme.
- **Mekanizmi i ankesave dhe parashtresave**, siç u aplikua, rezultoi me vonesa të konsiderueshme në publikimin e rezultateve përfundimtare të certifikuara. Mungesa e dispozitave të qarta në ligj për natyrën e ankesave që mund të paraqiten gjatë procesit në QNR ose pas shpalljes së rezultateve përfundimtare krijon konfuzion për ankuesit, prodhon ngarkesë shtesë të punës për autoritetet shqyrtuese dhe shkakton vonesa të mëtejshme në proces. Situata u rëndua nga mungesa e vendimeve zyrtare nga KQZ, kryesisht në lidhje me pranimin e fletëvotimeve përmes postës për votimin jashtë Kosovës të marra pas afatit ligjor, si dhe nga qasjet e ndryshme të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Gjykatës Supreme për pranimin e këtyre fletëvotimeve përmes postës.

II. REKOMANDIMET PRIORITARE

EU EOM ka 23 rekomandime për përmirësimin e zgjedhjeve në Kosovë. Ato përfshijnë shtatë rekomandime prioritare si vijon:

1. *Të konsiderohet futja e një pozite jopartiake të anëtarit/sekretarit në Këshillin e Vendvotimit (KVV), për të ofruar mbështetjen e nevojshme këshilluese dhe administrative për kryesuesin e KVV.*
2. *Të përmirësohet dizajni i fletëvotimit për zgjedhjet parlamentare për ta bërë më lehtë të kuptueshëm për votuesit dhe të rritet konsiderueshëm edukimi i votuesve përpara çfarëdo zgjedhjeve, duke u përqendruar në trevat ku numri i votave të pavlefshme është tradicionalisht i lartë.*
3. *Të përfshihen dispozita të qarta për kundërshtimin e rezultateve në të gjitha nivelet (vendvotim, QNR dhe rezultatet përfundimtare) në LZP. Të qartësohet lloji i ankesave dhe parashtresave dhe afatet përkatëse për to gjatë gjithë procesit në LZP. Të qartësohen kompetencat e KQZ-së dhe PZAP-së për anulimin e rezultateve dhe urdhërim të rinumërimeve.*
4. *Zgjedhjet e parakohshme të thirren me paralajmërim prej të paktën dy muaj për të lejuar kohë të mjaftueshme për përgatitjet e duhura zgjedhore dhe për fushatën zgjedhore.*

5. Të përmirësohet saktësia e listës së votuesve, ndër të tjera, duke futur në përdorim një mekanizëm për heqjen sistematike të personave të ndjerë nga regjistri civil dhe më pas nga lista e votuesve.
6. Të përcaktohet me ligj raportimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të garuesve gjatë periudhës së fushatës, si dhe brenda 30 ditëve nga dita e zgjedhjeve. Raportimi do të duhej të përfshijë financat e kandidatëve të propozuar nga partitë dhe subjektet që bëjnë fushatë për garuesit (palë të treta). Ligji të përcaktojë një afat të shkurtër për autoritetet e mbikëqyrjes dhe subjektet politike për publikimin e të gjitha raporteve financiare në mënyrë lehtësisht të arritshme.
7. Të merret në konsideratë rregullimi i mëtejshëm i blerjes së kohës së emetimit nga subjektet politike në mediat audio-vizive. Kjo do të duhej të ketë për synim sigurimin e kushteve të barabarta dhe jo-diskriminuese për qasje në kohën e tillë, shpalosje publike të listave të çmimeve, si dhe vendosje të kufirit në kohën të emetimit që transmetuesi mund t'ia shesë secilit subjekt politik gjatë fushatës zgjedhore.

III. PREZANTIMI I MISIONIT

Me ftesë nga Presidenti i Kosovës të bërë më datë 28 gusht 2019, BE e dërgoi një Mision Vëzhgues të Zgjedhjeve (EOM) më 7 shtator për të vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Misioni u udhëhoq nga Shefja e Misionit, Viola von Cramon-Taubadel, anëtare e Parlamentit Evropian nga Gjermania. Misioni përbëhej nga një ekip prej 9 analistësh me qendër në Prishtinë, 18 vëzhgues afatgjatë (LTO) të cilët u dërguan në mbarë Kosovën më 15 shtator, dhe 36 vëzhgues afatshkurtër (STO) të cilët ishin të pranishëm në Kosovë nga 2 deri më 9 tetor (gjashtë prej tyre mbetën në Kosovë deri më 14 tetor). EOM gjithashtu u përforcua nga 38 vëzhgues të rekrutuar në vend nga Shtetet Anëtare të BE-së në Kosovë dhe një delegacion i Parlamentit Evropian i udhëhequr nga z. Andrey Kovatchev nga Bullgaria. Në ditën e zgjedhjeve, gjithsej 108 vëzhgues nga 27 Shtete Anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra vizituan 416 vendvotime në të gjitha 38 komunat e Kosovës për të vëzhguar votimin dhe numërimin.

LTO-të e misionit mbetën në terren për të ndjekur procedurat pas ditës së zgjedhjeve dhe u larguan nga Kosova më 17 tetor, përveç 6 LTO-ve që mbetën në Kosovë për të vëzhguar aktivitetet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve në Prishtinë deri më 28 tetor. Shumica e ekipit bërthamë u larguan nga Kosova më 31 tetor ndërsa dy anëtarët tjerë të ekipit e mbyllën misionin më 29 nëntor, dy ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare.

EU EOM vlerësoi të gjithë procesin zgjedhor kundrejt detyrimeve dhe zotimeve ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe ndaj ligjeve të Kosovës. EU EOM është i pavarur në gjetjet dhe konkluzionet e tij dhe i përmbahet Deklaratës së Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.

EU EOM dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij për autoritetet e Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe institucionet e tjera, policinë, partitë politike, mediat dhe shoqërinë civile për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre gjatë gjithë kohës sa ishte i pranishëm Misioni. EU EOM gjithashtu çmon bashkëpunimin nga Zyra e BE/EUSR, EULEX, KFOR, OSBE dhe përfaqësitë diplomatike të Shteteve Anëtare të BE-së, Norvegjisë dhe Zvicrës.

IV. KONTEKSTI POLITIK

Këto zgjedhje të parakohshme parlamentare u mbajtën më 6 tetor 2019 pas dorëheqjes zyrtare të qeverisë më 22 korrik 2019 dhe shpërbërjes së Kuvendit një muaj më vonë. Këto ishin zgjedhjet e katërta parlamentare që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në 2008, të gjitha këto ishin të parakohshme.

Qeveria e mëparshme u formua tre muaj pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në qershor 2017 nga koalicioni parazgjedhor i njohur si “PAN” i cili ishte i përbërë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma Social Demokratike (Nisma). Këtyre partive iu bashkuan partitë jo-shumicë dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) - e cila në kohën e zgjedhjeve të 2017 kishte qenë në koalicion parazgjedhor me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Në kohën e formimit të saj, qeveria kishte mbështetjen e 61 nga 120 deputetëve të Kuvendit dhe kishte 21 ministra që përfaqësonin tetë parti dhe një kandidat të pavarur.

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017, koalicioni parazgjedhor PAN doli i pari, por nuk formoi grup parlamentar të përbashkët në Kuvend, duke e bërë partinë më të madhe në Kuvend Lëvizjen Vetëvendosje (VV) nga opozita, deri kur 13 nga ligjvënësit e saj u larguan nga partia në 2018, 12 prej të cilëve iu bashkuan Partisë Socialdemokrate (PSD). Numrat në grupet parlamentare të Kuvendit në kohën e shpërbërjes më 22 gusht 2019 u raportuan të jenë si vijon: LDK 25, PDK 23, VV 19, PSD 12, AAK 12, Srpska Lista 10,¹ Nisma 8, grupi parlamentar i partive jo-shumicë 6, si dhe 5 anëtarë pa përkatësi.

Aktorët kryesorë politikë

Në këto zgjedhje, 25 subjekte politike (parti, koalicione, ose në një rast një individ) u certifikuan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për të marrë pjesë në zgjedhje. Numri i subjekteve të regjistruara sipas komunitetit ishte: 7 të komunitetit shqiptar të Kosovës, 4 të komunitetit serb të Kosovës, 4 të komunitetit boshnjak (përfshirë 1 kandidat të pavarur), 3 të komuniteti goran, 2 të komunitetit ashkali, 2 të komunitetit rom, 2 të komunitetit egjiptian dhe 1 i komunitetit turk.

Tri partitë më të mëdha, PDK, LDK dhe VV, në këto zgjedhje garuan vetëm. Një koalicion parazgjedhor u formua nga AAK dhe PSD, nën emërtimin “100% Kosovë”. Nisma dhe AKR, së bashku me Partinë e Drejtësisë (PD), formuan gjithashtu koalicion parazgjedhor. Kandidatët për kryeministër nga partitë kryesore ishin lideri i VV, Albin Kurti, nënkryetarja e LDK, Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit në largim dhe lideri i PDK, Kadri Veseli, dhe kryeministri në largim dhe lideri i AAK, Ramush Haradinaj, për koalicionin AAK-PSD.

Komuniteti serb i Kosovës, në Kuvendin në largim përfaqësohej nga nëntë anëtarë të Srpska Lista dhe një nga Partia e Pavarur Liberale (SLS). Të dy partitë ishin të përfaqësuara në qeverinë në largim.² Dy partitë tjera serbe të Kosovës që morën pjesë në këto zgjedhje ishin Partia e Serbëve të Kosovës (PKS) dhe Koalicioni Liria (Sloboda). Të dhjetë komunat me shumicë serbe kanë zgjedhur

¹ Përfshirë anëtarin e vetëm të komunitetit goran nga JGP, i cili zgjodhi të bëhej pjesë e grupit parlamentar të Srpska Lista në Kuvendin e kaluar.

² Në mars 2018, Srpska Lista njoftoi se ata nuk e mbështesin më qeverinë e koalicionit, megjithëse ministrat e tyre de facto vazhduan të qëndrojnë në detyrë. Një ministër i bujqësisë nga SLS u emërua në shkurt 2019.

Srpska Lista-n për pushtet lokal; të katër komunat veriore mbajtën zgjedhje të jashtëzakonshme për kryetar komune në maj 2019, në të cilat nga partitë serbe të Kosovës, mori pjesë vetëm Srpska Lista.

V. IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE TË MËHERSHME TË EU EOM

Fare pak rekomandime të implementuara pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2017

Kosova ka bërë përparim të vogël në forcimin e procesit zgjedhor që nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Përkundër iniciativës së shefave të grupeve parlamentare për të përmirësuar dhe forcuar procesin zgjedhor dhe vendimit të marrë nga Kuvendi për krijimin e një komisioni parlamentar ad-hoc, reforma shumë e nevojshme nuk u zhvillua për shkak të shpërbërjes së Kuvendit.

EU EOM për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017 dha 26 rekomandime. Prej tyre, vetëm dy janë implementuar plotësisht në praktikë. Konkretisht, procesi i tabelimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është përmirësuar, dhe procedurat për trajtimin e votave me kusht janë qartësuar dhe vëzhguesit ishin në gjendje të vëzhgonin procesin e verifikimit.

Tre rekomandime të tjera janë implementuar pjesërisht. Zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 u thirrën me paralajmërimin më të gjatë të mundshëm prej 45 ditësh, që parashihet me Kushtetutë, PZAP postoi me kohë në internet vendimet për ankesa dhe institucionet u përpoqën që menjëherë dhe në mënyrë të rregullt të kryejnë hetimet, ndjekjen penale dhe shqyrtimin e rasteve të mashtrimit zgjedhor. Do të duhej të theksohej se nuk është implementuar asnjë nga rekomandimet që kërkojnë ndryshime legjislative.

VI. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Kornizë ligjore adekuate, por disa mangësi të identifikuarra më parë vazhdojnë

Zgjedhjet rregullohen kryesisht me Kushtetutën e vitit 2008, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP, i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2010) dhe Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2010 (i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2013).³ Korniza ligjore nuk ka pësuar asnjë ndryshim që nga zgjedhjet e fundit parlamentare, dhe vlerësohet se garanton në mënyrë adekuate kryerjen e zgjedhjeve, në përputhje me standardet ndërkombëtare ndaj të cilave është zotuar Kosova

³ Këto plotësohen nga 19 Rregullat Zgjedhore të KQZ-së të nxjerra në 2013, 2015 dhe 2016, të cilat zbërthejnë tutje parimet e përfshira në LZP. Përveç kësaj, aspektet procedurale janë paraparë në Rregulloren e Punës së KQZ-së nga viti 2008 dhe Rregulloren e Punës së Panelit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) të vitit 2015. Ligje të tjera të rëndësishme që lidhen me procesin zgjedhor janë: Kodi Penal i vitit 2019, Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDK), i ndryshuar herën e fundit në 2012 dhe Ligji për përdorimin e gjuhëve i vitit 2006.

përmes Kushtetutës së saj.⁴ Sidoqoftë, disa mangësi tashmë të identifikuar në zgjedhjet e kaluara vazhdojnë të paraqiten. Tutje, Kushtetuta detyron autoritetet të interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me ligj dhe Kushtetutë në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).⁵ Të drejtat e mishëruara në KEDNJ (ECHR) janë drejtpërdrejt të zbatueshme, dhe në rast konflikti kanë epërsi ndaj ligjeve të Kosovës. Pas anëtarësimit të Kosovës në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut i tetorit 2002 aplikohet si referencë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.⁶

Një komision ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor u krijua në maj 2019 pa arritur megjithatë ndonjë rezultat konkret para shpërbërjes së Kuvendit. Prandaj, përkundër angazhimit për të vazhduar me reformë zgjedhore të përkufizuar mirë, nuk u bë asnjë ndryshim dhe rekomandimet kryesore të EU EOM që kërkonin ndryshime legislative nuk u adresuan.

Në mangësitë e identifikuar të kornizës ligjore përfshihen dispozitat për thirrjen e zgjedhjeve të parakohshme me paralajmërim jashtëzakonisht të shkurtër dhe që i lejojnë KQZ-së t'i shkurttojë tutje afatet, duke rritur kështu rrezikun e komprometimit të të drejtave zgjedhore. Kjo kohë e kufizuar nuk siguron përgatitje të duhura zgjedhore, përfshirë regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës, verifikimin e regjistrave të votuesve ose kundërshtimet e mundshme mbi listat e kandidatëve. Ligji parasheh rregulloret e fushatës që synojnë sigurimin e barazisë së mundësive për garuesit dhe paanshmërinë e administratës publike gjatë fushatës. Periudha zyrtare e fushatës zgjedhore e shkurtuar në 10 ditë nuk siguroi fushë-loje të barabartë mes garuesve.

Aspekte të rëndësishme të procesit, siç janë regjistrimi dhe funksionimi i partive politike, rregullat për fushatën zgjedhore, procedurat në QNR, rregullat për rinumërim dhe anulimet rregullohen me legjislacion sekondar, gjegjësisht Rregulloret e KQZ-së,⁷ gjë që e bën procesin të cënueshëm nga ndryshimet ose sqarimet e minutës së fundit dhe nuk garanton siguri juridike.⁸ Tutje, afatet për të kundërshtuar vendimet e ndryshme të KQZ-së, procedura për të kundërshtuar rezultatet e zgjedhjeve veçanërisht lidhur me afatet për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të tilla, si dhe për urdhërim të rinumërimit nuk janë të qarta dhe trajtohen vetëm paksa në LZP dhe

⁴ Neni 22 i Kushtetutës thekson zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të një varg instrumentesh të rëndësishme për zgjedhjet: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (ECHR) dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

⁵ Neni 53 i Kushtetutës. Sidoqoftë, duke qenë se Kosova nuk është palë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, nuk ka mundësi që ndonjë çështje të paraqitet para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe interpretimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut mbetet brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.

⁶ Më 11 qershor 2014, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës miratoi anëtarësimin e Kosovës në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si Komisioni i Venedikut.

⁷ Adresuar në Rregullat e KQZ nr.6/2013, nr.11/2013, nr.13/2013.

⁸ Rregulla Zgjedhore nr. 13/2013 – Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike u ndryshua në 26 shtator gjatë periudhës së fushatës me Rregullën Zgjedhore nr. 20/2019 të KQZ.

shpesh madje në kundërshtim me rregulloren e punës së PZAP ose rregullat e KQZ-së.⁹ Këto, të kombinuara më tej me mungesën e qartësisë në LZP mbi mënyrën se si mund të vlerësohet pranueshmëria e kandidatit për t'u paraqitur për subjektet politike jo-shumicë,¹⁰ dhe dispozitat shumë të përgjithshme për përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në organet e menaxhimit të zgjedhjeve, komprometojnë sigurinë juridike.¹¹ LZP u jep autoriteteve kompetenca të gjera diskrecionare për të interpretuar dispozitat e tij, gjë që nuk e parandalon zbatimin jo-konsistent ose arbitrar.¹² Nga një aspekt tjetër, korniza ligjore është diskriminuese ngase ia mohon qytetarëve të drejtën për të votuar dhe pranueshmërinë e kandidatëve bazuar në paaftësinë mendore, në kundërshtim me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.¹³

Rekomandimi: Aspektet thelbësore të procesit, të përcaktuara aktualisht në rregulloret e KQZ-së, p.sh. veprimet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, rregullat për rinumërimin dhe anulimin e rezultateve, të përfshihen në legjislacionin primar.

Përveç kësaj, ekzistojnë mbrojtje të pamjaftueshme ligjore kundër keqpërdorimit të resurseve publike, si dhe të raportimit financiar. Rregullat e fushatës që lidhen me njoftimin dhe organizimin e ngjarjeve të fushatës, postimet zgjedhore dhe përfshirjen neutrale dhe të paanshme të zyrtarëve publikë dhe nëpunësve civilë në fushatat elektorale nuk janë zhvilluar aq sa duhet në LZP.¹⁴ LZP as nuk përfshin masa mbrojtëse adekuate kundër përdorimit të paligjshëm të resurseve administrative, d.m.th. masa të tilla si ndalimi i keqpërdorimit të resurseve administrative në mënyrë të qartë dhe të parashikueshme, as nuk ofron një listë gjithëpërfshirëse të shkeljeve të

⁹ Konkretisht, afatet për kundërshtime në listat e kandidatëve ose për tërheqjen e kandidatëve, afatet për shqyrtimin e parashtrësive ndaj vendimeve të KQZ-së, etj. Në mënyrë indikative, kundërshtimet për certifikimin e kandidatëve, siç adresohen në nenin 122.1 (b) dhe 26.6, LZP, nenet 10.4 dhe 10.5 të Rregullës nr. 02/2015, Rregullores së Punës të PZAP dhe nenin 6.8 të Rregullës Zgjedhore nr. 08/2013 të KQZ.

¹⁰ 15.11, LZP “Çdo subjekt politik në kërkesën e tij tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera jo-shumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës.”

¹¹ Çështja është adresuar në përgjithësi nga neni 67.1(b), LZP “nga një anëtar i nominuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor” dhe neni 67.3, LZP “KQZ duhet të përpikët ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.” dhe në mënyrë të ngjashme përsëritet në nenin 3, Rregulla Zgjedhore nr.18/2016 e KQZ-së “Komisioni duhet të përpikët ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune”.

¹² Ref. te pjesa Zgjidhja e kontesteve zgjedhore.

¹³ Neni 45.1, Kushtetuta dhe neni 5.1(e), LZP. Komiteti i traktatit për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është shprehur se në bazë të neneve 12 dhe 29 paaftësia mendore nuk do të duhej të shërbejë si bazë për heqjen e të drejtës së votës dhe të drejtës për t'u zgjedhur në asnjë rrethanë (CRPD GC 1, para. 48).

¹⁴ Neni 35, LZP “Veprimet e ndaluara nga shërbyesit publikë”.

mundshme zgjedhore dhe sanksioneve përkatëse.¹⁵ Në përgjithësi, këto mangësi ligjore nuk sigurojnë transparencë dhe integritet në të gjitha fazat e procesit zgjedhor.¹⁶

Rekomandimi: Periudha e fushatës për zgjedhje të parakohshme të zgjatet në 30 ditë. Rregullat e fushatës që lidhen me njoftimin dhe organizimin e ngjarjeve politike, rregullat për postimet zgjedhore dhe rregullat për përfshirjen e zyrtarëve të zgjedhur në fushatën zgjedhore të zhvillohen më shumë në LZP.

Kosova është një zonë e vetme zgjedhore me sistem përfaqësimi proporcional me shumë parti me votim preferencial për deri në pesë kandidatë.¹⁷ 120 deputetët e Kuvendit zgjedhen me votim të fshehtë për mandat katër vjeçar. Njëqind ulëse në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në proporcion me numrin e votave të vlefshme që i kanë marrë.

Një minimum prej 20 ulësesh janë të garantuara për komunitetet jo-shumicë (dhjetë për komunitetin serb, tre për komunitetin boshnjak, dy për komunitetin turk, një për komunitetin rom, një për komunitetin ashkali, një për komunitetin egjiptian, një për komunitetin goran dhe një ulëse shtesë i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme).¹⁸ Subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin shumicë shqiptar duhet të kalojnë pragun prej pesë për qind të totalit të votave të vlefshme. Nga ulëset që i caktohen një subjekti politik, secila gjini duhet të ketë të paktën 30 për qind të numrit të përgjithshëm të ulëseve të fituara nga subjekti politik. Nëse kjo nuk arrihet, pas ndarjes fillestare të vendeve, lista e kandidatëve rirenditet derisa numri i

¹⁵ Para.110. “Objektivi i ligjeve që japin masa që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e resurseve administrative është në parim të sigurojë votën e lirë dhe të barabartë...”. Raporti i Komisionit të Venedikut për Keqpërdorimin e resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore, miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike në mbledhjen e tij të 46-të (Venedik, 5 dhjetor 2013) dhe nga Komisioni i Venedikut në sesionin plenar të 97-të (Venedik, 6-7 dhjetor 2013). Para.A.1.1. Korniza ligjore do të duhej të parashikojë një ndalim e përgjithshëm të keqpërdorimit të resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore. Ndalimi duhet të vendoset në mënyrë të qartë dhe të parashikueshme. Sanksionet për keqpërdorim të resurseve administrative duhet të parashikohen dhe të implementohen. Sanksionet e tilla duhet të jenë të zbatueshme, proporcionale dhe dekurajuese. A.4.2. Në këtë drejtim, korniza ligjore do të duhej të sigurojë një sërë rregullash adekuate dhe proporcionale. Rregullat e tilla mund të përfshijnë një udhëzim të qartë se si dhe kur mund të bëhet fushata në cilësi personale, pezullimi nga detyra ose dorëheqja e autoriteteve të caktuara publike që garojnë për zgjedhje. B.1.1. Korniza ligjore do të duhej të sigurojë mekanizma efektivë për t’ia ndaluar autoriteteve publike që të realizojnë avantazhe të padrejta nga pozitat e tyre duke mbajtur ngjarje zyrtare publike për qëllime të fushatës zgjedhore. B.1.4. Korniza ligjore do të duhej të përcaktojë se nuk do të duhej të ketë emërime jo-thelbësore në organet publike gjatë fushatës zgjedhore.” Udhëzime të përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore, adoptuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike në mbledhjen e tij të 54-të (Venedik, 10 mars 2016) dhe nga Komisioni i Venedikut në sesionin plenar të 106-të (Venedik, 11-12 mars 2016).

¹⁶ Për këtë çështje referojuni gjithashtu pjesëve “Ambienti i fushatës” dhe “Financimi i fushatës”.

¹⁷ Votuesit vënë shenjë në fletëvotim për zgjedhjen e tyre të subjektit politik, dhe po ashtu mund të vënë shenjë për preferencat për deri në pesë kandidatë nga subjekti i zgjedhur politik. Nëse në fletëvotim janë vënë shenja për më shumë se pesë kandidatë, preferencat bëhen të pavlefshme dhe numërohet vetëm vota për subjektin politik.

¹⁸ Sistemi garanton që ato 20 ulëse gjithmonë do t’u ndahen subjekteve politike që i përfaqësojnë ato komunitete jo-shumicë, pavarësisht nga rezultatet e tyre aktuale, por përveç kësaj mund t’u ndahen ulëse shtesë varësisht nga pjesa e tyre e votës.

përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të arrijë në 30 për qind.¹⁹

Kushtetuta dhe LZP lejojnë Presidentin e Kosovës të thërrasë zgjedhje të parakohshme për Kuvendin kur ai shpërbëhet. Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se 30 dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.²⁰ Dekreti presidencial i 26 gushtit shpalli 6 tetorin si datën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare 2019, data e fundit e mundshme për të mbajtur zgjedhje të parakohshme. Ndonëse kjo lejoi më shumë kohë sesa në zgjedhjet e vitit 2017, ky afat kohor është shumë i shkurtër për të siguruar përgatitje të duhura zgjedhore dhe mundësi të barabarta për subjektet politike dhe kandidatët.

Rekomandimi: Zgjedhjet e parakohshme të thirren me paralajmërim prej të paktën dy muaj për të lejuar kohë të mjaftueshme për përgatitjet e duhura zgjedhore dhe për fushatën zgjedhore.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Proces i hapur dhe gjithëpërfshirës i certifikimit të kandidatëve

Kushtetuta garanton lirinë e asociimit, si dhe të drejtën e çdo shtetasi që ka mbushur moshën 18 vjeç për t'u zgjedhur. Legjislacioni përkatës nuk përmban kufizime të paarsyeshme për certifikimin e subjekteve politike ose certifikimin e pranueshmërisë së kandidatëve.

Për të marrë pjesë në zgjedhje, kandidatët potencialë duhet të certifikohen nga KQZ-ja si subjekte politike.²¹ Subjekti politik mund të jetë parti politike, koalicion i partive politike, iniciativë e qytetarëve ose kandidat i pavarur. Partitë politike të regjistruara certifikohen automatikisht. Çdo subjekt politik i certifikuar duhet të paraqesë në KQZ listën e kandidatëve për certifikim.

U certifikuan që të gjitha 25 subjektet politike - katër koalicione të partive politike, 20 parti politike dhe 1 kandidat i pavarur - që aplikuan për certifikim për të marrë pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019. Më pas, KQZ gjithashtu certifikoi 25 listat e kandidatëve me 1,067 kandidatë, duke përfshirë 724 burra dhe 343 gra.²² Të gjitha listat e kandidatëve me më shumë se dy kandidatë respektuan kuotën e detyrueshme gjinore prej 30 për qind.²³ Procesi i certifikimit u përmbyll në 10 shtator ashtu siç ishte parashikuar në kalendarin zgjedhor të miratuar. Në përgjithësi, procesi ishte gjithëpërfshirës, pa ndonjë polemikë të rëndësishme.

¹⁹ Me kusht që lista të ketë mbi dy kandidatë (neni.111.6 i ndryshuar, LZP).

²⁰ Neni 66.2, Kushtetuta; neni 4.5, LZP.

²¹ Përveç kërkesave të ndryshme administrative, subjekti politik paguan tarifë certifikimi prej 2,000 EUR dhe paraqet 1,000 nënshkrime në mbështetje të kërkesës së tij për certifikim. Partia politike që ka fituar të paktën një ulësë në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës nuk kërkohet të paguajë tarifën e certifikimit ose të paraqesë nënshkrimet.

²² Pas afatit për certifikim të kandidatëve, KQZ bazuar në vendimet e PZAP-së decertifikoi pesë kandidatë dhe certifikoi dy kandidatë të rinj për të ruajtur kuotën gjinore minimale të kërkuar.

²³ Ligji kërkon që çdo listë e kandidatëve të përbëhet prej të paktën 30% kandidatë të certifikuar të gjinisë tjetër.

VIII. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Organ transparent i menaxhimit të zgjedhjeve dhe zgjedhje të përgatitura mirë nga aspekti teknik

Zgjedhjet u administruan nga një organ i menaxhimit të zgjedhjeve prej tri nivelesh, i përbërë nga KQZ, 38 Komisione Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe 2,547 Këshilla të Vendvotimeve (KVV). Mekanizmi ekzistues për emërim në KQZ, KKZ dhe KVV parashikon përfshirje domethënëse të subjekteve politike përkatëse në Kosovë, duke përfshirë subjektet politike jo-shumicë. Përbërja e KQZ-së ishte dhjetë anëtarë me një vend të lirë. Përveç kryesuesit jopartiak, ishin nga dy anëtarë të emëruar nga VV dhe LDK, dhe nga një nga PDK, Srpska Lista, koalicioni Vakrat (boshnjak), KDTP (turk) dhe PREBK (rom, që përfaqësonte gjithashtu komunitetin ashkali, dhe atë egjiptian). AAK, partia e dytë më e madhe e koalicionit të mëparshëm PAN, nuk ishte e përfaqësuar në KQZ, megjithatë Presidenti nuk e konfirmoi emërimin e anëtarit të dytë në KQZ nga ky koalicion.²⁴ Sidoqoftë, AAK ishte e përfaqësuar në nivel të KKZ dhe KVV.

KQZ dhe KKZ-të funksionuan në mënyrë transparente dhe profesionale. Mbledhjet e KQZ-së ku u morën vendime ishin të hapura për publikun dhe vendimet në përgjithësi u publikuan në uebsajtin e KQZ-së, megjithatë nganjëherë publikimi u vonua, disa vendime mungonin, dhe ato jo gjithnjë u publikuan në të dy gjuhët zyrtare. Vendimet zakonisht u morën me konsensus, megjithatë, në disa raste nuk u arrit konsensusi dhe ishte e nevojshme të zbatohet votimi me shumicë të thjeshtë. Këto përfshijnë vendimet për përbërjen në KKZ, caktimin e pozitave të kryesuesve në KVV dhe dokumentet e identifikimit të lejuara për verifikimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve.²⁵

Në disa raste, KQZ me qëllim iu shmang përgjegjësisë për të marrë vendime dhe lejoi që Sekretariati i KQZ-së të vendosë për disa aspekte të rëndësishme dhe politikisht të ndjeshme të procesit, siç janë pranimi i fletëvotimeve të votimit jashtë Kosovës përmes postës nga Serbia, pranimi i fletëvotimeve të votimit jashtë Kosovës përmes postës që mbërritën pas afatit ligjor të 5 tetorit dhe pranimi i fletëvotimeve të votimit jashtë Kosovës përmes postës që mbërritën pas 11 tetorit dhe të cilat nuk u përmendën shprehimisht në vendimin e Gjykatës Supreme që urdhëroi KQZ-në t'i përpunojë dhe t'i numërojë të gjitha fletëvotimet e pranuar përmes postës me kusht që ato të jenë dërguar para afatit ligjor.

Ka mungesë të qartësisë në ligj mbi dokumentet e identifikimit që kërkohen për të vërtetuar identitetin e votuesve në ditën e zgjedhjeve. KQZ e sqaroi këtë çështje më 9 shtator duke adoptuar udhëzim administrativ sipas të cilit mund të pranohen vetëm dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Kosova, d.m.th. mund të pranohen letërnjoftimi, pasaporta dhe patentë shoferi. Ky vendim u kundërshtua dhe u ankimua pa sukses nga Srpska Lista. Në parim, të gjithë votuesit, emrat e të

²⁴ Koalicioni PAN i përbërë nga PDK, AAK dhe Nisma, kishte të drejtë të caktonte dy anëtarë në KQZ. Presidenti konfirmoi emërimin e anëtarit nga PDK, mirëpo, ai nuk konfirmoi asnjërin prej dy të emëruarve të propozuar nga AAK dhe Nisma, përkatësisht.

²⁵ KQZ miratoi një propozim "kompromisi" për përbërjen e 38 KKZ-ve duke i lejuar të tre anëtarët e koalicionit PAN (d.m.th. PDK, AAK dhe Nisma) të emërojnë përfaqësuesit e vet, megjithatë me ligj i tërë koalicioni ishte dashur të propozonte vetëm një përfaqësues.

cilëve janë në listën e votuesve, së pari regjistrohen në regjistrin civil të Kosovës, i cili shërben si bazë për listën e votuesve. Megjithatë, ndonëse ishin të pranueshëm, jo të gjithë këta votues të regjistruar kishin medoemos në ditën e zgjedhjeve dokument të vlefshëm të identifikimit të lëshuar nga Kosova.²⁶ KQZ miratoi udhëzimin 26 ditë para ditës së zgjedhjeve, duke siguruar kështu periudhë kohore të arsyeshme që ata që nuk kishin dokument të vlefshëm identifikimi të mund të pajisen me një të tillë.²⁷ Vëzhguesve të EU EOM nuk iu dhanë prova materiale se njerëzit nuk kishin qenë në gjendje të marrin dokument të ri identifikimi para zgjedhjeve.

Të dhënat e siguruar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) për numrin e përgjithshëm të letërnjoftimeve të Kosovës të lëshuara dhe të vlefshme, treguan se në listën përfundimtare të votuesve kishte rreth 246,000 votues të regjistruar pa letërnjoftim të vlefshëm të Kosovës²⁸ përfshirë 137,000 persona me letërnjoftime të skaduar të lëshuara nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovës (UNMIK). Ky grup mund të përfshijë disa kategori të votuesve siç janë personat e ndjerë, personat që abuzuan me kërkesat e zbutura për regjistrim në vitet e hershme të regjistrimit civil dhe kurrë nuk aplikuan për letërnjoftim të ri²⁹, personat me vendbanim të përhershëm jashtë vendit që nuk e kanë ndërmend të nxjerrin letërnjoftime të reja për t'i zëvendësuar ato të skaduarat, personat që për shkaqe të ndryshme refuzojnë të aplikojnë për letërnjoftime të reja të lëshuara nga Kosova, etj.

Për KQZ-në u ndanë resurse të mjaftueshme financiare – 5,7 milionë EUR – nga buxheti i Kosovës menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve. Përkundër kornizës kohore të shkurtër prej 41 ditësh, të gjitha përgatitjet zgjedhore përfunduan me kohë dhe zgjedhjet ishin të përgatitura mirë teknikisht. Megjithatë pati një përjashtim të dukshëm, ku formularët e rezultateve nga vendvotimi dhe formularët e përputhjes së rezultateve (FPR) përmbanin gabime shtypi. Për shkak të mungesës së kontrollit të cilësisë, Sekretariati i KQZ-së nuk e zbuloi këtë gabim shtypi përpara ditës së zgjedhjeve dhe si rezultat më shumë se 450 FPR u plotësuan gabimisht dhe ishte e nevojshme të rinumërohen vendvotimet përkatëse, duke e vonuar procesin e tabelimit të rezultateve. Në përgjithësi, KQZ përfitoi nga përvoja e saj e mëparshme, me organizimin e katër zgjedhjeve në mbarë Kosovën ndërmjet 2013 dhe 2017, ku dy prej tyre ishin zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Trajnimi i më shumë se 17,000 pjesëtarëve të stafit të votimit në nivelin komunal u vlerësua nga vëzhguesit e EU EOM si përgjithësisht i kryer mirë, megjithatë auditimi i FPR-ve dhe formularëve të përputhjes së kandidatëve (FPK) në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) zbuloi se një në tre vendvotime kishte probleme me formularët e rezultateve dhe duhej të rinumërohej. Ky është problem që përsëritet në zgjedhjet që mbahen në Kosovë. Me sa duket vetëm trajnimi nuk është i mjaftueshëm për ta adresuar këtë çështje dhe mund të jetë e nevojshme një zgjidhje sistematike.

²⁶ Shumica e këtyre votuesve të regjistruar ka të ngjarë të jenë shqiptarë të Kosovës. Srpska Lista vlerësoi se kishte rreth 5,600 votues serbë të Kosovës që nuk kishin letërnjoftim të Kosovës. Thuhet se pothuajse të gjithë jetonin në katër komunat veriore.

²⁷ Letërnjoftimi i ri do të duhej të lëshohet brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës dhe tarifa është 10 EUR. Mund të lëshohet edhe brenda 72 orësh, por tarifa për shërbimin e tillë është 60 EUR.

²⁸ Diferenca midis numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën përfundimtare të votuesve për votimin brenda dhe jashtë Kosovës (1.97 milion) dhe numrit të përgjithshëm të letërnjoftimeve të vlefshme të Kosovës të lëshuara deri më 31 gusht 2019 (1.73 milion).

²⁹ Në fazën fillestare të regjistrimit civil nga UNMIK, qytetarët mund të regjistroheshin në regjistrin civil edhe pa ndonjë dokument, me kusht që identiteti i tyre të ishte konfirmuar nga dy persona të tjerë me letërnjoftime të vlefshme.

Rekomandimi: Të konsiderohet futja e një pozite jopartiake të anëtarit/sekretarit në KVV, për të ofruar mbështetjen e nevojshme këshilluese dhe administrative për kryesuesin e KVV-së.

Përkundër numrit të madh të votave të pavlefshme në zgjedhjet e kaluara, edukimi i votuesve me sa duket nuk ishte prioritet për KQZ-në. Edukimi i votuesve ishte i kufizuar në transmetimin e spoteve të KQZ-së në media elektronike dhe rrjete sociale dhe disa aktivitete të momentit të fundit për edukim të votuesve nga ekipet lëvizëse në qendrat urbane të komunave. Vëzhguesit e EU EOM vlerësuan edukimin e votuesve si joadekuat.

Rekomandimi: Të përmirësohet dizajni i fletëvotimit për zgjedhjet parlamentare për ta bërë më lehtë të kuptueshëm për votuesit dhe të rritet dukshëm edukimi i votuesve përpara çfarëdo zgjedhjeve, duke u përqendruar në trevat ku numri i votave të pavlefshme është tradicionalisht i lartë.

Në këto zgjedhje u lejuan katër lloje të votimit: votimi i rregullt në vendvotimin e caktuar; votimi me kusht për ata që nuk u gjetën në listën përfundimtare të votuesve në qendrën e votimit, por paraqitën dokument të lejueshëm të identifikimit; votimi me kusht për personat me nevoja të veçanta përmes kutive mobile të votimit për votuesit që nuk mund të dalin nga shtëpia, të hospitalizuar, në paraburgim dhe të burgosur; dhe votimi me kusht përmes postës jashtë Kosovës për votuesit me vendbanim të përkohshëm jashtë Kosovës.³⁰ Votat e rregullta u numëruan në vendvotime menjëherë pas mbylljes së votimit. Të gjitha votat e tjera – me kusht, me nevoja të veçanta, përmes postës për votuesit jashtë Kosovës – u numëruan në mënyrë qendrore në QNR.

Votimi jashtë Kosovës përmes postës

Ekziston mungesë e masave mbrojtëse kundër identifikimit të rremë në sistemin e votimit me postë jashtë Kosovës dhe disa palë të interesuara shprehën shqetësime për besueshmërinë e procesit. Votuesit mund të aplikojnë në formë elektronike duke bashkëngjitur vetëm një skanim të dokumentit personal të identifikimit dhe fletëvotimet nuk ishte e nevojshme të dërgohen me postë në adresat e votuesve jashtë vendit, meqë ato mund të shkarkoheshin dhe shtypeshin nga uebsajti i KQZ-së.

Regjistrimi dhe votimi i votuesve jashtë Kosovës u ndikua negativisht nga korniza kohore e ngjeshur dhe numri më i madh i aplikuesve nga sa ishte pritur.³¹ Votuesit kishin vetëm 12 ditë për të aplikuar për regjistrim në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe KQZ-ja nuk ishte në gjendje t'i shqyrtonte të gjitha 40,313 aplikimet me kohë. Prandaj, ndryshe nga lista e rregullt e votuesve, lista e votuesve jashtë Kosovës nuk ishte në dispozicion për kontroll publik gjatë periudhës tejet të shkurtër të konfirmimit dhe kundërshtimit më 12-14 shtator. Lista përfundimtare e votuesve jashtë Kosovës me 35,087 votues³² u përpilua vetëm më 18 shtator dhe më pas u certifikua nga KQZ-ja. Votimi jashtë Kosovës filloi më 19 shtator, një ditë më vonë sesa ishte parashikuar fillimisht, pasi u publikuan në uebsajtin e KQZ-së fletëvotimi i miratuar dhe broshura me listat e kandidatëve.

³⁰ Në misionet e Kosovës jashtë vendit nuk ofrohet mundësia për votim jashtë Kosovës.

³¹ Numri i aplikuesve për votim jashtë Kosovës u rrit nga 20,354 në 2017 në 40,313 në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019.

³² Pas vendimit të PZAP-së për ankesat e paraqitura, edhe shtatë votues të tjerë u shtuan në listën e votuesve jashtë Kosovës. Gjithsej, votuesit jashtë Kosovës përfaqësuan 1.8 për qind të të gjithë votuesve të regjistruar.

Gjermania, Zvicra dhe Serbia përbënin më shumë se 70 për qind të aplikuesve të regjistruar dhe të refuzuar për votim jashtë Kosovës.

Të gjitha fletëvotimet me kusht të dërguara përmes postës duhej të mbërrinin në zyrën postare të caktuar në Prishtinë para mesnatës së 5 tetorit, pra brenda 17 ditëve nga dita e parë e votimit. Deri në këtë afat, KQZ mori 15,794 dërgesa postare me fletëvotime përmes postës. Edhe 6,445 dërgesa të tjera postare që mbërritën pas afatit fillimisht u refuzuan, por më vonë u procesuan pas vendimeve të Gjykatës Supreme meqë ishin dërguar me postë para afatit.³³ Pas ditës së zgjedhjeve, KQZ filloi verifikimin e fletëvotimeve të pranuar përmes postës për të konstatuar nëse ishin dërguar nga votues të regjistruar për votimin jashtë Kosovës. Vëzhguesit patën mundësi të ndiqnin procesin e verifikimit. Vëzhguesit e EU EOM vizituan disa herë ambientet në Ministrinë e Infrastrukturës³⁴ ku po bëhej verifikimi i fletëvotimeve të dërguara me postë dhe nuk u raportuan ankesa në lidhje me procesin e verifikimit.

Më 11 tetor u pezullua procesi i verifikimit pasi stafi filloi të përpunojë pakot e ardhura nga Serbia. Gjithsej ishin 19 pako identike nga Serbia që përmbanin 3,782 zarfe të personalizuar, të cilat ishin gjithashtu të gjitha identike, gjë që sugjeron përfshirjen e pavend të autoriteteve serbe në procesin e votimit jashtë Kosovës. Pakot përmbanin mes 157 dhe 238 zarfe. Në mënyrë që të verifikohen, u hapën 150 zarfe dhe brenda tyre kishte zarfe identike sekreti ngjyrë vjollcë. Pakot u sollën fizikisht në zyrën postare nga zyrtari ndërlidhës serb, në vend se të dërgoheshin me postë ndërkombëtare, meqë aktualisht nuk ka asnjë marrëveshje midis Beogradit dhe Prishtinës për shkëmbim postar të drejtpërdrejtë. Kjo çështje u soll para KQZ-së në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor, mirëpo, KQZ vendosi të mos marrë ndonjë vendim zyrtar në lidhje me këtë.

Më 13 tetor, rreth orës 11:00, ambientet e Ministrisë së Infrastrukturës ku po bëhej verifikimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, u evakuuan dhe u vulosën nga Policia e Kosovës, pasi që u raportua se disa nga 26 punonjësit e KQZ-së ishin ankuar për reaksione alergjike nga trajtimi i zarfeve të ardhura nga Serbia. Sipas raporteve të policisë, nëntë persona u pranuan në spital për trajtim.³⁵ Incidenti u hetua nga Prokuroria dhe Policia e Kosovës, megjithatë, megjithatë, deri më 27 nëntor hetimi nuk kishte përfunduar dhe autoritetet nuk dhanë ndonjë informacion zyrtar në lidhje me statusin e hetimit për sa i përket kohës së rezultateve ose ekzaminimit të provave.

Gjatë mbledhjes së mbyllur të mbajtur në mbrëmjen e 13 tetorit, KQZ vendosi të zhvendosë të gjithë materialin e votimit jashtë Kosovës³⁶ në QNR. Materiali u zhvendos fizikisht në QNR dhe numërimi i 13,491 fletëvotimeve të miratuara të votimit jashtë Kosovës u bë më 16 tetor në prani të vëzhguesve të subjekteve politike dhe vëzhguesve të shoqërisë civile. Bazuar në vendimin e Sekretariatit të KQZ-së, 3,782 zarfe të kontestuara me fletëvotime përmes postës nga Serbia u

³³ LZP përcakton që fletëvotimet përmes postës për votimin jashtë Kosovës duhet të pranohen nga KQZ para ditës së zgjedhjeve.

³⁴ Verifikimi i fletëvotimeve përmes postës është organizuar tradicionalisht jashtë QNR-së, zakonisht në të njëjtat ambiente ku ishin ruajtur pakot me fletëvotimet përmes postës para ditës së zgjedhjeve. Këtë herë, nga 6 tetori deri më 1 nëntor, procesi i verifikimit u zhvillua në ambientet e Ministrisë së Infrastrukturës.

³⁵ Sipas raporteve të mediave, i gjithë stafi i KQZ-së që ishte shtrirë në spital u lirua nga spitali pas disa ditësh.

³⁶ Me përjashtim të materialit që ishte i nevojshëm për hetime të mëtejshme policore.

përpunuan përfundimisht më 23 tetor dhe në të njëjtën ditë u krye numërimi i 2,924 votave të verifikuara. Do të duhej të theksohet se para përpunimit të këtyre zarfeve, autoritetet e Kosovës nuk publikuan asnjë informacion zyrtar në lidhje me shkakun e problemeve shëndetësore të stafit të KQZ-së ose rrezikun e mundshëm shëndetësor lidhur me trajtimin e këtyre zarfeve.³⁷

Pas dy vendimeve të Gjykatës Supreme, u procesuan 6,445 dërgesa postare që mbërritën pas afatit ligjor dhe 6,709 fletëvotime të verifikuara të votimit jashtë Kosovës u numëruan midis 31 tetorit dhe 5 nëntorit. Në përgjithësi, ishin 23,345 fletëvotime përmes postës për votimin jashtë Kosovës të përfshira në rezultate fillimisht, që përfaqësojnë 2.7 për qind të të gjithë votave të hedhura. Nga 35,087 votues të regjistruar për votim jashtë Kosovës, 67 për qind morën pjesë në zgjedhje.

Rekomandimi: Të konsiderohet prezantimi i afateve më të gjata, në rast të zgjedhjeve të parakohshme, dhe masa mbrojtëse shtesë për të përmirësuar gjithëpërfshirjen dhe integritetin e procesit të votimit jashtë Kosovës. Masat mbrojtëse do të mund të përfshinin aplikimin vetëm me shkrim dhe të nënshkruar nga aplikuesi, votimin vetëm me fletëvotim të dërguar me postë në adresën postare të votuesit jashtë vendit, ose fletëvotimi i dërguar me postë të jetë i shoqëruar me konfirmimin e nënshkruar nga votuesi se fletëvotimi është plotësuar në fshehtësi dhe nga votuesi dora vetë.

IX. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Mungon besimi në saktësinë dhe besueshmërinë e listës së votuesve

Kushtetuta garanton të drejtën e votës për çdo qytetar që ka mbushur moshën 18 vjeçare. Legjislacioni i favorshëm e bën pranueshmërinë e votuesve edhe më gjithëpërfshirëse, duke i dhënë të drejtën e votës edhe jo-shtetasve, të cilët kanë të drejtën për shtetësi të Kosovës.

Kosova ka sistem pasiv për regjistrim të votuesve, ku lista preliminare dhe përfundimtare e votuesve përpilohet nga KQZ, bazuar në ekstraktin e të dhënave që e siguron Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Lista përfundimtare e votuesve u certifikua nga KQZ më 19 shtator dhe përfshiu 1,937,868 votues. Kjo shifër nuk përfshin 35,087 votues të regjistruar për votimin jashtë Kosovës. Çdo votues mund të identifikohet me anë të numrit unik personal 10-shifror të caktuar nga ARC.

Saktësia dhe besueshmëria e listës së votuesve është problem i kahmotshëm për zgjedhjet në Kosovë. Kosova ka më shumë votues të regjistruar (1.973 milion) sesa vlerësohet të jetë popullsia rezidente (1.796 milion më 31 dhjetor 2018). Kjo anomali shpjegohet pjesërisht me faktin se pjesa dërmuese e diasporës kosovare u përjashtuan nga regjistrimi i vitit 2011 për shkak të përkufizimit ligjor ekzistues të popullsisë rezidente, megjithëse ata mbeten të regjistruar në mënyrë të ligjshme

³⁷ Bazuar në udhëzimet e policisë, stafi i KQZ-së, gjatë përpunimit dhe verifikimit të fletëvotimeve përmes postës nga Serbia, kishte veshur veshje mbrojtëse që mbulonin tërë trupin, dorashka dhe maska për frymëmarrje.

në regjistrin civil, i cili shërben si bazë për listën e votuesve.³⁸ Megjithatë, në mungesë të të dhënave të besueshme për popullsinë e diasporës, nuk është e mundur të vlerësohet nëse ky shpjegim është i justifikuar.

Tutje, lista e votuesve përfshin shumë persona që kanë ndërruar jetë meqë nuk ekziston sistemi efektiv për heqjen sistematike të tyre nga lista. Analiza e listës përfundimtare të votuesve e kryer nga EU EOM³⁹ tregoi numër pamundshëm të madh të votuesve të regjistruar mbi moshën 100 (qindvjeçarë) – 3,731, ku votuesi më i moshuar është 134 vjeç. Bazuar në të dhënat e listës së votuesve, Kosova ka 1,269 qindvjeçarë për një milion banorë, d.m.th. 4.7 herë më shumë sesa vlera mesatare për dhjetë vendet e para në botë me numrin më të madh të qindvjeçarëve për një milion banorë.⁴⁰

Arsyeja kryesore për këtë situatë të pafavorshme me sa duket është fakti se barra e veprimit administrativ qëndron kryesisht te familja e personit të ndjerë, që shpesh nuk ka asnjë nxitje për të raportuar vdekjen tek autoritetet e Kosovës. Gjatë periudhës shumë të shkurtër të konfirmimit dhe kundërshtimit më 12-14 shtator, kur lista preliminare e votuesve ishte në dispozicion për kontroll publik në zyrat e KKZ-ve, votuesit gjithashtu kishin mundësinë të kundërshtojnë përfshirjen e personave të ndjerë në listë, por kjo procedurë nuk po përdoret në praktikë. Thuhet se ARC në vitin 2016 filloi bashkëpunimin me disa autoritete fetare për të përmirësuar sistemin e raportimit të vdekjeve, mirëpo, për zgjidhjen e këtij problemi është e nevojshme një zgjidhje më sistematike.

*Rekomandimi: Të përmirësohet saktësia e listës së votuesve, ndër të tjera, duke futur në përdorim një mekanizëm për heqjen sistematike të personave të ndjerë nga regjistri civil dhe më pas nga lista e votuesve.*⁴⁰

Numri i votuesve të regjistruar po rritet vazhdimisht ndërmjet zgjedhjeve meqë numri i votuesve të rinj që mbushin 18 vjet dhe numri i qytetarëve të saporegjistruar gjithnjë është më i madh se numri i përgjithshëm i votuesve të hequr nga lista e votuesve për shkak të vdekjes ose heqjes dorë nga shtetësia. Në mes të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2017 dhe 2019, numri i votuesve të regjistruar u rrit përafërsisht për 65,000.

Numri i madh i pjesëtarëve të diasporës me vendbanim të përhershëm jashtë vendit dhe i votuesve të ndjerë në listën e votuesve e bëjnë procesin e votimit në çdo cikël të zgjedhjeve të cenueshëm nga abuzimi i mundshëm. Ky rrezik zbutet disi nga masat mbrojtëse ekzistuese në sistem, siç është përbërja ndër-partiake e këshillave të vendvotimeve dhe prania e vëzhguesve të subjekteve politike dhe të shoqërisë civile në vendvotime.⁴¹

³⁸ Personat të cilët kanë munguar përkohësisht nga vendbanimi i tyre i zakonshëm për periudhë më të shkurtër se dymbëdhjetë muaj me arsye, si për punë, studim, udhëtim, trajtim mjekësor ose arsimim, do të duhej të përfshihen në regjistrimin e popullsisë dhe në popullsinë rezidente.

³⁹ Siç parashikohet në ligj, EU EOM mori nga KKZ listën përfundimtare të votuesve në format elektronik.

⁴⁰ Burimi i të dhënave: Kombet e Bashkuara, DESA Divizioni i Popullsisë, Popullsia sipas moshës dhe gjinisë (mijëra), 2015, të dy gjinitë të kombinuara, grupmosha e dëshiruar: 100+, <https://population.un.org/wpp/DataQuery/> Popullsia rezidente e vlerësuar plus popullsia e diasporës është 2.94 milionë.

⁴¹ Numri i vëzhguesve nga një subjekt i vetëm politik ose organizatë vëzhguese e shoqërisë civile që mund të jenë të pranishëm në të njëjtën kohë në një vendvotim nuk mund të kalojë dy.

Sipas rregullave të KQZ-së, kërkohet që lista e votuesve të pastrohet nga votuesit që janë privuar nga aftësia e tyre ligjore me vendim të formës së prerë të gjykatave. Kjo kërkon që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të komunikojë me KQZ-në për t'ua bërë me dije identitetin e këtyre personave. Megjithatë, nga 297 persona vetëm 112 mund të identifikoheshin, kjo për shkak të mungesës së numrit personal të identifikimit.

X. AMBIENTI I FUSHATËS

Fushatë konkurruese në pjesën më të madhe të Kosovës, ndonëse me keqpërdorim të avantazhit të subjekteve në pushtet; kishte mungesë themelore të konkurrencës në komunitetin serb të Kosovës

Liria e fushatës u respektua në një fushatë të gjallë dhe konkurruese në pjesën më të madhe të Kosovës. Një varg tubimesh intensive u mbajtën nga të gjitha subjektet kryesore politike shqiptare të Kosovës gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore. Në pothuajse pesëdhjetë tubime të vëzhguara nga EU EOM nuk pati raste të tendosjes ose të gjuhës inflamatore. Megjithatë disa parti politike raportuan vështirësi në gjetjen e hapësirës publike për vendosjen e pllakateve. U vlerësua se dy komuna nuk arritën të sigurojnë lokacione të aprovuara dhe hapësirë të barabartë për pllakatet e partive siç kërkohet, gjë që i shkoj për shtati partive më të mëdha me mundësi për të paguar për vendosjen e pllakateve në prona private.⁴²

Disa dënime të konsiderueshme financiare të shqiptuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) prekën lirinë e shprehjes dhe u dukën joproporcionale dhe të paarsyeshme. Këta kandidatë në fjalë u gjobitën për postimin e fotografive të vetvetes në faqet e tyre në Facebook, duke u takuar me policë për të ilustruar premtimet e fushatës për ligjin dhe rendin. Gjithashtu, KQZ miratoi një rregull të ndryshuar gjatë periudhës zyrtare të fushatës, e cila forcoi kufizimet rreth përdorimit të fëmijëve në fushata dhe dukej se ishte hartuar me paqartësi të konsiderueshme. Kandidatja për kryeministër nga LDK e cila i prezantoi fëmijët e saj në një tubim ndërsa ata mbanin shenja të LDK-së u sanksionua, pavarësisht se ishte e qartë se kishte dhënë pëlqim për fëmijët e saj.⁴³ Sidoqoftë më e rëndësishmja, ishte gjoba prej 30,000 EUR kundër Srpska Lista për atë që PZAP, duke përdorur interpretim të gjerë, e gjykoi si “gjuhë urrejtjeje” për reklamën me titull “*Kur Serbia thërret*”.⁴⁴

Rekomandimi: Çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të përcaktohet me ligj, të jetë i domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe të ketë për qëllim objektiva të caktuara konkrete, një prej të cilave do të mund të ishte parandalimi i trazirave apo krimit. Çdo kufizim duhet të vlejë në mënyrë të barabartë për të gjitha rastet që i plotësojnë kushtet e përcaktuara.

⁴² Kjo u vërejt nga vëzhguesit e BE-së në komunat e Glllogocit dhe Ferizajt. Mirepo, partitë nuk bënë asnjë ankesë zyrtare. Në nenin 3.3 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 thuhet: “*Autoritetet komunale duhet t'i caktojnë vendet e posaçme për ekspozimin e materialit të shtypur të zgjedhjeve...Vendet e tilla duhet të...hapësirat më të frekuentuara dhe më të dukshme në atë komunë.*”

⁴³ Siç kërkohet nga dispozitat e Rregullës nr. 20/019 që u adoptua rishtazi nga KQZ.

⁴⁴ Paneli në arsyetimin e tij vlerësoi se videoja ku thuhej “*Kur është e vështirë, vetëm së bashku fitojmë, në mbrojtje të asaj që është e jona*” dhe “*Kur Serbia thërret, unë hedh votën time*” përbënte mesazh që nxit urrejtje kundër ekzistencës së Kosovës.

Temat kryesore të fushatës ishin pretendimet e korrupsionit dhe nepotizmit, dhe marrëdhëniet e ardhshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Partitë më të mëdha përqendruan fushatat e tyre në kandidatët e tyre për pozitën e kryeministrit, dhe pati fare pak programe thelbësore të botuara. Ky përqendrim në personalitete dhe jo në politika, kufizoi aftësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të informuara mbi programet qeveritare potenciale.

Periudha zyrtare e fushatës u kufizua nga KQZ në 10 ditë në krahasim me 30 ditë për zgjedhje të rregullta, duke rezultuar në kuptime të ndryshme nga palët e interesuara mbi atë që lejohej gjatë kohëzgjatjes së periudhës para fushatës. Disa nga partitë më të mëdha filluan fushatën disa javë para fillimit zyrtar të periudhës së fushatës, gjë që u dha avantazhin e të qenit i pari.⁴⁵ Për shkak të kësaj paqartësie u zvogëluar efektet barazuese të dobishme për rregullim të fushatës.

Në disa raste pati keqpërdorim të resurseve qeveritare në nivel qendror dhe lokal në përpjekje për të realizuar avantazh politik. Për shembull, Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në largim nga PDK krijoi një fond prej 4 milionë euro për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me deri në 100,000 EUR, me kritere të paqarta të përzgjedhjes dhe ku afati për aplikime ishte dita pas zgjedhjeve. Ministria e Bujqësisë nga SLS promovoi subvencionin prej 3 milionë euro për fermerët në llogarinë e saj personale në Facebook, ku flamuri i partisë shfaqet dukshëm në video. Ndërmarrjet publike të energjisë elektrike dhe të minierave shpallën numër të madh të konkurseve të reja të punës pak para zgjedhjeve.⁴⁶ Disa komuna promovuan projektet e tyre të infrastrukturës lokale për të fituar mbështetje për kandidatët e tyre në Kuvend.⁴⁷ Tutje, ka pretendime se u ofruan ngritje në detyrë në sektorin publik, zgjatje të kontratave të përkohshme ose pozita të reja, për mbështetje nga punonjësit dhe familjet e tyre. Këto nuk janë në përputhje as me praktikat më të mira ndërkombëtare,⁴⁸ as me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike në Kosovë.⁴⁹

Rekomandimi: Të parashihet në mënyrë specifike në kornizë ligjore ndalimi i përgjithshëm i keqpërdorimit të resurseve administrative për avantazh politik nga qeveria qendrore dhe autoritetet

⁴⁵ Këto ngjarje fushate ndonjëherë u emërtuan si “takime partiake”, por kishin karakteristikat e fushatës. Për shembull, ngjarja e kryeministrit në Pejë më 17 shtator, ku të rinjë iu kërkua të nënshkruanin premtimin për mbështetje 100% të Kosovës, që ishte jehonë e sloganit të fushatës së AAK-PSD.

⁴⁶ Mediat raportuan se KEK, ndërmarrja e energjisë elektrike shpalli konkurs për 133 vende pune dhe miniera e Treptës për 230 vende pune.

⁴⁷ Për shembull, në faqen në Facebook të Komunës së Ferizajt, më 3 tetor u postua se kryetari i komunës ishte takuar me ministrin e shëndetësisë dhe kishte nënshkruar kontratë për spital të ri. Të dy, edhe ministri edhe kryetari i komunës janë nga PDK. Në të njëjtën ditë, 30 fermerëve iu dhanë pajisje bujqësore me premtime se “forma mbështetjeje për bujqit do të vijojnë të aplikohen me intensitet edhe më të lartë, ditëve e javëve në vijim.” Kryetari i Komunës së Prishtinës, i cili ishte kandidat i PSD-së për Kuvend, promovoi rinovimet e infrastrukturës në faqen zyrtare komunale në Facebook më 2 tetor. Llogaria në Facebook e Komunës së Malishevës, më 3 tetor promovoi ceremoninë e vënies së gurit themeltar të një shkolle, organizuar nga kryetari i komunës në prani të kandidatëve për Kuvend dhe zëvendës ministrit të arsimit, të gjithë përfaqësues të Nisma.

⁴⁸ Komisioni i Venedikut, Udhëzime të përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të resurseve administrative gjatë procesit zgjedhor (2016) Kapitulli B, neni 1.4 “Korniza ligjore do të duhej të përcaktojë se nuk do të duhej të ketë emërim jo-thelbësor në organet publike gjatë fushatës zgjedhore.”

⁴⁹ Rregulla Zgjedhore nr. 11/2013 Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, neni 6.2 “Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.”

komunale gjatë proceseve zgjedhore. Ndalimi të vendoset në mënyrë të qartë dhe të parashikueshme.

Ambienti i fushatës në trevat e Kosovës me shumicë serbe

Kishte mungesë të konkurrencës në trevat me shumicë serbe. Srpska Lista u mbështet theksueshëm nga qeveria e Serbisë që kishte për synim de-legjitimimin e partive tjera të serbëve të Kosovës. Partitë e opozitës patën vështirësi të zhvillojnë fushatë efektive në të gjitha komunat e Kosovës me shumicë serbe, pjesërisht për shkak të mungesës së fondeve dhe pjesërisht për shkak të pretendimeve për frikësime.⁵⁰ SLS, partia më e madhe opozitare, nuk bëri fushatë në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, PKS kishte fushatë të kufizuar kryesisht në Leposaviq, ndërsa fushata e kufizuar e Sloboda ishte kryesisht në Graçanicë dhe në internet. Vëzhguesit e EU EOM vunë në dukje se PKS dhe Sloboda nuk mbajtën tubime. Srpska Lista, nga ana tjetër, mbajti disa tubime, si në komunat veriore ashtu edhe në ato jugore me shumicë serbe. Nga katër tubimet e vëzhguara të Srpska Lista, në tre tubime pati gjuhë inflamatore. Kishte gjithashtu raporte që zyrtarëve nga Serbia u ishte refuzuar hyrja në Kosovë gjatë periudhës së fushatës.

Partitë opozitare të serbëve të Kosovës patën vështirësi në përcjelljen e mesazheve të tyre te elektorati, dhe këto vështirësi shkonin përtej mungesës së resurseve. Vëzhguesit afatgjatë vlerësuan se nëntë nga dhjetë komunat me shumicë serbe të Kosovës nuk i ofruan hapësirë të përshtatshme të gjitha partive për vendosjen e pllakateve. Në shumë pjesë kishte vetëm pllakate të Srpska Lista.⁵¹ Për marrjen e lajmeve, komuniteti serb i Kosovës kryesisht mbështetet në mediat nga Serbia dhe jo nga Kosova. Partitë e opozitës serbe në Kosovë pohuan se nuk kishin qasje të barabartë në mediat e Serbisë dhe paraqitën prova që ata ishin denoncuar nga mediat dhe nga përfaqësuesit e qeverisë së Serbisë.

Kishte raste të shumta të dokumentuara të anëtarëve të familjeve të kandidatëve nga opozita, dhe votuesve në përgjithësi, që ishin përballur me kërcënime për largim nga puna ose pezullim nga pozitat e financuara nga qeveria e Serbisë ose nga pozitat komunale.⁵² Megjithatë, u shënuan pak raste të raportimit të kanosjes fizike.⁵³ Liritë themelore të zgjedhjes dhe shprehjes në komunitetin serb të Kosovës as nuk u respektuan sa duhet nga partia udhëheqëse, as nuk u mbrojtën plotësisht nga autoritetet dhe institucionet.

⁵⁰ Në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të komunave në katër komunat me shumicë serbe në veriun e Kosovës, të mbajtura në maj 2019, nga partitë serbe të Kosovës, mori pjesë vetëm Srpska Lista. Partitë e opozitës serbe pohuan se nuk kishte kushte për zgjedhje të drejta duke pasur parasysh pasojat e vrasjes së liderit të opozitës Oliver Ivanović në janar 2018 dhe mbështetjen e qeverisë së Serbisë dhe mediave të Srpska Lista.

⁵¹ Megjithëse kishte disa raste të përdhosjes së pllakateve të Srpska Lista, shkatërrimi i pllakateve dhe billbordeve të PKS në Leposaviq u duk të jetë sistematik.

⁵² Misioni pranoi dokumente të cilat tregonin se një kandidat i SLS, një anëtar i bordit të SLS, një i afërm i një anëtarit të bordit të SLS, dhe nënat e dy kandidatëve të SLS u pezulluan ose u larguan nga vendi i tyre i punës i financuar nga Beogradi ose nga vendi i tyre i punës në komunë. Përveç kësaj, një anëtar i familjes të po të njëjtit anëtar të bordit të SLS iu dha njoftimi për dëbim nga banesa sociale. Nga ana tjetër, dy punonjës të shërbimit postar të Kosovës pohuan se ishin larguar nga puna për shkak të mbështetjes së tyre për Srpska Lista. Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë veç e veç japin fonde për pozitat e sektorit komunal dhe publik në trevat e Kosovës me shumicë serbe, por kontrolli politik në të dy rastet i është dhënë politikanëve vendas, të cilët mbizotërohen nga përfaqësuesit e zgjedhur të Srpska Lista.

⁵³ Më 4 tetor, pati konfrontim midis Srpska Lista dhe PKS në Leposaviq, me ç'rast u thirr policia. Një këshilltar i shquar i SLS pretendohet se ishte rrëmbyer dhe kërcënuar në Klllokot më 2 tetor. Në lidhje me incidentin e pretenduar, më pas u ngrit aktakuzë ndaj kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe zëvendësit të tij nga Srpska Lista.

Rekomandimi: Të drejtat themelore demokratike mund të mbrohen më fuqishëm dhe në mënyrë të menjëhershme nga autoritetet në të gjithë Kosovën për të siguruar që të drejtat e të gjithë kandidatëve, familjeve të tyre, atyre që bëjnë fushatë dhe përkrahësve, si dhe votuesve, për të marrë pjesë lirshëm në të gjitha aspektet e jetës demokratike zbatohen plotësisht. Qytetarët mund të kenë më shumë informacion se si të ankohen pranë autoriteteve përkatëse për pretendimet e frikësimit zgjedhor.

Ambienti i fushatës në komunitetet tjera jo-shumicë

Kushtetuta garanton vende për komunitetet në proporcion me popullsinë e tyre. Kjo krijon kornizën në të cilën shumë votues përcaktohen të zgjedhin përfaqësues nga komuniteti i tyre. Ndërsa kjo zvogëlon konkurrencën zgjedhore midis komuniteteve, ajo mund të rrisë rivalitetet lokale, gjë që ishte veçori e kësaj fushate. Fushata derë më derë, në internet dhe në media sociale ishte metoda kryesore e informimit të votuesve për politikën e partive, të cilat përgjithësisht u përqendruan në zhvillimin ekonomik për komunitetet e tyre.

Më shumë se 120 kandidatë nga tre subjekte politike dhe një kandidat i pavarur garuan për tre vende të garantuara për komunitetin boshnjak, i cili është kryesisht i përqendruar në Prizren.⁵⁴ Komuniteti goran pati fushatë të ashpër që u zhvillua midis tri partive, ku pati pretendime për praktika të ngjashme, mbase më pak të rënda, si ato që prekën komunitetin serb të Kosovës.⁵⁵ Kishte njëfarë tensioni midis partive të komunitetit boshnjak dhe atij goran gjatë fushatës, ku partia më e madhe boshnjake akuzoi liderin e partisë më të madhe gorane për gjuhë të urrejtjes.⁵⁶ Në të dy këto komunitete, debati kryesor për politikën afatgjatë, i përsëritur në këtë fushatë, ishte për krijimin e statusit komunal për komunitetet boshnjake dhe gorane. Secili nga tre komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kishte dy parti në garë në këto zgjedhje.⁵⁷ Këto fushata u karakterizuan si nga rivaliteti ndërmjet komuniteteve ashtu edhe brenda komunitetit, me konkurrencë veçanërisht të tensionuar midis partive egjiptiane në Pejë. Vetëm një parti turke mori pjesë në zgjedhje, por me 30 kandidatë për dy vende të garantuara, votuesve iu siguria deri diku hapësirë për të zgjedhur.⁵⁸

XI. FINANCIMI I FUSHATËS

Mungon transparenca për të ardhurat dhe shpenzimet e partive, në një kornizë zgjedhore joadekuate

Financimi i partive dhe fushatave rregullohet me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike

⁵⁴ Koalicioni Vakati, Partia e Re Demokratike (NDS), Partia e Veprimit Demokratik (SDA) dhe Esmir Kasi.

⁵⁵ Partia e Bashkuar Gora (JGP), Iniciative Qytetare Gora (GIG), Lëvizja për Gorën (PG).

⁵⁶ PZAP gjykoj se ankesa e Koalicionit Vakati kundër JGP ishte e pabazuar - por incidenti ilustroi qartë tensionin midis subjekteve.

⁵⁷ Partia Rome e Bashkuar Kosovës (PREBK), Partia e Re Rome e Kosovës (KNRP) për romët, Partia e Ashkalive për Integritim (PAI), Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) për ashkalitë, Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Iniciative e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) për komunitetin egjiptian.

⁵⁸ Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP).

(LFSP) të vitit 2010, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LPZ) të vitit 2008 dhe rregullat e KQZ-së.⁵⁹ Në janar 2019, Kuvendi nuk arriti të adoptojë projektligjin e ri për financimin e partive politike, i cili ishte vlerësuar si “hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur”.⁶⁰ Korniza ligjore aktuale parashikon kufizime për donacione dhe shpenzime, kërkesa për raportim dhe deklarim, mbikëqyrje dhe sanksione për parregullsi. Sidoqoftë, ajo përmban disa mangësi, boshllëqe, mospërputhje dhe paqartësi. Në përgjithësi, Korniza rregullative nuk siguron raportim të plotë, shpalosje me kohë, mbikëqyrje dhe përgjegjësi domethënëse për parregullsitë.⁶¹ Shumë bashkëbisedues të EU EOM shprehën shqetësime lidhur me interesat e ndërthurura politike dhe financiare që i bëjnë partitë në pushtet llogaridhënëse ndaj interesave të të pasurve dhe rezultojnë në keqpërdorim të buxhetit për prokurimin publik.

Të ardhurat dhe shpenzimet

Subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend marrin fonde publike që alokohen çdo vit, proporcionalisht me numrin e ulëseve që kanë.⁶² Ligji parashikon fonde publike shtesë për zgjedhje, nga të cilat 10 për qind janë paraparë të alokohen për subjektet politike pa përfaqësues në Kuvendin në largim. Sidoqoftë, kjo nuk është e detyrueshme dhe nuk pati alokim të tillë nga Kuvendi për këto zgjedhje ose çfarëdo zgjedhje të mëparshme.

Të gjitha subjektet politike gjithashtu mund të financohen nga aktivitetet e tyre si persona juridikë jofitimprurës, tarifatat e anëtarësimit partiak dhe donacionet private. Një individ mund të japë donacion për një subjekt të vetëm politik deri në 2,000 EUR në vit, ndërsa një person juridik mund të japë donacion deri në 10,000 EUR. Pavarësisht nga kjo, nuk ka asnjë mekanizëm për të identifikuar nëse shumat e përgjithshme të donacioneve nga një donator i vetëm e ka tejkaluar kufirin e lejuar. Donacionet mund të jenë monetare ose në natyrë, gjegjësisht mallra ose shërbime falas ose nën vlerën e tregut, por nuk ka ndonjë metodologji për vlerësimin e donacioneve në natyrë. Bashkëbiseduesit e EU EOM, përfshirë kandidatët, shoqërinë civile dhe autoritetet, informuan misionin se donacionet bëhen shpesh me para të gatshme dhe në natyrë.

Ekzistojnë gjithashtu ndalime për burime të caktuara të donacioneve, përfshirë burimet e huaja dhe anonime, organizatat joqeveritare, bamirëse dhe fetare, ndërmarrjet publike dhe kompanitë private me kontrata të prokurimit publik. Subjekteve politike u kërkohet t'i kthejnë donacionet e ndaluara te donatorët dhe t'i depozitojnë donacionet anonime në buxhetin e Kosovës. Ato gjithashtu duhet

⁵⁹ Rregullat Zgjedhore të KQZ-së nr. 12/2013 për kufirin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimin financiar dhe nr. 14/2015 për financimin e subjekteve politike dhe sanksionet.

⁶⁰ Shih Mendimi i Komisionit të Venedikut 922/2018 për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike. Ky projektligj kaloi leximin e parë në Kuvend, por ai u ndryshua në mënyrë drastike dhe në fund u tërhoq.

⁶¹ Shih Rekomandimi (2003)4 i Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, “Për rregullat e përbashkëta kundër korrupsionit në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore”.

⁶² Në vitin 2019, 4.2 milionë euro u ndanë për 13 subjekte politike në katër pagesa tremujore. Gjegjësisht, EUR 1,365,000 për PAN (PDK, AAK, Nisma), EUR 1,120,000 për VV, EUR 1,015,000 për LAA (LDK dhe AKR), EUR 315,000 për Srpska Lista, nga EUR 70,000 për secilën KDPT dhe Koalicionin Vakrat dhe nga EUR 35,000 për secilën nga shtatë partitë tjera jo-shumicë.

ta njoftojnë KQZ-në brenda 15 ditëve.⁶³ Sidoqoftë, nuk ka asnjë mekanizëm për verifikimin e pajtueshmërisë me këtë ndalim. Ligji gjithashtu ndalon ushtrimin e presionit dhe premtimin e privilegjeve ose përfitimeve të paligjshme për donatorët. Ndërsa ka pak ngritje fondesh në nivelin bazë, shumë bashkëbisedues të EU EOM, përfshirë autoritetet, shoqërinë civile dhe subjektet politike, thanë se partitë në pushtet mbështeten te donatorët e mëdhenj të korporatave duke i kompensuar ata me kontrata të prokurimit publik që rezultojnë në pasurim të ndërsjellë.⁶⁴

Rekomandimi: Të vendoset një mekanizëm efektiv për verifikimin e ligjshmërisë së donacioneve. Mekanizmi i tillë mund të përfshijë mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe do të duhej të mundësojë kontrollin e gërshetuar të donatorëve kundrejt databazës së kontraktuesve të prokurimeve publike dhe të identifikojë donacionet e shumëfishta nga një donator i vetëm.

Një subjekt politik mund të shpenzojë deri në 0.5 EUR për votues të regjistruar që arrin në 986,233 EUR në mbarë Kosovën.⁶⁵ Ligji parashikon që të gjitha shpenzimet e bëra për qëllime fushate duhet të raportohen madje edhe nëse ato janë bërë para thirrjes së zgjedhjeve. Megjithatë, sipas një interpretimi të gabuar të ligjit, KQZ dhe disa parti kufizuan raportimin vetëm për shpenzimet e bëra gjatë 10 ditëve të fushatës zyrtare, gjë që në mënyrë të konsiderueshme uli transparencën dhe llogaridhënien. Bashkëbiseduesit e EU EOM vunë në pah se palët ngurrojnë të raportojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e tyre për shkak të ligjshmërisë së tyre të dyshimtë. Nuk ka kërkesë ligjore për të përfshirë imprint me informacione mbi numrin e kopjeve, botuesin dhe pagesin në materialet e shtypura të fushatës, gjë që nuk e garanton gjurmimin e këtyre shpenzimeve.

Rekomandimi: Të gjitha materialet e shtypura dhe dixhitale të fushatës duhet të etiketohen qartë me informacione rreth organizatës sponsorizuese dhe të japin përshkrim të sanksioneve për mospërmblidhje dhe moszbatimin efektiv.

Raportimi dhe deklarimi

Çdo subjekti politik i kërkohet me ligj që të gjitha të ardhurat t'i marrë dhe të gjitha shpenzimet t'i kryejë me transferim bankar përmes një llogarie bankare partiake të vetme. Pavarësisht nga kjo, një numër i konsiderueshëm i transaksioneve të fushatave anashkaluan llogarinë e vetme bankare dhe mbase mbetën të paraportuara. Përkatesisht, shumë kandidatë informuan se kishin marrë kontribute individuale, shfrytëzuan fondet e veta dhe bënë vetë pagesat. Përveç kësaj, disa bashkëbisedues të EU EOM deklaruan se donacionet dhe pagesat e bëra me para të gatshme ose në natyrë shpesh

⁶³ KQZ informoi për një rast të donacionit që i ishte kthyer donatorit në të kaluarën.

⁶⁴ Përafërsisht 25% e buxhetit vjetor të Kosovës prej 2 miliardë euro alokohet për prokurim publik. Bashkëbiseduesit thanë se, që nga zgjedhjet e fundit, duke mos qenë në gjendje ta parashikojnë fituesin, kompanitë e mëdha shpesh i japin donacione më shumë se një partie udhëheqëse.

⁶⁵ Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017, LDK raportoi shpenzime që arritën në EUR 899,880, PDK-EUR 330,775, VV-EUR 304,226, Nisma-EUR 58,021, Srpska Lista-EUR 62,854, KDTP EUR-26,804 dhe AAK nuk raportoi. Për zgjedhjet komunale të vitit 2017, LDK raportoi EUR 878,225, PDK-EUR 266,252, VV-EUR 576,930, AAK-EUR 252,112, Nisma EUR 51,712, Srpska Lista EUR 67,050, KDTP EUR 32,647.

mbeten të paraportuara. Kishte gjithashtu disa raste të bërjes së fushatës nga palët e treta nga organizata të lidhura me subjektet politike, gjë që nuk është e rregulluar me ligj.⁶⁶

Subjektet politike janë të detyruar të paraqesin raporte të financimit të fushatës në KQZ vetëm pas ditës së zgjedhjeve brenda 45 ditëve, gjë që nuk ofron transparencë dhe mbikëqyrje para ditës së zgjedhjeve. Ndërsa ligji kërkon që subjektet politike të publikojnë raportet e tyre financiare në uebsajtet e tyre, shumica e partive nuk e bëjnë këtë. Për shembull, PDK, AKR dhe partia PDAK nuk kanë publikuar ndonjë raport në të kaluarën, ndërsa VV, Nisma dhe KDTP kanë publikuar shumicën e tyre dhe LDK ka publikuar disa raporte. VV gjithashtu ka publikuar shumicën e raporteve të auditimit. Shumica e subjekteve politike nuk kanë uebsajte zyrtare dhe për këtë arsye nuk mund të publikojnë raportet e tyre ashtu siç kërkohet me ligj. Nga subjektet politike kërkohet të publikojnë raportet e tyre vjetore deri në korrik dhe raportet e tyre të financimit të fushatës brenda gjashtë muajve nga dita e zgjedhjeve, gjë që nuk siguron shpalosje me kohë.⁶⁷ Meqë raportet paraqiten me shabllonin e standardizuar nga KQZ, shablloni nuk kërkon informacion të zbërthyer dhe nuk publikohet në mënyrë lehtësisht të arritshme.⁶⁸

Rekomandimi: Të përcaktohet me ligj raportimi i ndërmjetëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të garuesve gjatë periudhës së fushatës, si dhe raportimi përfundimtar brenda 30 ditëve nga dita e zgjedhjeve. Raportimi do të duhej të përfshijë financat e kandidatëve të propozuar nga partitë dhe subjektet që bëjnë fushatë për garuesit (palë të treta). Ligji të përcaktojë një afat të shkurtër për autoritetet e mbikëqyrjes dhe subjektet politike për publikimin e të gjitha raporteve financiare në mënyrë lehtësisht të arritshme.

Mbikëqyrja dhe sanksionet

Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike (në tekstin e mëtejshmë Komisioni), është i detyruar ta eksternalizojë shërbimin e auditimit të raporteve financiare tek auditorët e certifikuar të jashtëm. Shumë bashkëbisedues të EU EOM shprehën shqetësime në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit dhe mungesën e kapacitetit të Komisionit për të kryer rolin e tij mbikëqyrës.⁶⁹ Ligji kërkon që auditimi të përfundojë brenda 75 ditëve nga paraqitja e raporteve financiare. Mirëpo, në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, auditorët mund të emërohen vetëm në vitin vijues pas zgjedhjeve dhe kështu auditimi për këto zgjedhje nuk mund të përfundojë përpara qershorit 2020.⁷⁰ Shumë bashkëbisedues të EU EOM shprehën shqetësime rreth efektivitetit të këtij auditimi të vonë. Auditorëve u kërkohet të verifikojnë përmbajtjen e raporteve financiare, por jo të identifikojnë të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara, gjë që kufizon fushëveprimin e

⁶⁶ Gjegjësisht, ka pasur fushata dixhitale negative të palëve të treta të sponsorizuara (me pagesë) në disa llogari në Facebook me përkatësi të panjohur. Ligji përcakton që palët e treta nuk mund të bëjnë donacione për subjektet politike.

⁶⁷ Subjekteve politike u kërkohet që këto t'i mbajnë të publikuara për të paktën një vit.

⁶⁸ Si KQZ ashtu edhe partitë publikojnë kopjet e skanuara të raporteve financiare.

⁶⁹ Komisioni nuk arriti t'i emërojë auditorët për shkak të tenderëve publikë të pasuksesshëm. Si rrjedhojë, raportet nga 2013 deri në 2016 u audituan në vitin 2017. Raportet e vitit 2018 nuk janë audituar ende.

⁷⁰ Ligji parashikon që thirrja për emërimin e auditorëve, si për raportet financiare vjetore ashtu edhe për financimin e fushatës në një vit të rregullt zgjedhor, publikohet në janar dhe përfundon në mars.

mbikëqyrjes. Në të kaluarën, raportet e auditimit identifikuan pasaktësi në shumë raporte financiare të partive, por nuk u shqiptuan sanksione.⁷¹

Nga KQZ kërkohet të marrë dhe të publikojë raportet financiare vjetore dhe të financimit të fushatës së subjekteve politike në uebsajtin e saj.⁷² Në një interpretim të ngushtë të ligjit, KQZ i publikon këto raporte vetëm pas auditimit, gjë që vonon edhe më tej shpalosjen.⁷³ KQZ gjithashtu është e detyruar të publikojë regjistrin e donatorëve, me informacione për të gjitha donacionet e bëra për subjektet politike, por nuk ka afate kohore për ta bërë këtë dhe ky regjistër nuk është publikuar ende. Sipas ligjit, KQZ mund të shqiptojë sanksione për parregullsi, duke përfshirë mosparaqitjen e raportit financiar dhe keqpërdorimin e resurseve publike për fushatë. Mirëpo, KQZ ka resurse të pamjaftueshme dhe ligji nuk i jep asnjë kompetencë hetimore për të identifikuar parregullsitë. Për më tepër, disa bashkëbisedues të EU EOM mendojnë se sanksionet ekzistuese (kryesisht gjoka që shkojnë nga 1,000 deri në 5,000 EUR) nuk janë dekurajuese dhe efektive në krahasim me shumat në fjalë në fushën e financimit të partive. Tutje, partive nuk u janë shqiptuar sanksione për mospublikimin e raporteve të tyre financiare në uebsajtet e tyre ose për parregullsitë e identifikuara nga auditorët.

Rekomandimi: Auditimi i financave të partive dhe fushatave të përfshijë identifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të paraportuara. Të vendoset një mekanizëm efektiv për monitorimin dhe vlerësimin e vlerës së shpenzimeve të fushatës, përfshirë fushatën mediale dhe dixhitale.

Rekomandimi: Të sigurohet krijimi i mekanizmit të pavarur për mbikëqyrje efektive të financave të partive dhe fushatave, të cilit i është dhënë mandati, autoriteti, si dhe resurset financiare dhe njerëzore për të monitoruar në mënyrë efektive dhe pro-aktive, për të hetuar pretendimet për parregullsi të financimit të fushatës dhe për të shqiptuar sanksione.

XII. MEDIAT

Mediat dhe rrjetet sociale i mundësuan votuesve qasje në informacion mbi pikëpamjet e ndryshme politike, por mbulimi i përgjithshëm i zgjedhjeve në mediat audio-vizive u karakterizua me përdorim të gjerë të përmbajtjes me pagesë nga subjektet politike, gjë që cenoi fushë-lojën e barabartë.

Kosova përfiton nga një mjedis pluralist dhe i gjallë mediatik. Burimet kryesore të informacionit janë televizioni, mediat online dhe rrjetet sociale, veçanërisht për të rinjtë që përbëjnë pjesë të madhe

⁷¹ Pasaktësitë e identifikuara përfshinin mungesën e dokumentacionit mbështetës, përfshirë faturat dhe kontratat e qiradhënies dhe punësimit, mospërputhjet midis të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara dhe shumave në fatura, etj.

⁷² Neni 19 i LFSP kërkon që KQZ të publikojë raportet financiare vjetore së bashku me raportet përfundimtare të auditimit deri më 30 qershor të çdo viti. Neni 43 i LZP kërkon që KQZ të publikojë raportet e financimit të fushatës, pa përmendur konkluzionet e auditimit, dhe nuk përcakton ndonjë afat kohor.

⁷³ KQZ publikoi raportet financiare nga 2013 deri në 2017, me raportet e auditimit, në qershor 2019.

të popullsisë.⁷⁴ Transmetuesi publik Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka katër TV kanale dhe dy radio stacione; si dhe një faqe për lajme në internet dhe një faqe në Facebook. Anëtarët e Bordit të RTK-së zgjedhen me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi i Kosovës, gjë që mund të çojë në një bord të emëruar nga shumica në pushtet në Kuvend, bashkëbiseduesit gjithashtu shprehën shqetësime lidhur me procesin e përgjithshëm të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit.⁷⁵ Përveç kësaj, transmetuesi publik kryesisht mbështetet në buxhetin që ndahet nga Kuvendi, gjë që pengon më tej pavarësinë e tij të plotë.⁷⁶ Një projektligj i cili adreson pjesërisht këto mangësi u paraqit në Kuvendin e Kosovës në maj të vitit 2019, por miratimi nuk u përfundua deri në shpërbërjen e tij.

Rekomandimi: Të merret në konsideratë forcimi i pavarësisë së transmetuesit publik nga ndërhyrjet e mundshme politike, duke rishikuar procesin e përzgjedhjes së bordit të tij, si dhe sistemin e tij të financimit.

Përveç kanalit të parë televiziv publik, *RTK1*, janë pesë kanale private televizive, të cilat thuhet se kanë audienca të konsiderueshme: *RTV21*, *Kohavision (KTV)*, *Klan Kosova*, *T7* dhe *TV Dukagjini*.⁷⁷ Ndër mediat më të popullarizuara të lajmeve në internet janë *telegrafi.com* dhe *gazetaexpress.com* në gjuhën shqipe, dhe *Kossev.info* në gjuhën serbe. Bashkëbiseduesit e EU EOM raportuan se ekziston numër i konsiderueshëm i mediave online të lajmeve që u mungon profesionalizmi, nuk e bëjnë të ditur kush është pronar i tyre dhe shpesh ripublikojnë lajme të prodhuara nga media të tjera pa përmendur burimin, ose publikojnë informata çorientuese dhe të paverifikuara. Ato pak gazeta ditore që aktualisht botohen në Kosovë kanë tirazh shumë të kufizuar. Rrjeti social kryesor në Kosovë është Facebook (FB), Instagram është më pak i popullarizuar dhe nuk përdoret shumë për qëllime politike, ndërsa Twitter ka numër shumë të kufizuar të përdoruesve, dhe nuk luajti rol të rëndësishëm.

Peizazhi mediatik kosovar mbetet i ndarë në mes të komuniteteve shqipfolëse dhe serbishtfolëse, me pothuajse asnjë ofrues të shërbimeve mediale në të dy gjuhët. Burimi kryesor i informacionit për serbët e Kosovës janë kanalet televizive nga Serbia dhe në një masë më të vogël disa media lokale në gjuhën serbe. Ekziston një kanal televiziv kabllorik i transmetuesit publik, *RTK2*, i cili transmeton programe në serbisht dhe gjuhë të tjera jo-shumicë, por nuk është i arritshëm në katër

⁷⁴ Deri më 31 mars 2017, 80.4 për qind e popullsisë kishin qasje në internet sipas [Internet World Stats](#), ku gjithashtu raportohet se deri në dhjetor 2018 kishte 910,000 përdorues të Facebook, që përbëjnë rreth gjysmën e popullsisë. Deri në janar 2019, Instagram kishte rreth 600,000, dhe Twitter rreth 65,000 përdorues ([Hootsuite Global Digital Digital 2019](#)).

⁷⁵ Në tetor 2019, Bordi i RTK numëronte gjashtë anëtarë nga njëmbëdhjetë. Nga dhjetori i vitit 2019, dy anëtarë të tjerë do të mbarojnë mandatin e tyre dhe në mungesë të emërimeve të reja, Bordi nuk do të ketë kuorumin prej gjashtë anëtarëve për të marrë vendime.

⁷⁶ Ligji për RTK (2012) në nen. 21.4 përcakton që për një periudhë transitore, deri trevjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK i ndahet 0.7 për qind e të hyrave nga Buxheti i Kosovës. Periudha e përkohshme ka skaduar, por RTK është akoma e varur nga Buxheti i Kosovës, dhe menaxhmenti i RTK e ka informuar EU EOM se në vitin e fundit transmetuesi publik nuk e ka marrë shumën e plotë të buxhetit të përcaktuar me ligj.

⁷⁷ Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës (AMPEK) informoi EU EOM se nuk ka organizata që botojnë raporte për audiencën e transmetuesve në Kosovë.

komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.⁷⁸

Korniza ligjore për media dhe liria e mediave

Korniza ligjore ofron masa mbrojtëse të shëndosha për lirinë e mediave. Kushtetuta e Kosovës e garanton “*lirinë dhe pluralizmin e mediave*” dhe e ndalon censurën. Shpifja nuk është vepër penale, dhe legjislacioni përfshin ligje për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, ligje që lejojnë qasje në informacionet publike dhe ligje që mbrojnë informatorët.⁷⁹ Sidoqoftë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Serbisë (UNS) në Kosovë treguan se hetimi dhe ndjekja penale nga gjyqësori për kërcënimet e izoluara ndaj gazetarëve, të cilat ende po ndodhin, është proces tepër i ngadaltë dhe nganjëherë i paefektshëm.⁸⁰ Thuhet se profesionistët e mediave gjithashtu përballen me vështirësi në qasje në informata publike dhe ndonjëherë ushtrojnë vetë-censurim. Bashkëbiseduesit e EU EOM nga sektori i mediave raportuan se liria e mediave që mbulonin zgjedhjet është respektuar kryesisht, me disa përjashtime në komunat me shumicë të serbëve të Kosovës, ku disa mediat nga Serbia dhe një faqeje të lajmeve në internet të serbëve të Kosovës i ishte kufizuar përkohësisht mbulimi i lirshëm i zgjedhjeve.⁸¹

Mediat e transmetuara rregullohen me aktet nënligjore të nxjerra nga organi rregullues i mediave audio-vizive, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM). Ligji për KPM (2012) përkufizon përgjegjësitë e tij, të cilat përfshijnë krijimin dhe zbatimin e politikave dhe rregullave të transmetimit, si dhe sanksionimin e transmetuesve që nuk e respektojnë ligjin. Bordi i KPM-së dhe anëtarët e Bordit të Ankesave emërohen me shumicë të thjeshtë nga ana e Kuvendit të Kosovës.⁸² Në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare, mediat online nuk ka nevojë të marrin licencë për veprim, dhe së bashku me median e shkruar mbështeten në mekanizëm vetërregullues vullnetar të udhëhequr nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).⁸³ Platformat sociale, përfshirë edhe Facebook, nuk kanë detyrime nga ndonjë legjislacion specifik.

⁷⁸ Gjithashtu, kanali kryesor televiziv publik, RTK1, është i detyruar me Ligjin për RTK që të transmetojë 15 për qind të programeve të tij në gjuhë jo-shumicë.

⁷⁹ Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (2012), Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë (2013), Ligji për Qasje në Dokumente Publike (2019), Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (2018).

⁸⁰ Deri në tetor 2019, për këtë vit, AGK raportoi 11 sulme kundër gazetarëve: 4 sulme të lehta fizike dhe 7 sulme verbale.

⁸¹ Asociacioni UNS, për shembull, pohoi se më 4 tetor, një ekip gazetarësh nga Radio Beogradi ishte mbajtur në ndalim në një stacion policie në Mitrovicën e Jugut për gjashtë orë pa arsye. Uebfaqja e serbëve të Kosovës për lajme Kossev.info pohoi se kishte rënë viktimë e sulmit kibernetik, ku si rrjedhojë uebfaqja nuk ishte funksionale për disa orë në ditën e zgjedhjeve.

⁸² Gjatë fushatës zgjedhore, dy nga tri pozitat e gjyqtarëve që përbëjnë Bordin e Ankesave ishin të lira meqë gjyqtarët e rinj nuk ishin emëruar nga Kuvendi, pas skadimit të mandatit të atyre të mëparshëm, kështu që Bordi i Ankesave nuk ishte funksional.

⁸³ Shih Deklaratën e Përbashkët të 2011 për lirinë e shprehjes dhe internetin. KMSHK e ndryshoi Statutin e vet në prill 2019 për të përfshirë plotësisht mediat online në mekanizmin e vetërregullimit. Në tetor të vitit 2019, KMSHK përbëhej nga 35 anëtarë (4 gazeta dhe 31 media online). Numri i përgjithshëm i mediave online të lajmeve që veprojnë në Kosovë është i panjohur, por shumica e tyre nuk e kanë adoptuar Kodin e Etikës të nxjerrë nga KMSHK.

Rregullimi i fushatave mediale

Mbulimi medial i fushatës zgjedhore rregullohet kryesisht nga LZP, i cili kërkon, *ndër të tjera*, që mediat audio-vizive t'u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara mbulim të drejtë dhe të paanshëm. Ai gjithashtu parashikon sasi minimale minutash të kohës për emetim falas për të gjithë garuesit në të gjitha mediat që pranojnë reklamim me pagesë, megjithëse u lihet këtyre transmetuesve të vendosin se kur dhe në çfarë forme e japin kohën e emetimit falas.⁸⁴ Gjatë fushatës lejohet përmbajtja me pagesë me kusht që të identifikohet qartë si e tillë dhe kush e ka paguar.⁸⁵ Ndërsa një akt nënligjor i KPM-së përcakton tavanin prej 20 për qind për spote reklamimi, përfshirë spotet politike me pagesë, nga të gjitha programet në kohën e shikueshmërisë më të madhe në kanalet televizive private; ky tavan nuk vlen për llojet e tjera të përmbajtjes politike me pagesë në mediat e transmetimit.⁸⁶ Udhëzimet e LZP dhe KPM gjithashtu kërkojnë që transmetuesit të dorëzojnë çdo javë në KPM 'ditarë' me informacione të hollësishme për kohën e siguruar pa pagesë dhe kohët për reklamim që i janë shitur çdo subjekti politik, bashkë me çmimoret e tyre.⁸⁷

Kanalet kryesore televizive filluan mbulimin e aktiviteteve zgjedhore të partive politike dhe mbajtën debate televizive pas shpalljes së zgjedhjeve nga presidenti, pra shumë përpara fillimit të fushatës zyrtare zgjedhore. EU EOM vërejti raste të izoluara të shkeljeve nga kanalet televizive private, të cilat emetuan disa programe dhe spote reklamimi me pagesë nga subjektet politike para periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore.⁸⁸ KPM bëri monitorim sistematik të mediave të transmetuara vetëm gjatë dhjetë ditëve të fushatës zyrtare zgjedhore të rregulluar nga LZP. Pavarësisht se KPM është organ përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore të mediave, përfshirë ato që kërkojnë nga transmetuesit të ofrojnë mbulim editorial të drejtë dhe të ekuilibruar në çdo kohë dhe që ndalojnë emetimin e çdo përmbajtjeje politike me pagesë jashtë fushatës zgjedhore, KPM nuk e zgjeroi monitorimin për të përfshirë periudhën para periudhës së

⁸⁴ Televizionit publik dhe radio stacioneve u kërkohej të sigurojnë minimum 40 dhe 30 minuta respektivisht për secilin garues, ndërsa transmetuesve privatë u kërkohej të ofrojnë numër minimal të minutave të kohës për emetim falas që shkojnë nga 10 deri në 20 minuta, bazuar në shtrirjen gjeografike të transmetuesve. Gjatë periudhës së monitoruar, kanalet televizive ofruan qasje falas në kohë emetimi, por përveç subjekteve politike që përfaqësojnë komunitete jo-shumicë, pati interesim të kufizuar të garuesve për ta shfrytëzuar këtë mundësi.

⁸⁵ Gjatë fushatës zgjedhore, subjektet politike mund të blejnë nga media transmetuese spote politike që nuk mund të jenë më të gjata se 120 sekonda, ose ata mund të blejnë kohë emetimi për të transmetuar video përmbajtje të prodhuar nga vetë ata, kjo mund të përfshijë mbulim të regjistruar ose drejtpërdrejt nga aktivitetet e tyre të fushatës si dhe video promovuese.

⁸⁶ Rregullore për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, akti nënligjor 2017/07 i KPM, neni 11.2 "[...] komunikimet komerciale të cilat transmetohen nga ora 18:00 deri në ora 24:00, ku televizioneve komerciale u lejohet të transmetojnë spote të reklamimit televiziv [...] deri në 20% të vëllimit të përgjithshëm të programit të transmetuar gjatë kësaj periudhe kohore."

⁸⁷ Udhëzues i KPM për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019: "Të licencuarit (ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale), sipas nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje nr. 03/L-073, do t'i vënë në dispozicion të KPM oraret e transmetimit përmes Ditarëve, në të cilët regjistrohen koha e emetimit me dhe pa pagesë. Së bashku me Ditarë, të licencuarit do të paraqesin edhe çmimoren e reklamimit të aplikuar prej tyre gjatë gjashtë muajve të fundit."

⁸⁸ Rregullore për komunikimet audiovizuale komerciale, akti nënligjor 2017/07 i KPM, nen. 2.2. "Komunikimet komerciale audiovizuale politike lejohen vetëm gjatë fushatave zgjedhore, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret relevante." nen. 14.6 "Ndalohet reklamimi i partive politike, koalicionëve dhe anëtarëve të pavarur të organeve përfaqësuese, përveç gjatë kohës së promovimit zgjedhor në pajtim me një akt të veçantë"

fushatës zgjedhore, duke pohuar se ka resurse të kufizuara financiare dhe njerëzore për t'i përballuar përgjegjësitë e veta.⁸⁹ Duke marrë parasysh periudhën shumë të shkurtër të fushatës zgjedhore, mungesa e mbikëqyrjes efektive nga KPM-ja ndaj sjelljes së mediave para fillimit të fushatës cenoj masat mbrojtëse për parimin e fushë-lojës së barabartë para zgjedhjeve.

Rekomandimi: KPM të forcojë mbikëqyrjen e akteve nënligjore ekzistuese për mediat për të siguruar që transmetuesit ofrojnë mbulim të ekuilibruar dhe nuk transmetojnë përmbajtje politike me pagesë jashtë periudhës së fushatës zgjedhore.

Para dhe gjatë fushatës zgjedhore, KPM informoi transmetuesit dhe publikun për rregullativat e mediave gjatë fushatës zgjedhore, përmes një punëtorie, përmes udhëzuesit që iu dërgua të gjithë transmetuesve, me njoftime për shtyp dhe intervista të përfaqësuesve të KPM-së në kanalet kryesore televizive. Gjatë fushatës zgjedhore, KPM monitoroi 17 kanale televizive duke vërejtur shkelje të shumta dhe të përsëritura të ligjit, shumica në lidhje me përmbajtjen me pagesë që nuk ishte identifikuar si e tillë, pastaj duke zbuluar reklama, përfshirë ato politike, brenda programeve të aktualitetit dhe duke zbuluar kanale televizive që nuk ofronin mbulim të ekuilibruar të garuesve.⁹⁰ Sidoqoftë, organi rregullues nuk ka sanksionuar ose korrigjuar asnjë shkelje gjatë fushatës zgjedhore, duke pretenduar se e ka për detyrë të kryejë procedura të gjata të brendshme që nuk e lejojnë të reagojë me kohë. Vetëm pas zgjedhjeve, KPM sanksionoi 11 kanale televizive me dënime që shkojnë nga dhënia e vërejtjes e deri në 4,000 EUR gjobë. Shkelje të ngjashme u zbuluan në zgjedhjet e mëparshme dhe u pasuan me vërejtje ose gjoba të ngjashme, të shqiptuara pas ditës së zgjedhjeve.⁹¹ Kjo tregon se procesi i vendimmarrjes në KPM as nuk është efektiv, as nuk parandalon ose korrigjon shkeljet gjatë fushatës zgjedhore, as edhe nga një cikël i zgjedhjeve në tjetrin. Bashkëbiseduesit e EU EOM bënë me dije që shuma financiare e gjobave të shqiptuara nuk është e mjaftueshme për t'i frenuar transmetuesit të mos shkelin ligjin.

Rekomandimi: Të rishikohet procesi i vendimmarrjes në KPM në mënyrë që të adresojë shkeljet dhe ankesat me kohë, veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore, dhe të zbatojë sanksione dekurajuese.

Monitorimi i mediave nga EU EOM

Ambienti pluralist dhe i gjallë i mediave i mundësoi votuesve qasje në pikëpamje të larmishme politike. Monitorimi i mediave nga EU EOM tregoi që kanali televiziv publik *RTK1* gjatë periudhës zyrtare të fushatës, në programet e tij të lajmeve ofroi mbulim kryesisht të ekuilibruar të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend dhe organizoi debate gjithëpërfshirëse zgjedhore.⁹² Megjithatë,

⁸⁹ Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, akti nënligjor 2016/03 i KPM, nen. 6.2.2. "OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënies politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ."

⁹⁰ KPM informoi EU EOM se nuk ka marrë asnjë ankesë lidhur me mediat gjatë periudhës së zgjedhjeve.

⁹¹ Pas raundit të parë të zgjedhjeve komunale dhe për kryetarë të komunave 2017, nëntë transmetues u sanksionuan me dënime që shkonin nga dhënia e vërejtjes e deri në 5,000 EUR.

⁹² Në periudhën midis 14 shtatorit dhe 6 tetorit 2019, EU EOM kreu monitorim cilësor dhe sasior të gjashtë kanaleve televizive (RTK1, RTK2, RTV21, KTV, Klan Kosova dhe T7) nga ora 17:00 deri në 01:00 çdo ditë, si dhe të edicionit

në dhjetë ditët para fillimit të fushatës zgjedhore, kanali televiziv publik ofroi mbulim të konsiderueshëm për Kryetarin e Parlamentit dhe Ministrin e Shëndetësisë, përkatësisht Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e PDK, ndërkohë që po ushtronin pozitën e tyre institucionale. Përveç kësaj, në periudhën para zgjedhjeve, në uebsajtin e lajmeve dhe faqen në Facebook, RTK kishte mbulim të gjerë dhe mjaft pozitiv për PDK, me më pak mbulim për partitë e tjera dhe, ndonjëherë, mbulim negativ për LDK.⁹³ Kjo përforcoi perceptimin e përgjithshëm se transmetuesi publik është i njëanshëm. Transmetuesi publik, si institucion publik, mban përgjegjësi thelbësore, që do të thotë se i kërkohet të zbatojë politikë redaktuese të drejtë dhe të ekuilibruar në media online dhe faqe në platforma sociale, si dhe në transmetimet e veta.⁹⁴

Kanalet televizive private të tilla si *TV21*, *KTV*, *Klan Kosova* dhe *T7*, në përgjithësi ofruan mbulim me lajme që ishte i ekuilibruar dhe me ton neutral, dhe organizuan debate zgjedhore të shumta gjithëpërfshirëse, por asnjëri prej tyre nuk arriti të organizojë debat midis kandidatëve kryesorë për pozitën e kryeministrit. Përkundër disa përjekjeve të mediave për të adresuar tema dhe politika specifike, përfaqësuesit e partive që morën pjesë në debate nuk u përqendruan në propozime konkrete të platformave politike dhe gazetarët në përgjithësi nuk i sfiduan ata duke i mbajtur përgjendjes kundrejt historikut të tyre të mëparshëm politik. Për më tepër, disa kanale televizive private shkelën rregullat duke shfaqur banderola politike me pagesë gjatë debateve dhe programeve të tyre politike.⁹⁵ Prandaj, programet e krijuara për të informuar votuesit, u shndërruan në edhe një mjet për reklamim politik. Disa debate zgjedhore rezultuan në programe informative zbavitëse, të cilat nuk kontribuan shumë që votuesit të informohen për opsionet dhe programet politike.

Mbulimi i përgjithshëm i zgjedhjeve nga kanalet televizive private u cëno nga prania e gjerë e përmbajtjes me pagesë, përfshirë spotet politike me pagesë, mbulimin me pagesë të ngjarjeve të fushatës dhe videot promovuese. Në *KTV*, përmbajtja me pagesë tejkaloi mbulimin editorial duke përbërë 61 për qind të mbulimit të përgjithshëm zgjedhor, ndërsa për *T7* përmbajtja me pagesë përbënte 46 për qind, dhe 42 për qind për *Klan Kosova* dhe *RTV21*. PDK dhe AAK-PSD së bashku përbënë pothuajse 60 për qind të përmbajtjes totale me pagesë, me 31 dhe 28 për qind përkatësisht. LDK përbënte 20 për qind, VV 11 për qind dhe Nisma-AKR-PD 10 për qind të përmbajtjes totale me pagesë. Përdorimi i pakufizuar i përmbajtjes me pagesë në mediat e transmetuara ishte me përfitim për partitë më të pasura, gjë që cenoi fushë-lojën e barabartë dhe u shoqërua me mungesë transparence në blerjen e qasjes me pagesë. KPM nuk ka marrë nga të gjithë transmetuesit 'ditarët' me informacione në lidhje me kohën e emetimit falas, përmbajtjen me pagesë dhe çmimet e tyre, siç kërkohet nga LZP dhe udhëzuesi i KPM-së, dhe jo të gjithë ditaret e dorëzuar ofruan informacion të plotë.

kryesor të lajmeve në TV Most dhe TV Puls. Gjatë fushatës zgjedhore u bë gjithashtu monitorimi cilësor i një mostre të mediave online të lajmeve dhe mediave sociale (faqet në Facebook).

⁹³ Faqja e RTK në Facebook tregoi anim në favor të PDK duke i kushtuar më shumë postime kësaj partie politike, herë pas here duke i sponsorizuar këto postime për të rritur shtrirjen e tyre, dhe gjithashtu duke postuar video të ngjarjeve të fushatës së PDK pa logon e transmetuesit publik dhe pa treguar se kjo ishte përmbajtje me pagesë nga partia politike.

⁹⁴ Ligji për RTK (2012), nen.18.8 "Politika redaktuese e RTK-së duhet të jetë e pavarur, korrekte, profesionale, objektive, e balancuar dhe asnjansë."

⁹⁵ *Klan Kosova*, *TV21* dhe posaçërisht *T7* shkelën Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, akti nënligjor 2017/07 i KPM, nen.12.1 "Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t'ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale."

Rekomandimi: Të merret në konsideratë rregullimi i mëtejme i blerjes së kohës së emetimit nga subjektet politike në mediat transmetuese. Kjo do të duhej të ketë për synim sigurimin e kushteve të barabarta dhe jodiskriminuese për qasje në kohën e tillë, shpalosje publike të listave të çmimeve, si dhe vendosje të kufirit në sasinë e kohës së emetimit që transmetuesi mund t'ia shesë secilit subjekt politik gjatë fushatës zgjedhore.

RTK2, kanali televiziv publik në gjuhën serbe, i cili nuk është në dispozicion në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, u dëshmuar se ishte mjaft i ekuilibruar gjatë fushatës zgjedhore, duke i kushtuar 28 për qind të mbulimit në lajme për Srpska Lista dhe 31 për qind për të gjitha së bashku, tri partitë e opozitës serbe të Kosovës: Sloboda, PKS dhe SLS. RTK2 gjithashtu ofroi ca kohë emetimi falas dhe organizoi debate midis partive politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë. Srpska Lista refuzoi të marrë pjesë në çdo debat. Nga ana tjetër, kanalet televizive private lokale të serbëve të Kosovës shfaqën mbulim me njëanësi: TV Most dhe TV Puls ia kushtuan 87 dhe 89 për qind respektivisht të mbulimit në lajme për Srpska Lista.

Votuesit kishin qasje në një larmi të mediave online të lajmeve, të cilat nganjëherë shfaqnin shkrime editoriale që mbështetnin ose diskreditonin subjektet politike.⁹⁶ Disa media online të lajmeve ndanë hapësirë për reklama politike në mungesë të kërkesave ligjore për të ofruar kushte të barabarta për garuesit dhe për të zbuluar informacione mbi shpenzimet e garuesve. Facebook u përdor gjerësisht nga mediat tradicionale dhe ato online për të transmetuar drejtpërdrejt dhe ripublikuar përmbajtjen e tyre editoriale dhe për të rritur audiencën. Garuesit e shfrytëzuan rrjetin Facebook për të arritur deri te votuesit me mesazhe të sponsorizuara, për të mobilizuar votuesit gjatë fushatës dhe për të transmetuar drejtpërdrejt ngjarjet e fushatës. EU EOM vërejti raste të izoluara të faqeve në Facebook të përkatësisë së panjohur që bënë fushata njollosjeje duke përhapur sistematikisht mesazhe me pagesë me përmbajtje çorientuese dhe nganjëherë të rreme. Ndonëse pati reklamim të konsiderueshëm të fushatës zgjedhore në Facebook, në Kosovë rrjeti social ende nuk e ka zbatuar politikën e tij, të adoptuar në vende të tjera, për të siguruar transparencë të plotë të reklamave zgjedhore.⁹⁷ Kjo do t'ia kishte bërë të mundur votuesve që ta dinë burimin e mesazheve të sponsorizuara, si dhe do ta kishte bërë të mundur vlerësimin e shpenzimeve të subjekteve politike në këtë platformë sociale.

XIII. PJESËMARRJA E GRAVE

Përderisa dispozitat për pjesëmarrjen e grave janë në fuqi, zbatimi i tyre mbetet i paefektshëm, veçanërisht në nivelin lokal.

⁹⁶ Më 4 tetor 2019, portali i njohur i lajmeve online *gazetaexpress.com* dha mbështetje publike si për kandidatin Albin Kurti (VV) ashtu edhe për kandidaten Vjosa Osmani (LDK) për pozitën e kryeministrit.

⁹⁷ Në mbarë botën, Facebook gradualisht po fut në përdorim një “proces për autorizim të reklamave” për reklamuesit që publikojnë shpallje lidhur me çështje sociale, zgjedhore apo të politikave me qëllim të rritjes së transparencës së reklamimit politik në platformën e vet.

Barazia gjinore është e mishëruar në dispozita të ndryshme të Kushtetutës.⁹⁸ Korniza ligjore specifikon nivelet minimale të përfaqësimit të detyrueshëm të secilës gjini në listën e kandidatëve të secilës parti dhe alokimin e ulëseve në Kuvend.⁹⁹ Përderisa konteksti ligjor vendos themelet për barazinë gjinore në jetën publike dhe ekzistojnë disa ligje dhe mekanizma institucionalë për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë, zbatimi i tyre është i paefektshëm dhe skena politike është e mbizotëruar nga burrat ndërsa gratë mbeten të përfaqësuara në mënyrë të pamjaftueshme, sidomos në nivelin lokal.

Nga 1,067 kandidatë të certifikuar, 343 ishin gra, duke përfaqësuar 32.15 për qind të të gjithë kandidatëve, në përputhje me kuotën e parashikuar në LZP, me vetëm një grua të deklaruar se garonte si kandidat për kryeministër.¹⁰⁰ Është vetëm një grua si udhëheqëse e partisë politike.¹⁰¹ Platformat politike nuk adresuan sa duhet çështjet gjinore. Në tubimet e vëzhguara nga vëzhguesit afatgjatë, folëset femra përbënë 22 për qind të totalit të folësve ndërsa pjesëmarrja e femrave ishte mesatarisht 23 për qind. OJQ Rrjeti i Grave të Kosovës inicioi fushatë të gjerë derë më derë në të gjithë Kosovën për të inkurajuar votuesit që të votojnë për kandidatet femra, pa marrë parasysh pikëpamjet politike.¹⁰² Partitë politike ofruan qasje dhe mbulim të kufizuar për gratë kandidate në programet editoriale të transmetuesve kryesorë të monitoruar: nga mbulimi i përgjithshëm që iu ofrua kandidatëve vetëm 17 për qind iu kushtua grave kandidate, ku 36 për qind e mbulimit të grave iu dha kandidates për kryeministër nga LDK, Vjosa Osmani.¹⁰³

Prania e grave në administrimin e zgjedhjeve mbetet e ulët. Edhe pse KQZ-ja kryesohet nga një grua, vetëm dy nga 10 anëtarët e KQZ-së dhe 14 për qind e anëtarëve të KKZ-ve ishin gra. Prani më e ekuilibruar gjinore është vënë re në radhët e trajnuesve të stafit të votimit. Në 416 vendvotimet ku EU EOM vëzhgoi votimin, gratë përbënë 28 për qind të anëtarëve të KVV-ve dhe 19 për qind të kryesuesve të KVV-ve, ndërsa 26 për qind e vëzhguesve të partive dhe 44 për qind e vëzhguesve vendas ishin gra. Përtej statistikave, disa bashkëbisedues të EU EOM shprehën mendimin se gratë nuk po luajnë rol si udhëheqëse dhe vendimmarrëse dhe me sa duket përballen me pengesa

⁹⁸ Neni 71.2, Kushtetuta “Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektojë parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare” dhe dispozita të tjera për përbërjen e shërbimit civil (neni 101.1), gjyqësorit (neni 104.2), Këshillit Gjyqësor të Kosovës (neni 108.2), Këshillit Prokurorial të Kosovës (neni 110.1), Gjykatës Kushtetuese (neni 114.1).

⁹⁹ Nenet 27, 110.2 dhe 111.6 të ndryshuar, në LZP përcaktojnë kuotë minimale prej 30 për qind për secilën gjini në secilën listë të kandidatëve dhe në ndarjen e ulëseve në Kuvend, përkatësisht. Neni 4.1, CEDAW përcakton që “Miratimi i masave të përkohshme të veçanta nga Shtetet Palë që synojnë përshpejtimin de facto të barazisë midis burrit dhe gruas, nuk konsiderohet diskriminim, siç është përkufizuar në këtë Konventë, por në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë për pasojë ruajtjen e normave të pabarabarta apo të veçanta; këto masa duhet të ndërpriten kur të jenë arritur objektivat e barazisë së mundësive dhe të trajtimit.” Paragrafi 20, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 25 për nenin 4.1 të CEDAW.

¹⁰⁰ Sipas listës së kandidatëve të KQZ-së, të certifikuar nga KQZ, e datës 17 shtator 2019.

¹⁰¹ Emilija Redžepi, Lidere e partisë boshnjake Nova Demokratska Stranka (NDS).

¹⁰² Shpërndarja e fletushkave me sloganin “Voto për më shumë gra në Parlament”.

¹⁰³ Mbulimi i kandidatëve nga RTK1, TV21, KTV, Klan Kosova dhe T7 gjatë fushatës zgjedhore në debatet e tyre zgjedhore, emisionet e diskutimit dhe programet e aktualitetit. Kanalet televizive i thanë EU EOM se në përgjithësi ata nuk i ftojnë drejtpërdrejt kandidatët në programet e tyre, por vetëm kërkojnë nga partitë politike për një përfaqësues të tyre, duke i dhënë kështu partive zgjedhjen përfundimtare se kë ta dërgojnë nga kandidatët e tyre.

shoqërore dhe familjare për t'u propozuar për pozitë të zgjedhur ose për të bërë fushatë të suksesshme.

Edicioni i fundit i Ligjit për Barazi Gjinore parashikon barazi strikte të përfaqësimit prej 50 për qind¹⁰⁴. Dispozitat e këtij ligji nuk janë harmonizuar me ato të LZP-së dhe kuota prej 30 për qind e parashikuar në LZP u aplikua edhe për këto zgjedhje. Mosharmonizimi i të dy ligjeve ishte çështje që u ngrit në disa raste nga përfaqësuesit e organizatave për të drejtat e grave dhe u kundërshtua nga Avokati i Popullit në gjykatë pak para zgjedhjeve. Avokati i Popullit doli me deklaratë publike më 5 shtator 2019 mbi epërsinë e dispozitave të Ligjit për Barazi Gjinore mbi dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Më 27 shtator, Avokati i Popullit ngriti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë ndaj KQZ-së për diskriminim gjinor në listat e kandidatëve të subjekteve politike dhe bëri kërkesë për masë të përkohshme gjyqësore duke kërkuar nga KQZ-ja që të rishikojë listat e kandidatëve; Gjykata nuk e pranoi kërkesën sepse dhënia e urdhërësës së tillë do të paragjykonte vendimin gjyqësor rreth padisë kryesore.¹⁰⁵ Përtej kuotave legislative, partitë politike dhe administrata zgjedhore nuk ndërmorën vullnetarisht asnjë masë të diskriminimit pozitiv për të rritur numrin e grave kandidate dhe numrin e grave anëtare të organeve përgjegjëse për zhvillimin e zgjedhjeve, veçanërisht në organet zgjedhore të niveleve të ulëta.

Rekomandimi: Partitë politike të konsiderojnë adoptimin e politikave të brendshme për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe integritetin e çështjeve gjinore në platformat partiake. Të rriten fondet publike për partitë që promovojnë barazinë gjinore.

Rekomandimi: KQZ të rrisë pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve.

XIV. PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Identifikimi i masave dhe qasjeve që kanë për qëllim mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike duhet të intensifikohet

Kushtetuta garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe imponon më tej detyrimin që ato të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁰⁶ Nga KQZ kërkohet me ligj që të sigurojë që personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe personave me nevoja dhe rrethana të veçanta (PSNC), u mundësohet të marrin pjesë në procesin zgjedhor dhe që fushatat e edukimit të votuesve janë gjithëpërfshirëse dhe synojnë edhe votuesit analfabetë.¹⁰⁷

¹⁰⁴ Ligji për Barazi Gjinore (nr. 05/L-020) u adoptua në 28 maj 2015 duke shfuqizuar Ligjin për Barazi Gjinore (nr. 2004/2), për të siguruar barazi gjinore në përputhje me CEDAW dhe disa Direktiva të BE-së për barazi gjinore.

¹⁰⁵ Gjykata Themelore vendosi që masa e përkohshme e kërkuar ishte identike me kërkesën kryesore të padisë. Nëse Gjykata do të urdhëronte që listat e kandidatëve të rishikohen, do të ishte si marrje e vendimit për përmbajtjen lëndore të çështjes.

¹⁰⁶ Neni 53 i Kushtetutës. Sidoqoftë, duke qenë se Kosova nuk është palë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, nuk ka mundësi që ndonjë çështje të paraqitet para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe interpretimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut mbetet brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.

¹⁰⁷ Sipas nen. 99.1, LZP, rregullat për votim për personat me nevoja të veçanta janë përcaktuar për votuesit të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak të paaftësisë fizike,

Në ditën e zgjedhjeve, në nivel të KKZ-ve u themeluan Ekiye Mobile dhe Ekiye për Votuesit nëpër Institucione për të lehtësuar votimin për të gjithë votuesit e regjistruar me sukses si PNRRV. Për këtë lloj të veçantë votimi, ishin regjistruar gjithsej 2,785 persona, të ndarë në dy kategori, gjegjësisht votimi në shtëpi dhe votimi nëpër institucione (qendrat e paraburgimit, qendrat korrektuese dhe Burgu i Sigurisë së Lartë, institucionet e kujdesit shëndetësor, shtëpitë e të moshuarve).¹⁰⁸

Ligji parashikon votimin me ndihmë nga personi sipas zgjedhjes së votuesit, në përputhje me standardet në CRPD,¹⁰⁹ praktikë kjo që u përdor gjerësisht në ditën e zgjedhjeve. Fletëvotimi i veçantë me prekje për votuesit me dëmtim në të parë ishte në dispozicion në 60 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Megjithatë, sipas OJQ-ve, shkalla e shkrim-leximit të alfabetit Braille është relativisht e ulët dhe nuk u ofrua trajnim specifik. Vështirësitë në kuptim të qasjes fizike në vendvotime u vërejtën në pothuajse 40 për qind të vendvotimeve të vizituara nga EU EOM. OJQ-të avokojnë për përligje absolute të së drejtës për të votuar në mënyrë autonome dhe masa për integrim efektiv dhe votim të pavarur.¹¹⁰

Nga KQZ kërkohet me ligj që të përgatisë materiale për informim të votuesve në gjuhën e shenjave.¹¹¹ Informacioni për votues në uebsajtin e KQZ-së nuk ishte përshtatur enkas për personat me aftësi të kufizuara,¹¹² duke cenuar mundësinë e tyre për të marrë dhe komunikuar informacionin në mënyrë të barabartë.¹¹³ Sidoqoftë, nga ana pozitive, spotet e KQZ-së në media dhe në faqen e KQZ-së në Facebook u përkthyen edhe në gjuhën e shenjave. Të drejtat zgjedhore të grupeve të cënueshme nuk u përfshinë në fushata dhe nuk u debatuan gjatë emisioneve kryesore politike. Nuk ka kërkesa të veçanta ligjore për mediat publike ose private që të përshtatin programet e tyre zgjedhore për PAK.¹¹⁴

mjekësore ose çfarëdo paaftësie tjetër, ose votuesit me lëvizje të kufizuara në ndonjë institucion: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mendore në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit. Votimi në rrethana të veçanta i referohet votuesve që jetojnë në bashkësitë të cilat për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar.

¹⁰⁸ Gjegjësisht 1,315 votues për votimin në shtëpi dhe 1,470 votuesit që mbahen në institucione. Nuk kishte asnjë votues të regjistruar në kategorinë e tretë, d.m.th. për votim në rrethana të veçanta.

¹⁰⁹ Neni 89.5, LZP “Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin dhe/ose është analfabet mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi nëse ai kërkon një ndihmë të tillë” në përputhje me CRPD, neni 29 (iii) “shprehja e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës” garantohet gjithashtu duke “lejuar ndihmën në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.”

¹¹⁰ HANDIKOS dhe Shoqata e të Verbërve të Kosovës.

¹¹¹ Neni 108, LPZ për Transmetimin e Informatave për Votuesit.

¹¹² Një uebsajt miqësor për personat me aftësi të kufizuara mund të përdorë teknologji ndihmuese, siç janë, për shembull, *alt tags* që lexohen me zë për përdoruesit me dëmtim në të parë, diapazoni i zmadhuar me klikim për përdoruesit me probleme të mobilitetit, udhëzuesi me lexues për audiencën e moshuar.

¹¹³ Neni 21 i CRPD bën thirrje për sigurimin e “informacionit të menduar për përdorim publik për personat me aftësi të kufizuara në formate të qasshme...të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar” dhe për inkurajimin e “masmediave...për t’i bërë shërbimet e tyre të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.”

¹¹⁴ Ligji për Radio Televizionin e Kosovës përmban vetëm dispozita të përgjithshme siç është “vëmendje e veçantë i kushtohet personave me aftësi të kufizuara sa i përket programeve dhe ofrimit të informatave” (nenet 1.11 dhe 1.12). Gjuha e shenjave u përdor vetëm në emisionin kryesor të lajmeve të përditshme në RTK dhe spotet për informim të votuesve nga OJQ-të.

XV. VËZHGIMI NGA SHOQËRIA CIVILE

Vëzhguesit nga partitë dhe shoqëria civile kontribuuan në besimin e votuesve ndaj procesit zgjedhor në shumicën e komuniteteve.

KQZ-ja akreditoi numër të madh vëzhguesish brenda afateve të arsyeshme dhe pa ndonjë problem të raportuar. Gjithsej, ishin 34,535 vëzhgues përfshirë subjektet politike, OJQ-të, mediat, vëzhguesit ndërkombëtarë dhe diplomatët. Kjo shkallë e lartë e kontrollit ndihmoi në rritjen e transparencës gjatë procesit të votimit dhe numërimit në ditën e zgjedhjeve. Meqenëse akreditimi vlen edhe për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, prania e vëzhguesve atje kontribuo në besimin në procesin e rezultateve dhe rinumërimëve.

Subjektet politike patën 29,339 vëzhgues të akredituar, ku pesë partitë kryesore politike¹¹⁵ secila pati rreth 5,000 vëzhgues duke mundur rreth dy vëzhgues për çdo vendvotim. Nga ana tjetër, partitë më të vogla kishin më pak vëzhgues, me përjashtim të Koalicionit Vakati i cili akreditoi 1,005 vëzhgues që përbënë përafërsisht 1 në 30 qytetarë të komunitetit boshnjak. Srpska Lista ishte e përfaqësuar mirë me 237 vëzhgues të akredituar në afro 200 vendvotime në komunitetin serb të Kosovës, por partitë opozitare ishin më pak të përfaqësuara me SLS që kishte 127, PKS 14 dhe Sloboda pa vëzhgues të akredituar. Partitë e opozitës serbe të Kosovës raportuan se disa nga këta vëzhgues dhe anëtarët e tyre në këshillat e vendvotimeve iu nënshtruan presioneve në natën para zgjedhjeve, por nuk u dhanë prova.

Kishte gjithsej 4,154 vëzhgues vendas, nga të cilët 3,113 ishin nën organizatën ombrellë Demokracia në Veprim, që është rrjet prej rreth 50 OJQ-ve. Demokracia në Veprim pati 72 vëzhgues afatgjatë të cilët arritën të vëzhgojnë pothuajse 800 ngjarje fushate në të gjithë Kosovën, përveç ofrimit të vëzhguesve statikë në secilin nga vendvotimet në ditën e zgjedhjeve. Raportet e tyre publike gjithëpërfshirëse, me kohë dhe të vlefshme gjatë gjithë fushatës, në ditën e zgjedhjeve dhe më pas dhanë kontribut të rëndësishëm për integritetin e procesit zgjedhor.

XVI. VOTIMI DHE NUMËRIMI

Dita e zgjedhjeve ishte e rregullt dhe e qetë dhe procesi i zhvilluar i votimit u vlerësua pozitivisht

Dita e zgjedhjeve ishte e rregullt dhe e qetë dhe vëzhguesit e EU EOM nuk raportuan ndonjë incident madhor. EU EOM dërgoi 108 vëzhgues të cilët vëzhguan procedurat e hapjes, votimit, mbylljes dhe numërimit në 416 vendvotime në të gjitha 38 komunat, si dhe pranim-dorëzimin e materialeve të vendvotimit në 24 qendra e pranimi të KKZ-ve. Mostra e vëzhgimit mbuloi 16 për qind të të gjitha vendvotimeve dhe 63 për qind të të gjitha qendrave të pranimi. Mostra e vendvotimeve nuk ishte e rastësishme dhe për këtë arsye gjetjet e vëzhgimit nuk janë përfaqësuese për të gjitha vendvotimet në Kosovë.

Të 38 vendvotimet ku misioni vëzhgoi procesin e hapjes, u hapën me kohë ose me vonesë prej më pak se 30 minuta. Arsyet kryesore të hapjes me vonesë ishin mospërgatitja dhe stafi i pamjaftueshëm i këshillave të vendvotimit. Procedurat e hapjes u ndoqën kryesisht dhe zhvillimi i

¹¹⁵ Gjegjësisht, VV, LDK, PDK, AAK-PSD dhe Nisma-AKR-PD.

përgjithshëm i procesit të hapjes u vlerësua pozitivisht në të gjithë, përveç një vendvotimi të vëzhguar.

Votimi u vëzhgua në 416 vendvotime. Zhvillimi i përgjithshëm i procesit të votimit u vlerësua pozitivisht në më shumë se 95 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Vëzhguesit nga subjektet politike dhe shoqëria civile ishin të pranishëm në respektivisht 94 dhe 91 për qind të vendvotimeve të vizituara, duke rritur besimin e palëve të përfshira në proces. Sidoqoftë, në 76 vendvotimet në të cilat u bë vëzhgimi i votimit në komunat me shumicë të serbëve të Kosovës, subjektet politike të opozitës serbe nuk ishin përfaqësuar mirë, ku SLS kishte 20, PKS 11 dhe Sloboda 4 vëzhgues.

Përderisa vlerësimi i përgjithshëm i procesit të votimit ishte pozitiv, vëzhguesit e EU EOM gjithashtu vunë re disa parregullsi. Ajo më e rëndësishmja - ndihma e tepërt për votuesit – u vëzhgua në shumë nga vendvotimet e vizituara, ku i ofrohej ndihmë votuesve që me sa dukej nuk kishin nevojë për ndihmë. Numri i votuesve që u ndihmuan për plotësimin e fletëvotimit në disa vendvotime arrin madje deri në 22 për qind. Vëzhguesit e EU EOM raportuan se votimi me ndihmë shpesh u keqpërdor për të përligjur votimin, përndryshe të paligjshëm, familjar. Ndihamë e paligjshme për votuesit nga anëtarët e KVV-ve ose vëzhguesit u vërejt në 3 për qind të vendvotimeve të vizituara.¹¹⁶

Më shumë se dy vëzhgues nga një subjekt politik ishin të pranishëm në mënyrë të paligjshme në 15 për qind dhe raste të votimit familjar apo grupor (duke mos përfshirë votimin me ndihmë) u vëzhguan në 10 për qind të vendvotimeve të vizituara. Votuesit jo gjithmonë e shënuan fletëvotimin e tyre në fshehtësi në 9 për qind të vendvotimeve të vizituara dhe votuesve iu lejua të votonin me kusht me dokumentet e identifikimit të Serbisë në 3 nga 84 vendvotimet e dyfishta të vëzhguara.¹¹⁷ Përpjekje për të ushtruar ndikim te votuesit se për kë të votojnë u vërejtën në 3 për qind të vendvotimeve të vizituara.

Vëzhguesit e EU EOM raportuan se kishte votim të organizuar dhe të koordinuar nga grupe të mëdha të votuesve serbë të Kosovës, të cilët me sa duket se ishin punonjës të sektorit publik në qytezën e Graçanicës dhe fshatrat Gushtericë dhe Bërnice.

Performanca e stafit në KVV u përkeqësua dukshëm gjatë procesit të mbylljes dhe numërimit dhe vetëm 28 nga 39 numërime të kryera në vendvotim u vlerësuan pozitivisht. Kjo kryesisht për shkak të faktit se procedurat mjaft komplekse të mbylljes dhe numërimit shpesh nuk u ndoqën. Në një rast, vëzhguesit e EU EOM raportuan falsifikim të rezultateve për kandidatët në FRK. Vëzhguesit e subjekteve politike ishin të pranishëm në 36 vendvotime dhe vëzhguesit e shoqërisë civile në 37 vendvotime të vëzhguara gjatë numërimit. Dorëzimi dhe marrja e materialit të vendvotimeve u vëzhgua nga 25 ekipe në 24 nga 38 qendrat e pranimit në KKZ. Procesi u vlerësua pozitivisht në 25 nga 26 vëzhgime.¹¹⁸

¹¹⁶ Votuesit mund t'i ndihmojë në shënimin e fletëvotimit një person që e ka zgjedhur ai/ajo. Anëtarëve të KVV-ve dhe vëzhguesve nuk u lejohet të ndihmojnë votuesit.

¹¹⁷ Çdo qendër votimi përfshinte një vendvotim të dyfishtë ku votuesit mund të votonin me fletëvotim me kusht.

¹¹⁸ Dy ekipe vëzhguan në të njëjtën qendër të pranimit në KKZ në periudha të ndryshme dhe së bashku paraqitën tre formularë të veçantë vëzhgimi.

Ashtu si në zgjedhjet e kaluara, KQZ kërkoi nga OSBE të ofrojë ndihmë teknike në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. OSBE u përgjigj pozitivisht dhe dërgoi 220 persona si staf zgjedhor dhe 50 si staf mbështetës në katër KKZ dhe në 86 KVV sa ishin gjithsej. Stafi i OSBE-së kishte vetëm rol këshillues pa kompetenca ekzekutive, megjithatë prania e tyre kontribuoi në proces të votimit dhe numërimit që shkoi mbarë në ditën e zgjedhjeve.

Nga aspekti pozitiv, KQZ siguroi transparencën e procesit të numërimit duke publikuar menjëherë në internet rezultatet preliminare për subjektet politike të zbërthyer sipas vendvotimeve brenda disa orësh pas përfundimit të numërimit të rregullt të votave në qendrat e votimit.¹¹⁹ Sistemi i KQZ-së për votimin brenda Kosovës i cili bëri të mundur publikimin e rezultateve në internet u vërtetua si tejet i rëndësishëm për të siguruar besueshmërinë e procesit të shpalljes së rezultateve. Stafi i regjistrimit të të dhënave për votimin në qendrat e votimit brenda Kosovës ishin, me pak përjashtime, në dukje të zotë të zbulonin gabimet dhe të futnin numrin e saktë të votave për subjektet politike, madje edhe nëse FPR-të e vendvotimit ishin plotësuar gabimisht nga kryesuesit e KVV-ve. Subjektet politike në përgjithësi u besuan këtyre rezultateve, megjithëse me shqetësime që u shkaktuan nga çështja e FRP-ve me gabime shtypi.¹²⁰

XVII. AMBIENTI PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

Në mbarë Kosovën u pasqyrua gjerësisht pranimi i rezultateve të zgjedhjeve, përkundër ndryshimeve të rëndësishme politike që ato sollën. VV, fituese e zgjedhjeve, dhe LDK, e cila doli e dyta, shpallën më 10 tetor marrëveshjen për krijimin e një qeverie të vogël të koalicionit me vetëm 12 ministra dhe të dy partitë menjëherë filluan negociatat për programin e qeverisë.

Natën e zgjedhjeve, PDK njoftoi se ata e pranojnë rezultatin dhe do të shkonin në opozitë. Në mënyrë të ngjashme, më 7 tetor, AAK njoftoi se ata nuk do të kërkojnë të jenë pjesë e qeverisë, por mund ta mbështesin atë rast pas rasti. Koalicioni Nisma-AKR-PD, i cili për rreth 300 vota nuk e arriti pragun prej 5 për qind për të hyrë në Kuvend, i kundërshtoi pa sukses rezultatet përfundimtare në PZAP dhe Gjykatë Supreme. Kjo i la vetëm katër subjekte politike të shqiptarëve të Kosovës në Kuvend, që është ulje nga shtatë në mandatin e fundit.

Të dhjetë ulëset e garantuara për komunitetin serb u fituan nga Srpska Lista dhe ata u shprehën të kënaqur me rezultatin. Subjektet e tjera politike të serbëve të Kosovës, gjegjësisht SLS, PKS dhe Sloboda u ankuan për padrejtësi në fushatë, frikësim të mbështetësve të tyre, vëzhguesve dhe anëtarëve të këshillave të vendvotimit dhe kërkuan pa sukses rinumërimin e plotë të të gjitha vendvotimeve në zonat me shumicë serbe në Kosovë.

¹¹⁹ Rezultatet e plota të zbërthyer sipas vendvotimit ishin në dispozicion në uebsajtin e KQZ-së 45 orë pas mbylljes së votimit.

¹²⁰ Sipas rezultateve preliminare, koalicioni mori 4.96 për qind të votave të rregullta të vlefshme.

XVIII. TABELIMI

Proces transparent, por problemet me formularët e rezultateve vonuan shpalljen e rezultateve përfundimtare

Tabelimi i rezultateve, verifikimi dhe numërimi i votave me kusht dhe të personave me nevojave të veçanta¹²¹, numërimi i fletëvotimeve përmes postës për votimin jashtë Kosovës, si dhe të gjitha rinumërimet e kërkuara të rezultateve të vendvotimeve po zhvilloheshin njëkohësisht në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve në Prishtinë. Sipas vëzhguesve të EU EOM, puna në qendër ishte e organizuar mirë, stafi ishte kompetent dhe vëzhguesit kishin qasje domethënëse në të gjitha fazat e procesit. Sidoqoftë, puna përparonte mjaft ngadalë për shkak të masave mbrojtëse për procesin e tabelimit, siç është futja paralele e dyfishtë e të dhënave nga të gjitha FPR-të dhe FRK-të, skanimi i dyfishtë i të gjitha listave përfundimtare të votuesve për të zbuluar çdo votim të mundshëm të shumëfishtë nga votuesit me kusht dhe auditimi i çdo parregullsie të zbuluar në lidhje me materialin dhe rezultatet e vendvotimit.

KQZ mbajti nivel të lartë të transparencës gjatë proceseve në QNR. Skanimet e FPR-ve dhe FRK-ve për secilin vendvotim të procesuar u ngarkuan në uebsajtin e KQZ-së. Në rast të rinumërimit, u publikuan edhe formularët origjinalë të rezultateve nga vendvotimi edhe formularët e plotësuar rishtas pas rinumërimit. E vetmja e metë e dukshme sa i përket transparencës ishte fakti që nuk kishte rezultate progresive për mbarë Kosovën të publikuara nga KQZ-ja gjatë procesit të tabelimit. Kjo mangësi u theksua veçanërisht në rastin e rezultateve të koalicionit Nisma-AKR-PD. Sipas rezultateve preliminare për votimin brenda Kosovës, ky subjekt politik fitoi 4.96 për qind të votave të vlefshme dhe deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare kishte informacione kontradiktore nëse e kishin kaluar pragun prej pesë për qind.

Në përgjithësi, procesi i tabelimit zgjati jashtëzakonisht shumë dhe rezultatet përfundimtare, ende subjekt i kundërshtimit të mëtutjeshëm dhe certifikimit, u shpallën vetëm më 7 nëntor, pra 32 ditë pas ditës së zgjedhjeve.¹²² Arsyeja kryesore për vonesën ishte nevoja për të rinumëruar 2,255 ose 88.5 për qind të të gjitha vendvotimeve për shkak të parregullsive të hetuara, si dhe procesi i gjatë i ankesave dhe parashtrësive në lidhje me pranimin e fletëvotimeve përmes postës për votimin jashtë Kosovës të ardhura nga Serbia dhe ato që arritën pas afati ligjor.

Para vendimit të PZAP-së për të rinumëruar votat nga 1,407 vendvotime, KQZ-ja gjatë mbledhjeve të mbajtura më 9, 17 dhe 25 tetor vendosi për rinumërim të 314, 530 dhe 4 vendvotimeve, respektivisht. Shumica e këtyre 848 vendvotimeve, gjegjësisht 452 prej tyre, duhej të rinumëroheshin për faktin se FPR-të e përdorura në ditën e zgjedhjeve në të gjitha vendvotimet përmbanin gabime shtypi. Rreshti i parë në pjesën ku duhej të regjistroheshin votat e marra nga secili prej 25 subjekteve politike, u shtyp pa tre kutitë për të shënuar numrin treshifror të votave (p.sh. 0 0 7) të marra nga subjekti politik i listuar i pari në fletëvotim. Si pasojë e kësaj, shumë kryesues të KVV-ve regjistruan votat e marra nga subjekti i parë në rreshtin/kutitë që i përkisnin subjektit të dytë në fletëvotim, etj.

¹²¹ Gjithsej, 26,825 fletëvotime me kusht dhe për persona me nevojave të veçanta të konfirmuara, që përfaqësojnë 3.1 për qind të totalit të votave të hedhura, u numëruan në 24 dhe 25 tetor.

¹²² Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2017, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve u shpallën 18 ditë dhe u certifikuan 27 ditë pas ditës së zgjedhjeve.

Pjesa tjetër prej 396 vendvotimeve u desh të rinumëroheshin në radhë të parë për shkak të mospërputhjeve të zbuluara në mes të numrit të votave të marra nga subjekti politik dhe numrit të votave të marra nga kandidatët e tij. Në shumicën dërrmuese të këtyre rasteve, një ose më shumë kandidatë kishin marrë më shumë vota sesa subjekti i tyre politik. Anomalitë e tilla në rezultatet e vendvotimit u refuzuan automatikisht gjatë procesit të regjistrimit të të dhënave dhe më pas u dërguan për auditim. Asnjë nga parregullsitë e zbuluara nuk çoi në anulimin e rezultateve të vendvotimeve.¹²³

EU EOM analizoi 258, d.m.th. 65 për qind të këtyre 396 vendvotimeve të rinumëruara. Analiza e formularëve të rezultateve konfirmoi arsyen e deklaruar zyrtarisht për rinumërimin në 240 vendvotime.¹²⁴ Në 165 vendvotime rinumërimi çoi në ndryshime në numrin e votave të marra nga subjektet politike. Në 153 raste ndryshimi ishte në mes të 1 dhe 5 votave, dhe në 12 raste më shumë se 5 vota. Rinumërimet gjithashtu ndryshuan, kryesisht me ulje, numrin e votave të marra nga kandidatët individualë në 250 vendvotime të analizuara. Në 156 vendvotime ndryshimi ishte deri në 10 vota, në 57 vendvotime në mes të 11 dhe 50 vota, në 27 vendvotime në mes të 51 dhe 100 vota, dhe në 10 vendvotime më shumë se 100 vota.¹²⁵ Përderisa shumica e këtyre ndryshimeve mbase do të mund të shpjegohej me dallimet në përcaktimin e vlefshmërisë së votave ose gabimet pa dashje, ka pasur disa raste që tregojnë qartë manipulimin e qëllimshëm të rezultateve. Të gjitha këto raste kërkojnë hetime të mëtutjeshme.

Pas vendimeve të PZAP-së dhe Gjykatës Supreme për ankesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme politike ndaj rezultateve përfundimtare të publikuara më 11 nëntor, QNR u urdhërua të rinumërojë edhe 1,407 vendvotime tjera. Për të shpejtuar procesin, QNR e rriti numrin e ekipeve të rinumërimit nga 23 në 33. Procesi i rinumërimit të këtyre vendvotimeve ishte transparent dhe u ndoq nga afër kryesisht nga vëzhguesit e VV dhe koalicioni i udhëhequr nga Nisma. Si edhe më parë, QNR nuk publikoi ndonjë përditësim të rregullt të rezultateve të përkohshme. Nga ana pozitive, formularët e rezultateve të reja nga vendvotimet e rinumëruara u shfaqën publikisht në QNR dhe me disa vonesa ato u publikuan edhe në uebsajtin e KQZ-së.¹²⁶ Sidoqoftë, procesi ishte më i tensionuar për shkak të disa mosmarrëveshjeve dhe vendimeve jokonsistente lidhur me vlefshmërinë e fletëvotimeve të kontestuara. Rreth 35 vendime për fletëvotimet e kontestuara u ankimuan në PZAP nga përfaqësuesit e VV ose subjektit Nisma.¹²⁷

EU EOM analizoi 236 (23 për qind) nga 1,040 formularë të rezultateve të rinumëruara që u publikuan. Analiza tregoi se në 151 (64 për qind) vendvotime nuk kishte asnjë ndryshim në numrin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Në 85 vendvotimet e mbetura ndryshimi ishte kryesisht +/- një ose dy fletëvotime.¹²⁸

¹²³ Në rastin e vendvotimit 2114B/01R në Komunën e Skenderajt, ku 450 fletëvotime të papërdorura u raportuan të vjedhura gjatë ditës së zgjedhjeve, KQZ përjashtimisht e ndryshoi procedurën në QNR dhe i pranoi rezultatet.

¹²⁴ Në 14 vendvotime nuk u konfirmua arsyeja zyrtare dhe 4 skanime të formularëve të rezultateve ishin të palexueshme.

¹²⁵ Nëse rinumërimi çoi në më shumë se një ndryshim në numrin e votave të marra për një subjekt politik ose kandidat, u mor parasysh ndryshimi më i madh.

¹²⁶ Deri më 28 nëntor, një ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare, vetëm 1,040 nga 1,407 formularë të rezultateve nga vendvotimet e rinumëruara ishin publikuar në uebsajt të KQZ-së.

¹²⁷ Nga 35 fletëvotimet e kontestuara, 17 u ankimuan për vlefshmëri dhe 18 për pavlefshmëri. Gjithsej, 14 parashtresa u miratuan nga PZAP.

¹²⁸ Në tre vendvotime ndryshimi ishte midis 14 dhe 24 fletëvotime.

XIX. ZGJIDHJA E KONTESTEVE ZGJEDHORE

Procesi i zgjidhjes së kontesteve zgjedhore ashtu siç zbatohet nuk ofron korrigjim efektiv ligjor.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i pavarur i përbërë nga dhjetë gjyqtarë dhe kryesohet nga një gjyqtar i Gjykatës Supreme. Paneli është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave në lidhje me zgjedhjet, përveç kundërshtimeve ndaj listës së votuesve të rregullt dhe ankesave ndaj ofruesve të shërbimeve mediale. Kushdo që pretendon shkelje të të drejtave të veta ose që ka interes për çështjen, mund të paraqesë ankesë; këta mund të jenë votues, subjekte politike, anëtarë në KVV ose KKZ, vëzhgues të partive politike, vëzhgues vendas ose OJQ. Shumica e llojeve të ankesave dhe parashtresave duhet të paraqiten brenda 24 orëve, përfshirë ato ndaj vendimeve të caktuara të KQZ-së, si dhe ato lidhur me parregullsitë gjatë fushatës, votimit dhe numërimit. Afati 24-orësh rrjedh nga koha e shkeljes së pretenduar dhe mbyllja e vendvotimit, respektivisht. PZAP ka 72 orë nga marrja e ankesës për të marrë vendim, i cili më pas mund të ankimohet në Gjykatën Supreme brenda 24 orësh.¹²⁹

Sipas ligjit, ekzistojnë mekanizmat për ankesa dhe parashtresa, por procesi i zgjidhjes së kontesteve, ashtu siç zbatohet aktualisht, nuk parashikon korrigjim efektiv ligjor të formës së plotë. Afatet e përcaktuara konsiderohen jashtëzakonisht të shkurtra si për palët - për t'i mbledhur provat e nevojshme, ashtu dhe për organet shqyrtuese - për t'i ekzaminuar dhe vlerësuar ato si duhet. Tutje, disa nga dispozitat e ndryshme për afatet dhe ankesat e parashtresat janë të paqarta, të shpërndara nëpër nene të ndryshme të LQP-së dhe nuk japin udhëzime praktike për provat e nevojshme dhe të pranueshme.¹³⁰ Rregullorja e Punës e PZAP-së e vitit 2015 ofron më shumë detaje procedurale, megjithëse nganjëherë hap udhë për interpretime të ndryshme në krahasim me LQP.¹³¹

Rekomandimi: Të zgjaten afatet e paraqitjes së ankesave apo parashtresave zgjedhore në 48 orë dhe afatet e vendosjes nga PZAP në 96 orë.

Ankesat dhe parashtresat para dhe në ditën e zgjedhjeve

Para ditës së zgjedhjeve, PZAP pranoi 86 parashtresa ndaj vendimeve të KQZ-së. Shumica e parashtresave kishin të bëjnë me regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës. Dy parashtresa për mos-emërimin e përfaqësuesve në KKZ u refuzuan.¹³² Gjashtë kërkesa të kandidatëve për t'u tërhequr

¹²⁹ Sipas nenit 118.4, LQP (i ndryshuar) ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës pranohet në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa 5,000 euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme ka 72 orë për të vendosur çështjen.

¹³⁰ p.sh. për paraqitjen dhe shqyrtimin, njoftimin e palëve për t'u përgjigjur ose për dorëzimin e vendimeve.

¹³¹ p.sh. afatet në lidhje me shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave dhe dorëzimin e vendimeve palëve.

¹³² Parashtresa e paraqitur nga PLE dhe SLS ndaj Vendimit 919/2019 të KQZ-së, datë 4 shtator 2019, për mos-emërimin e përfaqësuesve të tyre si anëtarë në KKZ në Istog dhe Klinë dhe Istog, Lipjan, Obiliq, Pejë, Skenderaj, Viti, Vushtrri dhe Klinë, përkatësisht.

nga listat e kandidatëve të certifikuar u miratuan.¹³³ Parashtresa e paraqitur nga Srpska Lista ndaj udhëzimit të KQZ që vetëm dokumentet e lëshuara nga Kosova mund të përdoren për identifikimin e votuesve, u refuzua si nga PZAP ashtu edhe nga gjykata Supreme.¹³⁴ U vlerësua se sqarimi i kësaj dispozite të ligjit bie në kuadër të kompetencave të KQZ-së dhe se udhëzimi do të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë votuesit dhe ishte bërë pa asnjë diskriminim nga aspekti i komunitetit, përkatësisë etnike ose gjinisë.

PZAP pranoi tri ankesa në lidhje me shkeljet e pretenduara të fushatës para periudhës zyrtare të fushatës; por çdo ankesë e tillë nuk bie nën kompetencat e PZAP-së.¹³⁵ PZAP pranon nevojën për rregullimin me ligj të periudhës para-fushatës. PZAP ka marrë gjithsej 290 ankesa, përfshirë 149 për fushatën zyrtare dhe 86 për shkelje të heshtjes zgjedhore gjatë votimit, ose në 24 orët para votimit. Këto të fundit kanë të bëjnë kryesisht me vendosjen e pllakateve në hapësira publike, shpërndarjen e materialeve të fushatës në afërsi të vendvotimeve dhe lypjen e votave përmes thirrjeve telefonike ose mesazheve telefonike me tekst.¹³⁶ Trembëdhjetë ankesa i referoheshin përdorimit të detyrës publike duke shkelur kodin e sjelljes, ku tetë rezultuan me gjoba të konsiderueshme.¹³⁷ Në ditën e zgjedhjeve u morën 42 ankesa për materiale të fushatës në afërsi të vendvotimeve, parregullsi nga KVV-të, mungesë ose humbje të fletëvotimeve, fotografim të fletëvotimit dhe gabime në FPR. Gjithsej, 118 ankesa u miratuan, disa u tërhoqën dhe rreth 167 u refuzuan për formalitete ose në bazë meritore.

Ankesat të cilat u miratuan nga PZAP rezultuan në numër të konsiderueshëm të gjobave të shqiptuara me gjithsej 360,000 EUR ndaj 13 subjekteve politike, ku PDK ka marrë shumën më të madhe të gjobave dhe VV shumën më të vogël nga partitë kryesore.¹³⁸ Shumica e gjobave u shqiptuan për shkelje relativisht të lehta, siç është vendosja e pllakateve në vende të palejuara ose postimi i fotografive në mediat sociale. Shumica e ankesave (134) u paraqitën nga OJQ-të Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).¹³⁹ Numri i ankesave ndaj subjekteve politike ishte PDK 63, VV53, AAK-PSD 50, LDK 42, NISMA-AKR-PD 11, Srpska Lista 10, krahas 22 ankesave tjera ndaj KVV-ve dhe të tjerëve.

¹³³ Kërkesat për tërheqje kanë të bëjnë me subjektet politike në vijim: katër nga PEK, një nga Fjala. Një kandidat nga Vakati tërhoqi parashtresën e tij në PZAP, duke mbetur kështu në listë. E drejta e kandidatëve brenda listave të subjekteve politike për t'u tërhequr vlen deri në tërheqjen e shortit për renditje në fletëvotim.

¹³⁴ Ankesa u paraqit ndaj udhëzimit të KQZ-së të 9 shtatorit 2019 që sqaronte nenin 90 të LZP. Gjykata Supreme vendosi që "parashtruesi dështoi të vinte në dyshim ligjshmërinë e vendimit të PZAP dhe për pasojë, Udhëzimi Administrativ i KQZ-së u mbështet me të drejtë nga PZAP."

¹³⁵ Një ankesë u paraqit nga PKS në lidhje me përdorimin e fëmijëve për promovim politik në mediat sociale nga Srpska Lista dhe dy të tjera nga GIG kundër JGP dhe PG. Qëndrimi i PZAP-së për ankesat në lidhje me shkeljet para nisjes së fushatës zyrtare u konfirmua në takimin e PZAP-së dhe ZRCP (KQZ) me subjektet politike në 23 shtator.

¹³⁶ Nga 149 ankesat në lidhje me periudhën e fushatës, 85 u miratuan dhe u shqiptuan gjoba, 56 u refuzuan, katër u tërhoqën, katër u hodhën poshtë për formalitete. Nga 86 ankesa në lidhje me periudhën e heshtjes zgjedhore, 26 u miratuan dhe u shqiptuan gjoba, 53 u refuzuan dhe shtatë u hodhën poshtë për formalitete.

¹³⁷ Fotografitë me pjesëtarët e Policisë së Kosovës, Forcave të Sigurisë së Kosovës, stafin mjekësor, studentët të postuar në llogaritë në Facebook.

¹³⁸ Gjegjësisht, PDK mori gjoba në shumë prej gjithsej EUR 100,100, AAK-PSD EUR 89,600, LDK EUR 74,850, Srpska Lista 36,500, AKR-PD EUR 33,900, VV EUR 14,100, ndër të tjerët.

¹³⁹ Të ndjekur nga subjektet politike, LDK (43), VV (41), PDK (13), Nisma-AKR-PD (17), AAK-PSD (8) dhe të tjerët.

PZAP aplikoi interpretime të rrepta të shkeljeve të kodit të sjelljes për partitë politike gjatë fushatës, të cilat u dukën si kufizime të paarsyeshme të lirisë së shprehjes. Gjegjësisht, Paneli i shqiptoi gjoba garuesve për fëmijët që paraqiteshin në ngjarje fushate ose për zyrtarët e tillë si pjesëtarët e forcave të sigurisë që paraqiteshin në materialet e fushatës. Përveç kësaj, ky Panel shqiptoi gjoba të konsiderueshme të cilat shpesh nuk ishin proporcionale me shkeljen e identifikuar dhe ndikimin e mundshëm të kësaj shkeljeje në lirinë e votës.¹⁴⁰ Në funksion të parandalimit të kufizimit të padrejtë të lirisë së shprehjes dhe sigurimit të vendimeve konsistente, PZAP do të duhej të kishte konsideruar adoptimin e udhëzimeve të mëtutjeshme për palët e interesuara dhe për vendimmarrjen e vet. Gjohat e shqiptuara duhet të jenë proporcionale me një qëllim të ligjshëm dhe të mos zbatohen në mënyrë arbitrare dhe tepër kufizuese. U shqiptua gjobë prej 30,000 eurosh për spotin e fushatës zgjedhore nga Srpska Lista i cili, në një interpretim të gjerë të dispozitës ligjore përkatëse, u vlerësua se shkel Kodin e Sjelljes për subjektet politike. Nga aspekti pozitiv, në rreth 50 raste, PZAP ia ktheu ankesat ose parashtruesat ankuesve ose parashtruesve meqë nuk i kishin plotësuar kërkesat zyrtare. Kjo u bë në mënyrë që ato të plotësohen ose të sqarohen në vend se të hedhen poshtë automatikisht.¹⁴¹

Ankesat dhe parashtruesat pas ditës së zgjedhjeve

Pas ditës së zgjedhjeve, dhe gjatë procedurës në QNR, PDK, LDK dhe Nisma-AKR-PD paraqitën ankesa në PZAP, duke kërkuar rinumërim të plotë, për shkak të gabimit të shtypit në FPR, që rezultoi në disa raste me regjistrim të gabueshëm të numrit të votave në rreshtin vijues d.m.th. për subjektin politik tjetër.¹⁴² Të tri kërkesat u bashkuan dhe u hodhën poshtë si të parakohshme dhe të papranueshme.¹⁴³ Edhe tetë ankesa të tjera u paraqitën në PZAP gjatë procesit në QNR, shtatë që kërkuan rinumërim të pjesshme u rrëzuan dhe një u miratua pjesërisht.¹⁴⁴ Në mungesë të bazës ligjore të qëndrueshme për të kundërshtuar rezultatet preliminare të pjesshme në këtë fazë të procesit, asnjë ankesë nuk mund të shqyrtohej, ndërsa subjektet politike ishin këshilluar nga PZAP të kthehen kur të publikohen rezultatet përfundimtare nga KQZ nëse akoma mendojnë se janë të dëmtuara.¹⁴⁵ Mundësia për të bërë ankesë kundër vendimit të KQZ-së për të publikuar rezultatet përfundimtare paraqet një qasje të lirshme të dispozitave ligjore përkatëse.¹⁴⁶ Do të duhej të theksohet se llojet e vendimeve të KQZ-së ndaj të cilave mund të ushtrohet ankim janë të listuara

¹⁴⁰ Në pajtim me nenin 120, LZP, i ndryshuar, shuma maksimale e gjobës që mund të shqiptohet është 50,000 EUR, ndërsa shkalla e gjobave është e përshkruar në Rregullën nr. 01/2012, PZAP, dhe shkon nga 5,000 deri në 50,000 EUR. Janë shqiptuar edhe gjoba më të ulëta se 5,000 EUR. Kur vendos për sanksione, PZAP merr në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, siç janë masat përmirësuese të marra nga kryesi me t'u njoftuar rreth ankesës (siç thuhet në nenin 6.7 të Rregullës nr. 02/2015, Rregullorja e Procedurës, PZAP), pastaj nëse partia politike ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe ka shkelur Kodin e Sjelljes ose nëse ka marrë fonde publike, përkatësisht.

¹⁴¹ Sipas neneve 6.3 dhe 11.4 të Rregullës nr. 02/2015, Rregullorja e Punës, PZAP.

¹⁴² Ankesat nr.350/2019 nga PDK, nr.351/2019 nga LDK dhe nr.353/2019 nga NISMA-AKR-PD, me datë 07.10.2019, u shqyrtuan në seancën e mbajtur më 08.10.2019.

¹⁴³ Në pajtim me nenin 105.1, LZP dhe nenin 10, Rregulla Zgjedhore nr.6/2013, KQZ (Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve).

¹⁴⁴ Katër nga Nisma-AKR-PD, dy nga PLE, një nga VV dhe një nga një individ.

¹⁴⁵ Me aplikimin e nenit 122.1, LZP. Arsyeimi është që KQZ mund të vazhdojë me korrigjimin e rezultateve gjatë verifikimit në QNR.

¹⁴⁶ Rezultatet përfundimtare të përmbledhura para certifikimit nga KQZ.

shprehimisht në LZP dhe kundërshtimi i rezultateve nuk është i përfshirë. PZAP e pranon këtë boshllëk ligjor.

Gjatë procesit zgjedhor dhe deri në publikimin e rezultateve përfundimtare në 7 nëntor, 19 vendime të PZAP-së lidhur me ankesat dhe parashtrësarriten në Gjykatën Supreme. Në 14 raste parashtrësar u refuzuan dhe vendimet e PZAP-së u mbështetën në thelb; dy parashtrësar u miratuan, ndërsa tre vendime të tjera u dërguan në PZAP për rishqyrtim për t'u ndryshuar në lidhje me formën, por u mbështetën nga aspekti lëndor.¹⁴⁷

Rastet që i referohen fletëvotimeve përmes postës për votimin jashtë Kosovës

Menjëherë pas ditës së zgjedhjeve, më 17 tetor, VV kërkoi nga PZAP që rreth 4,639 pako me fletëvotime përmes postës të votimit jashtë Kosovës, të marra pas afatit ligjor, të përfshihen në numërim.¹⁴⁸ PZAP e hodhi poshtë ankesën për shkaqe procedurale, vendimi i të cilit pastaj u ankimua në Gjykatën Supreme; kjo e fundit e ktheu çështjen në PZAP për rishqyrtim duke dhënë udhëzime se si çështja do të duhej të vendoset nga aspekti lëndor.¹⁴⁹ PZAP e refuzoi ankesën duke zbatuar rreptësisht dispozitat e LZP-së. Vendimi më pas u ankimua përsëri dhe çështja më në fund u vendos nga Gjykata Supreme, e cila argumentoi se dispozita përkatëse e LZP-së është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar përmes Kushtetutës dhe se këto fletëvotime për votimin jashtë Kosovës ishin postuar mjaft përpara ditës së zgjedhjeve, dhe për këtë arsye duhet të numërohen.

Qasje e ngjashme u ndoq më vonë për 1,806 pako të tjera të votimit jashtë Kosovës të marra pas afatit ligjor dhe të përjashtuara nga numërimi. Parashtrësar e paraqitur nga VV më 2 nëntor ishte refuzuar nga PZAP duke mos marrë parasysh arsyetimin e aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Supreme. PZAP vlerësoi se LZP parashikon qartë afatin kur fletëvotimet në fjalë do të duhej të arrijnë duke vendosur kornizën kohore brenda së cilës do të duhej të përfundojë procesi; trajtimi i fletëvotimeve përmes postës të marra pas afatit të përcaktuar me ligj do ta vinte KQZ-në në një rreth vicioz duke vonuar publikimin e rezultateve të zgjedhjeve.¹⁵⁰ Vendimi i PZAP-së më pas u ankimua përsëri me sukses në Gjykatën Supreme, e cila më 5 nëntor vendosi që të numëroreshin fletëvotimet, mirëpo pa përmendur deri në cilën fazë të procesit do të duhej të pranohen fletëvotimet

¹⁴⁷ Parashtrësar nga VV për fletëvotimet për votimin jashtë Kosovës.

¹⁴⁸ Sipas nenit 96.2, LZP "Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ-së". Një ankesë e ngjashme u paraqit nga OJQ Germin më 18.10.2019, që gjithashtu i drejtoi ankesë Avokatit të Popullit për shkelje të të drejtës së votës së qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit.

¹⁴⁹ KQZ i kishte përjashtuar ato fletëvotime pa marrë ndonjë vendim zyrtar të KQZ. PZAP argumentoi se nuk kishte asnjë vendim ndaj të cilit mund të ushtrohej parashtrësar. Gjykata Supreme vendosi megjithatë që edhe një vendim i "heshtur" i KQZ-së mund të ankimohej. Tutje, ajo i dha përparësi ligjit të përgjithshëm ndaj ligjit të veçantë për zgjedhjet dhe dha mendim se data e postimit do të duhej të konsiderohet si datë e marrjes (në përputhje me nenin 127.2, Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, të vitit 2008), në kundërshtim me nenin 96, LZP dhe nenin 4.4, Rregulla nr. 03/2013, KQZ. Vihet re se ligjet e përgjithshme procedurale mund të zbatohen me analogji kur asnjë dispozitë përkatëse nuk përfshihet në ligjin special.

¹⁵⁰ PZAP më tej argumentoi se neni 96 i LZP nuk cenon të drejtën e votës, përkundrazi ai vetëm përcakton afatin kohor për marrjen e fletëvotimeve dhe se këto dispozita kontribuojnë në sigurimin e integritetit të procesit zgjedhor.

e tilla. Qasjet e ndryshme nga PZAP dhe Gjykata Supreme për këtë çështje shkaktuan vonesë të konsiderueshme në publikimin e rezultateve. Tutje, aktgjykimi i marrë nga Gjykata Supreme në devijim nga LZP në këtë fazë të përparuar të procesit ngriti reagime negative për mbase akomodim të interesave politike.¹⁵¹

Më 22 nëntor, dhe pak para se të mbaronte procesi i rinumërimit, VV kërkoi nga PZAP numërimin e 392 pakove të tjera nga votimi jashtë Kosovës që arritën pas afatit, por edhe pas publikimit të rezultateve më 7 nëntor.¹⁵² PZAP e hodhi poshtë si të palejueshme, vendim ky që më pastaj u ankimua në Gjykatën Supreme, duke vonuar më tej procesin. Më 27 nëntor, Gjykata Supreme këtë herë në mënyrë të arsyeshme mbështeti arsyetimin e PZAP-së dhe hodhi poshtë parashtresën, duke devijuar nga aktgjykimet e saj të mëparshme rreth çështjes duke argumentuar se këto u dorëzuan në një fazë tjetër të procesit kur numërimi ishte ende në vazhdim e sipër dhe rezultatet ende nuk ishin publikuar.

Në të njëjtën datë, VV iu drejtua PZAP-së duke kërkuar për herë të tretë numërimin e fletëvotimeve për votimin jashtë Kosovës, gjegjësisht më 22 nëntor, Nisma-AKR-PD parashtroi kërkesë lidhur me aktgjykimin e parë të Gjykatës Supreme për këtë çështje (që urdhëroi numërimin e 4,639 pakove të marra pas afatit) në Gjykatën Kushtetuese.¹⁵³ Kërkesa gjithashtu përfshinte propozimin për masë të përkohshme për të pezulluar përkohësisht certifikimin e rezultateve derisa të merret vendimi.¹⁵⁴ Kërkesa u bazua në faktin se Gjykata Supreme i tejkaloi kompetencat e saj duke kontrolluar kushtetutshmërinë e LZP-së, ndërsa ajo do të duhej ta kishte dërguar këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese.¹⁵⁵ Do të duhej të theksohej se Nisma-AKR-PD asnjëherë nuk e vuri në dyshim publikisht këtë aktgjykim të Gjykatës Supreme tashmë të nxjerrë më 30 tetor. Veprimi i tillë në atë fazë të procesit mund të interpretohet vetëm si përpjekje përfundimtare për të siguruar masë mbrojtëse ligjore për të pezulluar certifikimin e rezultateve, nëse është e nevojshme. Asnjë masë e tillë e përkohshme nuk u urdhërua deri në certifikimin e rezultateve më 27 nëntor.

Rastet që i referohen fletëvotimeve përmes postës të ardhura nga Serbia

Më 24 tetor, gjatë procesit në QNR, Nisma-AKR-PD kërkoi nga PZAP anulimin e fletëvotimeve të votimit jashtë Kosovës të ardhura nga Serbia që ishin përfshirë në numërim, mirëpo pa ndonjë vendim zyrtar të marrë nga KQZ. Në mungesë të vendimit të tillë nga KQZ, çështja u hodh poshtë për shkaqe procedurale. Pas aktgjykimin të Gjykatës Supreme për çështjen e fletëvotimeve të votimit jashtë Kosovës, ku u vendos që edhe një vendim “i heshtur” i KQZ-së mund të kundërshtohet, Nisma-AKR-PD u kthye në PZAP disa ditë më vonë me parashtresë kundër

¹⁵¹ LDK dhe PDK përmes anëtarëve të tyre përkatës në KQZ dhe OJQ Demokracia në Veprim (DnV).

¹⁵² Vendimi nr.507/20018, PZAP, 24 nëntor 2019.

¹⁵³ Aktgjykimi nr. AA20.2019, Gjykata Supremet, me datë 30 tetor 2019. Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, individët mund të ngrënë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

¹⁵⁴ Neni 116.2 i Kushtetutës thotë se përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të pezullojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme.

¹⁵⁵ Në pajtim me nenin 113.8, Kushtetuta.

vendimit “të heshtur” të KQZ-së. Më pastaj, kjo u hodh poshtë nga PZAP si e pasafatshme dhe parashtruesit u këshilluan që të ktheheshin pas publikimit të rezultateve përfundimtare.¹⁵⁶

Pas publikimit të rezultateve, Nisma-AKR-PD u kthye me parashtrësë lidhur me fletëvotimet e votimit jashtë Kosovës të ardhura nga Serbia. PZAP e miratoi parashtrësën duke vendosur që rrethanat e rastit tregojnë se pakot e kontestuara nuk janë marrë nga Posta e Kosovës në mënyrë të rregullt. PZAP vendosi më tej se pranimi i fletëvotimeve të tilla do të cenonte integritetin e procesit zgjedhor dhe do të binte ndesh me ligjin dhe rekomandimet e Komisionit të Venedikut.¹⁵⁷ Pas dy parashtrësave të pasuksesshme ndaj vendimit të PZAP-së në Gjykatën Supreme, fletëvotimet e kontestuara nga Serbia u eliminuan nga rezultatet përfundimtare, duke lejuar kështu që Nisma-AKR-PD të kalojë prapë. Vendimi u vlerësua si i politikisht i njëanshëm nga disa bashkëbisedues të EU EOM, kryesisht për shkak të mungesës së shërbimit postar ndërkombëtar zyrtar në mes të Kosovës dhe Serbisë. Vihet re se kjo çështje u soll në PZAP nga Nisma-AKR-PD në tre raste, dy herë gjatë procesit në QNR dhe pastaj pas publikimit të rezultateve. PZAP zbatoi aspektet procedurale të ligjit me përpikëri që bëri që çështja të merret në konsideratë në bazë të meritave vetëm pas publikimit të rezultateve dhe veçanërisht kur dihej ndikimi i anulimit të këtyre votave.

Parashtrësat për rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ

Pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ më 7 nëntor, u paraqitën 102 parashtrës nga subjektet politike dhe kandidatët individualë.¹⁵⁸ PZAP i bashkoi disa parashtrës të së njëjtës lëndë, duke marrë kështu një vendim të vetëm. PZAP miratoi ose miratoi pjesërisht 51 parashtrës dhe i dha urdhër KQZ-së të rinumërojë mbi 1,400 vendvotime. Parashtrës nga Nisma-AKR-PD (e përmendur më lart) që kërkonte përjashtimin e fletëvotimeve të votimit jashtë Kosovës nga Serbia nga rezultatet përfundimtare, u miratua gjithashtu dhe KQZ u urdhërua që t’i eliminojë këto vota nga rezultatet përfundimtare.¹⁵⁹

Natyra e disa parashtrësave të paraqitura (që madje iu referuan parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve) zbulon se ankuesit nuk e kuptojnë se çfarë korrigjimi ligjor është në dispozicion në fazat e ndryshme të procesit. Përveç kësaj, kishte ankesa që mund të ishin konsideruar nga PZAP

¹⁵⁶ Nuk kishte mundësi të paraqitej parashtrësë ndaj këtij vendimi të KQZ-së brenda 24 orëve nga koha kur u vendos që të përfshihen fletëvotimet nga Serbia meqë aktgjykimi përkatës i Gjykatës Supreme u dha disa ditë më vonë.

¹⁵⁷ Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, Komisioni i Venedikut, para.38. *Votimi me postë ose votimi me prokurë lejohet në shumë vende të botës Perëndimore, por mënyrat e tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Votimi me postë, për shembull, mund të jetë i përhapur në një vend dhe i ndaluar në një tjetër për shkak të rrezikut për mashtrim. Ai mund të lejohet vetëm në qoftë se shërbimi postar është i sigurt – me fjalë të tjera, nuk ka ndërhyrje të qëllimshme – dhe i besueshëm, në kuptimin që funksionon siç duhet...*

¹⁵⁸ Shpërndarë si më poshtë sipas subjektit politik SLS 42, LDK 23, PDK 12, Nisma-AKR-PD 6, VV 6, PKS 4, PLE 2, Koalicioni Vakati, PDAK 1, KDTP 1, NDS 1, PG 1, PAI 1 dhe JGP 1. Nga numri i përgjithshëm i parashtrësave, 44 u paraqitën nga kandidatët individualë dhe 3 nga votuesit.

¹⁵⁹ Edhe 24 parashtrës të tjera u hodhën poshtë si të paafatshme ose të palejueshme (nga të cilat 11 parashtrës nga SLS kundër KQZ-së duke kërkuar rinumërim në vendvotimet ku ishin vërejtur parregullsi gjatë ditës së zgjedhjeve), 26 u refuzuan si të pabazuara dhe një parashtrësë u konsiderua si e tërhequr.

para publikimit të rezultateve.¹⁶⁰ Në rreth 22 ankesa, të cilat tashmë ishin paraqitur pas ditës së zgjedhjeve dhe ishin hedhur poshtë, ankuesit u këshilluan që të ktheheshin pas publikimit të rezultateve nëse ende mendonin se ishin të dëmtuar. Nga këta, tetë nuk u kthyen (në disa raste disa kërkesa u bashkuan në një parashtresë) dhe më pas u shqyrtuan çështjet. Duke marrë parasysh afatet e ngushta, kjo mund të jetë qasje praktike nga PZAP për të lejuar më shumë kohë për të mbledhur prova dhe për të përgatitur siç duhet parashtresat. Sidoqoftë, dispozitat për natyrën e ankesave që mund të paraqiten gjatë procesit në QNR nuk janë të qarta dhe kjo praktikë çon në huti lidhur me afatet e paraqitjes dhe vonon certifikimin e rezultateve duke i grumbulluar parashtresat për kohën pas publikimit të rezultateve.

PZAP shqyrtoi bashkërisht 50 parashtresa (nga subjekte të ndryshme, shumica nga SLS) dhe nxori një vendim duke urdhëruar rinumërimin e rreth 1,463 vendvotimeve.¹⁶¹ PZAP vendosi që ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ në krahasim me FPR-të dhe që KQZ nuk arriti të japë prova bindëse që stafi i QNR-së kishte kontrolluar saktësinë e të dhënave të regjistruara në secilin FPR. Prandaj, paneli vlerësoi se procesi i numërimit ashtu siç ishte administruar nga KQZ gjatë auditimit nuk ishte proceduar në bazë të ligjit.¹⁶² Megjithatë, PZAP vuri në dukje se rinumërimi nuk duhej të përsëritej për vendvotimet tashmë të rinumëruara nga KQZ më parë. Brenda afatit 24-orësh, në Gjykatën Supreme u paraqitën shtatë parashtresa ndaj vendimeve të PZAP-së.¹⁶³ Në të gjitha rastet, vendimet e PZAP-së u mbështetën.¹⁶⁴ Në fund, duhet të nënvizohet se vendimi i PZAP-së për rinumërimin nuk u ankimua në Gjykatën Supreme.

Rekomandimi: Të përfshihen dispozita të qarta për kundërshtimin e rezultateve në të gjitha nivelet (vendvotim, QNR dhe rezultatet përfundimtare) në LZP. Të qartësohet lloji i ankesave dhe parashtresave dhe afatet përkatëse për to gjatë gjithë procesit në LZP. Të qartësohen kompetencat e KQZ-së dhe PZAP-së për anulimin e rezultateve dhe urdhërim të rinumërimeve.

Ankesat e paraqitura gjatë procesit të rinumërimit në QNR

PZAP mori 30 ankesa gjatë procesit të rinumërimit në QNR, 20 nga Nisma-AKR-PD dhe 10 nga VV.¹⁶⁵ Ankesat vunë në dyshim vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e 35 fletëvotimeve individuale. PZAP, pas ekzaminimit të provave të ofruara ose pas kryerjes së hetimit në QNR, i miratoi ose i refuzoi ankesat duke i vërtetuar si të vlefshme ose të pavlefshme fletëvotimet e kontestuar. Vendimet e PZAP-së për këto raste individuale pretendohet se kanë shërbyer si precedentë që

¹⁶⁰ Nisma-AKR-PD iu drejtua PZAP-së tri herë, derisa PZAP doli me vendim lëndor për fletëvotimet nga Serbia. Gjithashtu, rinumërimi tashmë ishte kërkuar nga disa parti pas ditës së zgjedhjeve.

¹⁶¹ Vendimi nr. 386/2019.

¹⁶² Neni 101.1, LZP “Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërimin dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës.”

¹⁶³ Një nga tre kandidatët e VV që do të humbnin ulëset e tyre në qoftë se Nisma-AKR-PD do të kalonte pragun dhe një nga kandidatit i Sloboda kundër vendimit të PZAP 428/2019 për fletëvotimet nga Serbia; pesë ankesa të tjera u paraqitën nga kandidatë individualë të LDK, KDTP, PLE, PDAK dhe VV.

¹⁶⁴ Përfshirë dy parashtresa për vendimin e PZAP-së që çoi në përjashtimin e fletëvotimeve të ardhura nga Serbia nga rezultatet përfundimtare. Shih paragrafin “Rastet që i referohen fletëvotimeve përmes postës të ardhura nga Serbia”.

¹⁶⁵ Përfshirë parashtresën për 392 pako të votimit jashtë Kosovës. Shih paragrafin “Rastet që i referohen fletëvotimeve përmes postës për votimin jashtë Kosovës”.

praktika të ndiqet më pas në raste të ngjashme nga stafi i QNR-së, mirëpo, është e diskutueshme nëse udhëzime të tilla u dhanë ose u ndoqën në mënyrë konsistente.

Megjithëse pas procesit të rinumërimit dhe zgjidhjes së kontesteve, rezultatet e reja sollën ndryshime në shpërndarjen e ulëseve brenda Kuvendit dhe më pas edhe te kandidatët e zgjedhur, në ligj nuk parashihet asnjë mjet juridik për kundërshtimin e rezultateve përfundimtare pas rinumërimit.¹⁶⁶ Prandaj, pas përfundimit të procesit të rinumërimit dhe shqyrtimit të të gjitha çështjeve para PZAP dhe Gjykatës Supreme, KQZ i certifikoi rezultatet më 27 nëntor duke hapur rrugën për formimin e qeverisë së re dhe Kuvendit.

Të gjitha ankesat dhe parashtresat u shqyrtuan brenda afatit të përcaktuar prej 72 orë. Rastet u zgjidhën në bazë të shkresave të paraqitura. Në përgjithësi, ankesat dhe parashtresat nuk ishin gjithmonë të argumentuara mirë dhe u dhanë prova të pakta. As vendimet e PZAP-së, as ato të Gjykatës Supreme nuk ishin gjithnjë të strukturuar mirë ose të arsyetuara në mënyrë konsistente. Baza ligjore dhe arsyetimi u përfshinë në vendime, megjithëse shkurtimisht. PZAP ndoqi qasje formaliste në shqyrtimin e çështjeve dhe shpesh bëri interpretim të ngushtë të ligjit. Paneli zbatoi dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative në mënyrë analoge, por nuk kërkoi prova në mënyrë proaktive. PZAP mund të emërojë ekipe hetimi, por kjo u vlerësua e domosdoshme për shumë pak raste të ankesat që kishin të bënin me QNR-në.¹⁶⁷ Nga ana pozitive, PZAP kontribuoi në transparencë më të madhe duke mbajtur regjistër të rasteve të paraqitura që ishte i qasshëm për publikun. Vendimet u publikuan me kohë në uebsajtin e tyre, megjithëse me disa vonesa të përkthimit të tyre në gjuhën serbe.

Veprat penale lidhur me zgjedhjet

Nëse rasti përmban elemente të veprës së mundshme penale, ai mund t'i referohet policisë për hetime të mëtejshme, ndërsa PZAP është organi kompetent për të përcaktuar përgjegjësinë administrative.¹⁶⁸ Gjashtë raste të tilla u referuan nga PZAP në polici për hetime të mëtejshme. Plani operativ i policisë dhe Koordinatorit Kombëtar për Zgjedhje në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit përfshinte angazhimin e 100 prokurorëve rajonalë në ditën e zgjedhjeve. Prokurori i Shtetit trajtoi rreth 35 raste, qoftë të ngritura ose të iniciuara sipas detyrës zyrtare bazuar në informacionet e marra nga mediat dhe shoqëria civile. Këto raste i referohen 45 të dyshuarve për vepra penale lidhur me zgjedhjet, përfshirë 11 anëtarë të këshillave të vendotimeve dhe 34 votues.¹⁶⁹ Rreth 25 persona u ndaluan përkohësisht (për 48 orë), ndërsa për dy prej tyre gjykata caktoi paraburgim.¹⁷⁰ Në kohën e shkrimit të këtij raporti, shumica e rasteve janë ende nën hetime.

¹⁶⁶ Duke përjashtuar fletëvotimet e ardhura nga Serbia, Nisma-AKR-PD e kaloi pragun.

¹⁶⁷ Ankesa nga VV lidhur me 173 fletëvotimet e votimit jashtë Kosovës të vlerësuara si të pavlefshme.

¹⁶⁸ Neni 9, Rregulla Zgjedhore nr.11/2013, KQZ, Kodi i Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

¹⁶⁹ Katër komisarë, të dyshuar se ishin përfshirë në rastin e fletëvotimeve të vjedhura në VV 2114B/01R në Runik, Komuna Skenderaj, u arrestuan pas verifikimit të materialeve të votimit në QNR.

¹⁷⁰ Gjashtë raste në Prishtinë, dhjetë në Prizren, dy në Pejë, 10 në Gjakovë, dy në Gjiilan, katër në Mitrovicë, një në Ferizaj.

Deri në fund të nëntorit, prokuroria kishte ngritur 14 aktakuza dhe dy lëndë gjyqësore ishin përfunduar.¹⁷¹

XX. SHPALLJA E REZULTATEVE

Rezultatet e para preliminare të votimit brenda Kosovës u publikuan në uebsajtin e KQZ-së menjëherë pas ditës së zgjedhjeve. Më 11 nëntor, KQZ publikoi rezultatet përfundimtare pasi përfundoi rinumërimin e 848 vendvotimeve dhe numërimin e fletëvotimeve me kusht, fletëvotimeve të personave me nevoja të veçanta dhe fletëvotimet përmes postës për votimin jashtë Kosovës. Pas vendimeve të PZAP-së dhe Gjykatës Supreme për parashtrësat ndaj rezultateve përfundimtare, u rinumëruan edhe 1,407 vendvotime të tjera dhe fletëvotimet e marra nga Serbia u përjashtuan nga numërimi. KQZ certifikoi rezultatet përfundimtare më 27 nëntor, pra 52 ditë pas ditës së zgjedhjeve. Koalicioni Nisma-AKR-PD kaloi pragun prej pesë për qind me 21 vota. Pjesëmarrja e përgjithshme ishte 44.56 për qind dhe 3.8 për qind e të gjitha fletëvotimeve të hedhura ishin të pavlefshme.

¹⁷¹ Gjegjësisht, dy në Gjilan, dy në Prizren, një në Ferizaj, një në Mitrovicë, shtatë në Gjakovë, një në Pejë. Në pajtim me nen.159, Kodi i Procedurës Penale, Prokuroria ka afat dyvjeçar për të ngritur aktakuzë. Veprat penale përfshinin veprat vijuese: neni 211 (keqpërdorimi i detyrës zyrtare); neni 212 (dhënia ose marrja e ryshfetit); neni 213 (keqpërdorimi i të drejtës së votimit); neni 214 (pengimi i procesit të votimit); neni 215 (cenimi i fshehtësisë së votimit); neni 216 (falsifikimi i rezultateve të votimit), Kodi Penal.



XXI. TABELA E REKOMANDIMEVE

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
KORNIZA LIGJORE					
1	Korniza ligjore përfshin dispozita për thirrjen e zgjedhjeve të parakohshme me paralajmërim jashtëzakonisht të shkurtër dhe që i lejojnë KQZ-së t'i shkurtojë tutje afatet, duke rritur kështu riskun e komprometimit të të drejtave zgjedhore. Kjo kohë e kufizuar nuk garanton përgatitje të duhura zgjedhore, procesin e votimit jashtë Kosovës, kontrollin publik të listës së votuesve dhe kundërshtimet e mundshme të listave të kandidatëve, etj. Faqe 14	Zgjedhjet e parakohshme të thirren me paralajmërim prej të paktën dy muaj për të lejuar kohë të mjaftueshme për përgatitjet e duhura zgjedhore dhe për fushatën zgjedhore.	K – Kushtetuta LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës	ZGJEDHJE PERIODIKE, LIRIA E SHPREHJES SË MENDIMIT, ZGJEDHJE TË MIRËFILLTA QË PASQYROJNË SHPREHJEN E LIRË TË VULLNETIT TË VOTUESVE ICCPR, neni 25 “Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (b) Të votojë dhe të zgjedhet në zgjedhje të mirëfillta të herëpashershme, me të drejtë vote universale dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, duke garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; ICCPR, neni 25, HRC GC 25 “1. Neni 25 i Paktit njihet dhe mbrohet të drejtën e çdo qytetari për të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur dhe të drejtën për të pasur qasje në shërbimin publik. Çfarëdo qoftë forma e kushtetutës apo qeverisë në fuqi, Pakti kërkon që Shtetet të adoptojnë masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar që qytetarët kanë mundësi efektive për të gëzuar të drejtat që mbrohen me Pakt.”

¹⁷² K = kushtetuta LP = legjislacioni primar D = e dëshirueshme të parashihet me ligj

*Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe mendimin e GJND për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
2	Ligji parasheh rregulloret e fushatës që synojnë sigurimin e barazisë së mundësive për garuesit dhe paanshmërinë e administratës publike gjatë fushatës. Periudha zyrtare e fushatës u shkurtua në vetëm 10 ditë. Faqe 13	Periudha e fushatës për zgjedhje të parakohshme të zgjatet në 30 ditë, siç është në rastin e zgjedhjeve të rregullta. Rregullat e fushatës që lidhen me njoftimin dhe organizimin e ngjarjeve politike, rregullat për postimet zgjedhore dhe rregullat për përfshirjen e zyrtarëve të zgjedhur në fushatën zgjedhore të zhvillohen më shumë në LZP.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KQZ-së	Kuvendi i Kosovës KQZ	ZGJEDHJE TË MIRËFILLTA QË PASQYROJNË SHPREHJEN E LIRË TË VULLNETIT TË VOTUESVE ICCPR neni 19.2 “Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve”. ICCPR, neni 25, HRC GC 25, para. 20 “Zgjedhësit do të duhej të jenë plotësisht të informuar për këto garanci.” HRC GC 25 para. 19: “Personat që kanë të drejtë të votojnë duhet të jenë të lirë të mbështesin ose të kundërshtojnë qeverinë, pa ndikim ose shtrëngim pavend të çfarëdo lloji që mund të shtrembërojë ose frenojë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësit. Votuesit duhet të jenë në gjendje të formojnë opinionet në mënyrë të pavarur, pa dhunë ose kërcënim me dhunë, detyrim, nxitje ose ndërhyrje manipuluese të çfarëdo lloji.”
3	Aspekte të rëndësishme të procesit siç janë regjistrimi dhe funksionimi i partive politike, procedurat në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), rregullat për rinumërimin dhe anulimin e rezultateve rregullohen me legjislacion sekondar, gjegjësisht me Rregulloret e	Aspektet thelbësore të procesit, të përcaktuara aktualisht në rregulloret e KQZ-së, p.sh. veprimet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, rregullat për rinumërimin dhe anulimin e rezultateve, të përfshihen në legjislacionin primar.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KQZ-së	Kuvendi i Kosovës KQZ	SUNDIMI I LIGJIT, TRANSPARENCA DHE QASJA NË INFORMACION ICCPR, neni 19, HRC GC 25, para. 25 “Një normë, në mënyrë që të cilësohet si “ligj”, duhet të formulohet me përpikëri të mjaftueshme për t’i mundësuar qytetarit të rregullojë përshtatshmërisht sjelljen e tij/saj dhe duhet të jetë e qasshme për publikun...”. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB për të Drejtat e Njeriut 19/36, 2012, para. 16 [Këshilli i të Drejtave të Njeriut] “u bën thirrje Shteteve të bëjnë

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	KQZ-së. Kjo e bën procesin të cënueshëm nga ndryshimet e minutës së fundit duke minuar sigurinë ligjore. Faqe 12				përpjekje të vazhdueshme për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të promovuar demokracinë duke: (c) Siguruar ofrimin e masës së mjaftueshme të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë në zbatimin e ligjit, në mënyrë që të shmangët çdo arbitraritet”. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, Komisioni i Venedikut 2002, para. 2 “Nivelet normative dhe qëndrueshmëria e të drejtës zgjedhore a. Përveç rregullave teknike dhe atyre për hollësira - të cilat mund të përfshihen në rregulloret e ekzekutivit - rregullat e të drejtës zgjedhore duhet të nxirren të paktën në nivelin e ligjit.”; para. 63 “Qëndrueshmëria e ligjit ka rëndësi kritike për besueshmërinë e procesit zgjedhor, i cili vetë ka rëndësi jetike për konsolidimin e demokracisë. Rregullat, të cilat ndryshojnë shpesh – dhe veçanërisht rregullat të cilat janë të ndërlikuara – mund të shkaktojnë huti të votuesit. Mbi të gjitha, votuesit mund të arrijnë në konkluzionin, me të drejtë apo jo, se ligji zgjedhor është një mjet në duart e të fuqishmëve, dhe se votat e tyre nuk kanë shumë peshë në përcaktimin e rezultateve të zgjedhjeve.”
KONTESTET ZGJEDHORE					
4	Sipas ligjit, ekzistojnë mekanizmat për ankesa dhe parashtrës, por procesi i zgjidhjes së kontesteve, ashtu siç zbatohet aktualisht, nuk parashikon korrigjim efektiv ligjor të formës së plotë. Afatet	Të zgjaten afatet e paraqitjes së ankesave apo parashtrësve zgjedhore në 48 orë dhe afatet e vendosjes nga PZAP në 96 orë.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregullorja e Punës e PZAP-së	Kuvendi i Kosovës PZAP KQZ	E DREJTA PËR MJET EFEKTIV JURIDIK, SUNDIMI I LIGJIT ICCPR, neni 2.3 “(a) Të sigurojë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv, edhe atëherë kur shkelen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare; (b) Të sigurojë që autoriteti

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	e përcaktuara (24 orë për ankuesit/parashtruesit dhe 72 orë për PZAP) konsiderohen jashtëzakonisht të shkurtra si për palët - për t'i mbledhur provat e nevojshme, ashtu dhe për organet shqyrtuese - për t'i ekzaminuar dhe vlerësuar ato si duhet. Faqe 43		Rregulloret e KQZ-së		kompetent gjyqësor, administrativ ose legjislativ, ose çdo autoritet tjetër që është kompetent në bazë të legjislacionit të shtetit do t'i përcaktojë të drejtat e këtij personi që paraqet mjetin juridik, si dhe të zhvillojë mundësitë e paraqitjes së mjetit juridik; (c) Të sigurojë që autoritetet kompetente veprojnë sipas çdo mjeti juridik që njihet si i përligjur.” UDHR, neni 8 “Secili ka të drejtë që me mjete juridike efektive para gjykatave kompetente kombëtare të mbrohet nga veprimet e shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me kushtetutë a me ligj”. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, Komisioni i Venedikut 2002, para. 95 “Përveç kësaj, vendimet për rezultatet e zgjedhjeve nuk duhet të vonohen, veçanërisht nëse klima politike është e tendosur. Kjo nënkupton që afatet kohore për ankim duhet të jenë shumë të shkurtra dhe që organi i ankimit duhet ta marrë vendimin e tij sa më shpejt që të jetë e mundur. Megjithatë, këto afate kohore duhet të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e të drejtës për mbrojtje si dhe marrjen e vendimit të peshuar mirë. Afati kohor prej tri deri në pesë ditë në shkallën e parë (duke përfshirë paraqitjen e ankimit dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm për vendime që merren para zgjedhjeve. Megjithatë, është e lejueshme që t'u jepet pak më shumë kohë Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese për të marrë vendimet e tyre.”

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
5	Në mungesë të bazës ligjore të qëndrueshme për të kundërshtuar rezultatet e pjesshme preliminare, asnjë ankesë nuk mund të shqyrtohet ndërkohë që procesi në QNR është në vazhdim e sipër. Subjektet politike u këshilluan të ktheheshin pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ nëse ende mendojnë se janë të dëmtuara, d.m.th. nëse ankesa e tyre nuk është adresuar nga KQZ gjatë procesit në QNR. Do të duhej të theksohet se llojet e vendimeve të KQZ ndaj të cilave mund të ushtrohet ankim janë të listuara shprehimisht në LZP dhe kundërshtimi i rezultateve preliminare nuk është i përfshirë. Faqe 49	Të përfshihen dispozita të qarta për kundërshtimin e rezultateve në të gjitha nivelet (vendvotim, QNR dhe rezultatet përfundimtare) në LZP. Të qartësohet lloji i ankesave dhe parashtrësive dhe afatet përkatëse për to gjatë gjithë procesit në LZP. Të qartësohen kompetencat e KQZ-së dhe PZAP-së për anulimin e rezultateve dhe urdhërim të rinumërimeve.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KQZ-së	Kuvendi i Kosovës KQZ	E DREJTA PËR MJET EFEKTIV JURIDIK, SUNDIMI I LIGJIT ICCPR neni 2.3(b) “Të sigurojë që autoriteti kompetent gjyqësor, administrativ ose legjislativ, ose çdo autoritet tjetër që është kompetent në bazë të legjislacionit të shtetit do t’i përcaktojë të drejtat e këtij personi që paraqet mjetin juridik, si dhe të zhvillojë mundësitë e paraqitjes së mjetit juridik.” ICCPR, GC 25 para. 20 “Do të duhej të ketë kontroll të pavarur të procesit të votimit dhe numërimit dhe qasje në shqyrtimin gjyqësor ose procesin tjetër ekuivalent, në mënyrë që zgjedhësit të kenë besim në sigurinë e votës dhe numërimin e votave”. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, Komisioni i Venedikut 2002, para. 97 “Është gjithashtu me rëndësi jetike që procedura e ankimit, veçanërisht kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të ndryshme që përfshihen në të, të rregullohen qartësisht me ligj, në mënyrë që të shmangen konfliktet e juridiksionit, qofshin pozitive apo negative.”
PJESËMARRJA E GRAVE					
6	Bashkëbiseduesit e EU EOM shprehën mendimin se gratë nuk po luajnë rol si udhëheqëse dhe vendimmarrëse dhe me sa	Partitë politike të konsiderojnë adoptimin e politikave të brendshme për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe	LP – LFSP Ndryshimi i rregulloreve të brendshme të	Kuvendi i Kosovës	E DREJTA E BARABARTË E VOTËS, LIRIA NGA DISKRIMINIMI, PJESËMARRJA E GRAVE NË PUNËT PUBLIKE / BARAZIA MIDIS BURRAVE DHE GRAVE

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	duket përballen me pengesa shoqërore dhe familjare për t'u propozuar për pozitë të zgjedhur ose për të bërë fushatë të suksesshme. Faqe 36	integrimin e çështjeve gjinore në platformat partiake. Të rriten fondet publike për partitë që promovojnë barazinë gjinore.	punës të partive politike		Komiteti CEDAW, GR 23, paragrafi 34 “Partitë politike kanë detyrim të demonstrojnë zotimin e tyre ndaj parimit të barazisë gjinore në kushtetutat e tyre...në këshillat e tyre drejtuese.” Komiteti CEDAW, GR 23, paragrafi 28 “Partitë politike kanë përgjegjësi të sigurojnë që gratë përfshihen në listat partiake dhe propozohen aty ku ato kanë gjasë për sukses zgjedhor.”
7	Prania e grave në administrimin e zgjedhjeve mbetet e ulët. Edhe pse KQZ kryesohet nga një grua, vetëm dy nga 10 anëtarët e KQZ-së dhe 14 për qind e anëtarëve të KQZ-ve ishin gra. Faqe 36	KQZ të rrisë pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KQZ-së	Kuvendi i Kosovës KQZ	LIRIA NGA DISKRIMINIMI, PJESËMARRJA E GRAVE NË PUNËT PUBLIKE / BARAZIA MIDIS BURRAVE DHE GRAVE ICCPR, neni 3 “Shtetet Palë të këtij Pakti zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas lidhur me gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike të përcaktuara në këtë Pakt.” CEDAW, neni 7 “Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për eliminimin e diskriminimit ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe veçanërisht t’ua sigurojnë grave në mënyrë të barabartë me burrat, të drejtat e mëposhtme: (a) Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike dhe që të kenë të drejtë për t’u zgjedhur në të gjitha organet e zgjedhura publike; [...]” CEDAW, GR 25, në nenin 4, para. 1 “...Së treti, Shteteve Palë kanë detyrim të adresojnë marrëdhëniet mbizotëruese gjinore dhe ngulmin e stereotipave me bazë gjinore që prekin gratë jo vetëm përmes akteve individuale nga individët, por edhe në ligj, dhe strukturat dhe institucionet juridike dhe shoqërore.”

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE					
8	Edhe pse numri i votave të pavlefshme ishte më i ulët se në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017, ai përsëri mbeti i lartë, rreth 4 për qind. Faqe 17	Të përmirësohet dizajni i fletëvotimit për zgjedhjet parlamentare për ta bërë më lehtë të kuptueshëm për votuesit dhe të rritet ndjeshëm edukimi i votuesve përpara çfarëdo zgjedhjeve, duke u përqendruar në trevat ku numri i votave të pavlefshme është tradicionalisht i lartë.			E DREJTA DHE MUNDËSIA PËR TË VOTUAR DHE TRANSPARENCA DHE QASJA NË INFORMACION ICCPR, Komenti i përgjithshëm 25, para. 11 <i>“Fushatat për edukim dhe regjistrim të votuesve janë të nevojshme për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të parapara në nenin 25 nga komuniteti i informuar.”</i> ICCPR, Komenti i përgjithshëm 25, para. 12 <i>“Informacioni dhe materialet rreth votimit do të duhej të jenë në dispozicion në gjuhët e pakicave. Metodatat specifike, siç janë fotografitë dhe simbolet, do të duhej të përdoren për të siguruar që votuesit analfabetë kanë informacione adekuate mbi të cilat mund të bazohet zgjedhja e tyre.”</i>
REGJISTRIMI I VOTUESVE					
9	Saktësia dhe besueshmëria e listës së votuesve është problem i kahmotshëm për zgjedhjet në Kosovë. Kosova ka më shumë votues të regjistruar sesa popullsia e vlerësuar rezidente. Lista përfundimtare e votuesve përfshin shumë persona që kanë ndërruar jetë meqë nuk ekziston sistemi efektiv për	Të përmirësohet saktësia e listës së votuesve, ndër të tjera, duke futur në përdorim një mekanizëm për heqjen sistematike të personave të ndjerë nga regjistri civil dhe më pas nga lista e votuesve.	KQZ Agjencia e Regjistrimit Civil	KQZ Agjencia e Regjistrimit Civil	E DREJTA UNIVERSALE E VOTËS, E DREJTA DHE MUNDËSIA PËR TË VOTUAR ICCPR neni 25 “zgjedhje..., me të drejtë universale dhe të barabartë të votës.” Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut, Këshilli i Evropës, 1.2.ii <i>“Duhet të ketë përditësime të rregullta (të regjistrave zgjedhore), të paktën një herë në vit.”</i>

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	heqjen sistematike të tyre nga lista. Faqe 20				
VOTIMI, NUMËRIMI DHE TABELIMI					
10	Auditimi në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve zbuloi se një numër i madh i kryesuesve të KVV-ve nuk ishin në gjendje të plotësonin saktë formularët e rezultateve në vendvotim dhe për rrjedhojë, fletëvotimet e hedhura në vendvotimet në fjalë duhej të rinumërohen. Si në KQZ ashtu edhe në KKZ aktualisht është nga një anëtar jopartiak. Faqe 17	Të konsiderohet futja e një pozite jopartiake të anëtarit/sekretarit në KVV, për të ofruar mbështetjen e nevojshme këshilluese dhe administrative për kryesuesin e KVV.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KQZ-së	Kuvendi i Kosovës KQZ	ZGJEDHJE TË MIRËFILLTA QË PASQYROJNË SHPREHJEN E LIRË TË VULLNETIT TË VOTUESVE ICCPR, Komenti i përgjithshëm 25, para. 20 “Një autoritet i pavarur zgjedhor do të duhej të themelohet për të mbikëqyrur procesin zgjedhor dhe për të siguruar që ai zhvillohet në mënyrë korrekte, të paanshme dhe në përputhje me ligjet e përcaktuara.”
11	Regjistrimi dhe votimi i votuesve jashtë Kosovës u ndikuan negativisht nga korniza kohore e ngjeshur. Ekziston mungesë e masave mbrojtëse kundër mashtrimit në sistemin e votimit me anë të postës për votuesit jashtë Kosovës. Faqe 19	Të konsiderohet prezantimi i afateve më të gjata, në rast të zgjedhjeve të parakohshme, dhe masa mbrojtëse shtesë për të përmirësuar gjithëpërfshirjen dhe integritetin e procesit të votimit jashtë Kosovës. Masat mbrojtëse do të mund të përfshinin aplikimin vetëm me shkrim dhe të nënshkruar	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KQZ-së	Kuvendi i Kosovës KQZ	E DREJTA DHE MUNDËSIA PËR TË VOTUAR ICCPR, Komenti i Përgjithshëm 25, Paragrafi 11 “Shtetet duhet të marrin masa efektive për të siguruar që të gjithë personat që kanë të drejtë të votojnë janë në gjendje ta ushtrojnë atë të drejtë. Regjistrimi i votuesve, në rastet kur kërkohet, do të duhej të lehtësohet dhe nuk do të duhej të vendosen pengesa ndaj regjistrimit të tillë.” ICCPR, Komenti i përgjithshëm 25, paragrafi 20 “Do të duhej të ketë kontroll të pavarur të procesit të votimit dhe numërimit dhe qasje në shqyrtimin gjyqësor ose procesin tjetër ekuivalent, në mënyrë që zgjedhësit

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
		nga aplikuesi, votimin vetëm me fletëvotim të dërguar në adresën postare të votuesit jashtë vendit, ose fletëvotimi i dërguar me postë të jetë i shoqëruar me konfirmimin e nënshkruar nga votuesi se fletëvotimi është plotësuar në fshehtësi dhe nga votuesi dora vetë.			<i>të kenë besim në sigurinë e votës dhe numërimin e votave.”</i>
AMBIENTI I FUSHATËS					
12	Në periudhën në prag të zgjedhjeve, pati shpallje për subvencione dhe vende pune në sektorin publik, si nga ana e qeverisë qendrore ashtu edhe nga autoritetet komunale të Kosovës, të cilat me sa duket kishin për qëllim realizimin e avantazhit politik për subjektet në pushtet. Faqe 22	Të parashihet në mënyrë specifike në kornizë ligjore ndalimi i përgjithshëm i keqpërdorimit të resurseve administrative për avantazh politik nga qeveria qendrore dhe autoritetet komunale gjatë proceseve zgjedhore. Ndalimi të vendoset në mënyrë të qartë dhe të parashikueshme.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës	PARANDALIMI I KORRUPSIONIT / KORREKTËSIA NË FUSHATËN ZGJEDHORE Komisioni i Venedikut, Udhëzime të përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore (2016), Kapitulli A, neni 1.1 <i>Korniza ligjore do të duhej të parashikojë një ndalim të përgjithshëm të keqpërdorimit të resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore. Ndalimi duhet të vendoset në mënyrë të qartë dhe të parashikueshme. Sanksionet për keqpërdorim të resurseve administrative duhet të parashikohen dhe të implementohen. Sanksionet e tilla duhet të jenë të zbatueshme, proporcionale dhe dekurajuese.</i> Komisioni i Venedikut, Udhëzime të përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
					të resurseve administrative gjatë proceseve zgjedhore (2016), Kapitulli B, neni 1.4 “Korniza ligjore do të duhej të përcaktojë se nuk do të duhej të ketë emërime jo-thelbësore në organet publike gjatë fushatës zgjedhore.”
13	Subjektet iu nënshtruan rregulloreve të paqarta, të ndryshueshme dhe arbitrare gjatë fushatës zyrtare që zvogëluan lirinë e tyre për fushatë për shkak të gjobave joproporcionale. Për shembull, PZAP gjobiti disa kandidatë për shkak se kishin postuar në Facebook foto të takimeve të tyre me policinë, etj. kur po bënë fushatë rreth ligjit dhe rendit. Tutje, kufizimet për të parandaluar pjesëmarrjen e të miturve ishin hartuar dobët, u ndryshuan gjatë fushatës dhe ishin arbitrare. Faqe 21	Çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të përcaktohet me ligj, të jetë i domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe të ketë për qëllim objektiva të caktuara konkrete, një prej të cilave do të mund të ishte parandalimi i trazirave apo krimit. Çdo kufizim duhet të vlejë në mënyrë të barabartë për të gjitha rastet që i plotësojnë kushtet e përcaktuara.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Rregulloret e KQZ-së	Kuvendi i Kosovës KQZ	LIRIA E MENDIMIT DHE E SHPREHJES ICCPR neni 19 (2) “Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve”. ICCPR Komenti i përgjithshëm 34, neni 19: Liria e mendimit dhe shprehjes Vërejtje të përgjithshme 34 & 35. “Kufizimet nuk duhet të jenë të tepruara... masat kufizuese duhet të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit; ato duhet të jenë të përshtatshme për të realizuar funksionin e tyre mbrojtës; ato duhet të jenë instrumenti më pak ndërhyrës midis atyre që mund të realizojnë funksionin e tyre mbrojtës; ato duhet të jenë proporcionale me interesin që mbrohet... Parimi i proporcionalitetit duhet të respektohet jo vetëm në ligjin që përcakton kufizimet, por edhe nga autoritetet administrative dhe gjyqësore që zbatojnë ligjin... Kur Shteti Palë thirret në bazë legjitime për kufizim të lirisë së shprehjes, ai duhet të tregojë në mënyrë specifike dhe të individualizuar natyrën e saktë të kërcënimit, si dhe domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimit specifik të ndërmarrë, veçanërisht duke krijuar lidhje të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme midis shprehjes dhe kërcënimit.”

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
					Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCPNM) (1995) neni 9.1. “Palët angazhohen të pranojnë se e drejta e lirisë së shprehjes së çdo personi që i përket një pakice kombëtare përfshin lirinë për të pasur mendime, dhe për të marrë dhe shpërndarë informacione e ide në gjuhën e pakicës, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë.”
14	Disa parti dhe autoritete ushtruan presion të pavend ndaj kandidatëve, familjeve të tyre, mbështetësve dhe votuesve në përgjithësi. Në disa raste ka pasur reagime të pamjaftueshme nga autoritetet në komunat me shumicë të serbëve të Kosovës në lidhje me këto pretendime. Faqe 24	Të drejtat themelore demokratike mund të mbrohen më fuqishëm dhe në mënyrë të menjëhershme nga autoritetet në të gjithë Kosovën për të siguruar që të gjithë kandidatët, familjet e tyre, ata që bëjnë fushatë dhe përkrahësit, si dhe votuesit, marrin pjesë lirshëm në të gjitha aspektet e jetës demokratike. Qytetarët mund të kenë më shumë informacion se si të ankohen pranë autoriteteve përkatëse për pretendimet e frikësimit zgjedhor.	D = kërkon zbatim më të mirë të legjislacionit ekzistues.	Përgjegjësi e autoriteteve qendrore dhe komunale, policisë, prokurorisë, Avokatit të Popullit dhe partive politike.	LIRIA E MENDIMIT DHE E SHPREHJES, E DREJTA PËR MJET EFEKTIV JURIDIK ICCPR, neni 25, HRC GC 25: paragrafi 19: “Personat që kanë të drejtë të votojnë duhet të jenë të lirë të mbështesin ose të kundërshtojnë qeverinë, pa ndikim ose shtrëngim pavend të çfarëdo lloji që mund të shtrembërojë ose frenojë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësit. Votuesit duhet të jenë në gjendje të formojnë opinionet në mënyrë të pavarur, pa dhunë ose kërcënim me dhunë, detyrim, nxitje ose ndërhyrje manipuluese të çfarëdo lloji.” ECHR, neni 13 “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmeshje të funksioneve të tyre zyrtare.” ICCPR, neni 2.3 “Çdo Shtet Palë i këtij Pakti zotohet: (a) Të sigurojë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv, edhe atëherë kur shkeljen e kryejnë

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
					personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare; (b) Të sigurojë që autoriteti kompetent gjyqësor, administrativ ose legjislativ, ose çdo autoritet tjetër që është kompetent në bazë të legjislacionit të shtetit do t'i përcaktojë të drejtat e këtij personi që paraqet mjetin juridik, si dhe të zhvillojë mundësitë e paraqitjes së mjetit juridik.” (c) Të sigurojë që autoritetet kompetente veprojnë sipas çdo mjeti juridik që njihet si i përligjur.”
FINANCIMI I FUSHATËS					
15	Ligji parashikon ndalime për burime të caktuara të donacioneve, përfshirë edhe nga kontraktuesit publikë, madje tre vjet pas përfundimit të kontratës. Ligji gjithashtu përcakton kufijtë e donacioneve nga individët dhe personat juridikë. Sidoqoftë, nuk ka asnjë mekanizëm për të kontrolluar nëse donacioni është nga burimi i palejueshëm ose ka donacione të shumëfishta nga i njëjti donator duke tejkalluar kufirin e donacioneve. Faqe 26	Të vendoset një mekanizëm efektiv për verifikimin e ligjshmërisë së donacioneve. Mekanizmi i tillë mund të përfshijë mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe do të duhej të mundësojë kontrollin e gërshetuar të donatorëve kundrejt databazës së kontraktuesve të prokurimeve publike dhe të identifikojë donacionet e shumëfishta nga një donator i vetëm.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme LP – LFSP	Kuvendi i Kosovës	PARANDALIMI I KORRUPSIONIT, TRANSPARENCA DHE QASJA NË INFORMACION UN CAC, neni 9.1 “për të vendosur sisteme të përshtatshme prokurimi, bazuar mbi transparencën, konkurrencën dhe kriteret objektive në vendimmarrje, që, ndërmjet të tjerash, janë të efektshme në parandalimin e korrupsionit.” Këshilli i Evropës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2003) 4, neni 3.a “Masat e marra nga shtetet që rregullojnë donacionet për partitë politike do të duhej të ofrojnë rregulla specifike për: shmangien e konflikteve të interesit; sigurimin e transparencës së donacioneve dhe shmangien e donacioneve sekrete; shmangien e paragjyimeve ndaj aktiviteteve të partive politike; sigurimin e pavarësisë së partive politike.” Këshilli i Evropës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2003) 4, neni 5.b “Shtetet do të duhej të

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
					<i>marrin masa që kufizojnë, ndalojnë ose ndryshe rregullojnë në mënyrë të rreptë donacionet nga personat juridikë që ofrojnë mallra ose shërbime për administratën publike.”</i>
16	Ligji parashikon që të gjitha shpenzimet e bëra për qëllime të fushatës duhet të raportohen madje edhe nëse ato janë bërë para thirrjes së zgjedhjeve. Bashkëbiseduesit e EU EOM vunë në pah se partitë ngurrojnë të raportojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e tyre për shkak të ligjshmërisë së tyre të dyshimtë. Nuk ka kërkesë ligjore për të përfshirë imprint me informacione mbi numrin e kopjeve, botuesin dhe paguesin në materialet e shtypura të fushatës, gjë që nuk e garanton gjurmimin e këtyre shpenzimeve. Faqe 26	Të gjitha materialet e shtypura dhe dixhitale të fushatës duhet të etiketohen qartë me informacione rreth organizatës sponsorizuese dhe të japin përshkrim të sanksioneve për mospërmblidhje dhe moszbatimin efektiv.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës	PARANDALIMI I KORRUPSIONIT, TRANSPARENCA DHE QASJA NË INFORMACION UN CAC, neni 7.3 “konsideron të marrë masa të përshtatshme, legjislative dhe administrative [...] për të rritur transparencën në financimin e kandidaturave për postin e zgjedhur publik dhe, kur është e zbatueshme, financimin e partive politike.” UN CAC, neni 12.1 “...merr masa për të parandaluar korrupsionin në sektorin privat, forcuar standardet e kontabilitetit dhe auditimit në sektorin privat dhe, nëse është e përshtatshme, cakton dënime të efektshme, proporcionale dhe dekurajuese - civile, administrative dhe penale, për mosrespektimin e këtyre masave.” UN CAC, neni 12.3 “Me qëllim që të parandalohet korrupsioni, secili Shtet Palë merr ato masa që janë të nevojshme, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, për mbajtjen e librave dhe të regjistrave, dhënien e deklarimeve financiare dhe standardet e kontabilitetit dhe të auditimit...me qëllim të kryerjes së një prej veprave penale të parashikuara sipas kësaj Konvente.”
17	Fushata e palëve të treta nga organizatat e lidhura me subjektet politike nuk është e	Të përcaktohet me ligj raportimi i ndërmjetëm i të ardhurave dhe	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës	TRANSPARENCA DHE QASJA NË INFORMACION

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	rregulluar me ligj. Subjektet politike e kanë për detyrim të paraqesin raporte të financimit të fushatës në KQZ vetëm pas ditës së zgjedhjeve brenda 45 ditëve, gjë që nuk ofron transparencë dhe mbikëqyrje para ditës së zgjedhjeve. KQZ i publikon raportet financiare vetëm pas marrjes së konkluzioneve të auditimit, që e vonon shpalosjen për disa muaj apo edhe vite. Nga subjektet politike kërkohet të publikojnë raportet e tyre vjetore deri në korrik dhe raportet e tyre të financimit të fushatës brenda gjashtë muajve nga dita e zgjedhjeve, gjë që nuk siguron shpalosje me kohë. Shablloni i standardizuar nga KQZ nuk kërkon informacion të zbërthyer dhe nuk publikohet në mënyrë lehtësisht të arritshme. Pavarësisht kërkesës ligjore, shumica e partive nuk i publikojnë	shpenzimeve të garuesve gjatë periudhës së fushatës, si dhe brenda 30 ditëve nga dita e zgjedhjeve. Raportimi do të duhej të përfshijë financat e kandidatëve të propozuar nga partitë dhe subjektet që bëjnë fushatë për garuesit (palë të treta). Ligji të përcaktojë një afat të shkurtër për autoritetet e mbikëqyrjes dhe subjektet politike për publikimin e të gjitha raporteve financiare në mënyrë lehtësisht të arritshme.	LP – LFSP		Këshilli i Evropës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2003) 4, neni 11 “Shtetet do të duhej t’u kërkojnë partive politike dhe subjekteve të lidhura me partitë politike të përmendura në nenin 6 [subjektet e lidhura me partitë politike] të mbajnë libra dhe llogari të rregullta. Llogaritë e partive politike do të duhej të konsolidohen për të përfshirë, sipas nevojës, llogaritë e subjekteve të përmendura në nenin 6.” Këshilli i Evropës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2003) 4, neni 13 “Shtetet do të duhej t’u kërkojnë partive politike t’i paraqesin llogaritë e përmendura në nenin 11 rregullisht, dhe të paktën çdo vit, tek autoriteti i pavarur i përmendur në nenin 14. Shtetet do të duhej të kërkojnë nga partitë politike rregullisht, dhe të paktën çdo vit, t’i bëjnë publike llogaritë e përmendura në nenin 11 ose si minimum një përmbledhje të atyre llogarive, përfshirë informacionin e kërkuar në nenin 10, sipas nevojës dhe në nenin 12.” KV, Udhëzime për Partitë Politike, para. 200. “raportet e financimit të fushatës do të duhej të dorëzohen pranë autoriteteve përkatëse brenda afatit kohor prej jo më shumë se 30 ditë pas zgjedhjeve. Raportet e tilla do të duhej të kërkohen jo vetëm për partinë në tërësi, por edhe për kandidatët individualë dhe listat e kandidatëve. Ligji do të duhej të përkufizojë formatin e raporteve në mënyrë që partitë të shpalosin të gjitha kategoritë e informacionit të kërkuar dhe të mund të krahasohet që informacioni nga partitë e ndryshme. Në përpjekje për të mbështetur

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	raportet e tyre financiare në uebsajtet e tyre. Faqe 27				<i>transparencën, është praktikë e mirë që raportet e tilla financiare me kohë të vihen në dispozicion në internet.”</i>
18	Auditorëve u kërkohet të verifikojnë përmbajtjen e raporteve financiare, por jo të identifikojnë të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara, gjë që kufizon fushëveprimin e mbikëqyrjes. Në të kaluarën, raportet e auditimit identifikuan pasaktësi në shumë raporte financiare të partive, por nuk u shqiptuan sanksione. [...] Auditorëve u kërkohet të verifikojnë përmbajtjen e raporteve financiare, por jo të identifikojnë të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara, gjë që kufizon fushëveprimin e mbikëqyrjes. Faqe 28	Auditimi i financave të partive dhe fushatave të përfshijë identifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të paraportuara. Të vendoset një mekanizëm efektiv për monitorimin dhe vlerësimin e vlerës së shpenzimeve të fushatës, përfshirë fushatën mediatike dhe dixhitale.	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme LP – LFSP	Kuvendi i Kosovës	PARANDALIMI I KORRUPSIONIT, TRANSPARENCA, QASJA NË INFORMACION Këshilli i Evropës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2003) 4, neni 3.b “Shtetet do të duhej të parashikojnë që donacionet për partitë politike të bëhen publike, në veçanti donacionet që tejkalojnë një tavan fiks; të konsiderojnë mundësinë e futjes së rregullave që kufizojnë vlerën e donacioneve për partitë politike; të adoptojnë masa për të parandaluar anashkalimin e tavaneve të përcaktuara.” Këshilli i Evropës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2003) 4, neni 14 “Shtetet do të duhej të parashikojnë monitorim të pavarur në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore. Monitorimi i pavarur do të duhej të përfshijë mbikëqyrjen e llogarive të partive politike dhe shpenzimet e përfshira në fushatat zgjedhore, si dhe prezantimin dhe publikimin e tyre.” 2001 PACE Rekomandimi 1516 për Financimin e Partive Politike 8.d “Shtetet do të duhej të krijojnë organe të pavarura auditimi të pajisura me kompetenca të mjaftueshme për të mbikëqyrur llogaritë e partive politike dhe shpenzimet lidhur me fushatat zgjedhore.”
19	KQZ ka resurse të pamjaftueshme dhe ligji nuk i jep asnjë kompetencë hetimore për të identifikuar	Të sigurohet krijimi i mekanizmit të pavarur për mbikëqyrje efektive të financave të partive dhe	LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës	TRANSPARENCA DHE QASJA NË INFORMACION UN CAC neni 6.2 “Secili Shtet Palë i jep organit ose organeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	parregullsitë. Nuk ka asnjë mekanizëm për të verifikuar respektimin e ndalimeve të donacioneve nga burimet e caktuara, as për të identifikuar nëse shumica e përgjithshme e donacioneve nga një donator i vetëm e ka tejkaluar kufirin e lejuar. Auditorëve u kërkohet të verifikojnë përmbajtjen e raporteve financiare, por jo të identifikojnë të ardhurat dhe shpenzimet e paraportuara, gjë që kufizon fushëveprimin e mbikëqyrjes. Faqe 28	fushatave, të cilit i është dhënë mandati, autoriteti, si dhe resurset financiare dhe njerëzore për të monitoruar në mënyrë efektive dhe pro-aktive, për të hetuar pretendimet për parregullsi të financimit të fushatës dhe për të shqiptuar sanksione.	LP – LFSP		<i>pavarësinë e nevojshme, në përputhje me parimet themelore të sistemit të tij të drejtësisë, për t'i dhënë mundësi organit ose organeve për të kryer funksionet e tyre me efektivitet dhe të lirë nga çdo ndikim i parregullt. Resurset e nevojshme materiale dhe personeli i specializuar, si dhe kualifikimi i nevojshëm që ky personel të mund të kryejë funksionet e tij, do të duhej të ofrohen.”</i> 2001 PACE Rekomandimi 1516 për Financimin e Partive Politike 8.d “Shtetet do të duhej të krijojnë organe të pavarura auditimi të pajisura me kompetenca të mjaftueshme për të mbikëqyrur llogaritë e partive politike dhe shpenzimet lidhur me fushatat zgjedhore.” Këshilli i Evropës, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2003) 4, neni 16 “Shtetet do të duhej të kërkojnë që shkelja e rregullave në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatat zgjedhore t'i nënshtrohet sanksioneve efektive, proporcionale dhe dekurajuese.”
MEDIAT					
20	Gjatë fushatës zgjedhore, përmbajtja me pagesë në disa kanale TV private arriti 42 deri 61 për qind të mbulimit të përgjithshëm për zgjedhjet në kohën e shikueshmërisë më të madhe. Nga kjo përfituan subjektet politike më të pasura dhe u cënuan fushë-loja e barabartë. Përveç kësaj,	Të merret në konsideratë rregullimi i mëtejshëm i blerjes së kohës së emetimit nga subjektet politike në mediat transmetuese. Kjo do të duhej të ketë për synim sigurimin e kushteve të barabarta dhe mosdiskriminuese për	D - KPM me ligj për komunikimet audio-vizuale komerciale LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	KPM Kuvendi i Kosovës	Parandalimi i korrupsionit / Korrektësia në fushatën zgjedhore VC CGP para. 2.3 “Barazia e mundësive duhet të garantohet si për partitë ashtu dhe për kandidatët... Financimet e partive politike, kandidatëve, dhe fushatës zgjedhore duhet të jenë transparente... Në disa raste, parimi i mundësive të barabarta mund të çojë në kufizim të shpenzimeve për partitë politike, veçanërisht për sa i përket reklamave.”

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	shumica e transmetuesve nuk i përmbushën apo i përmbushën pjesërisht detyrimet për t'i dhënë KPM informacione të hollësishme mbi sasinë e përmbajtjes me pagesë të emetuar dhe listën e çmimeve, duke minuar transparencën e gjithëmbarshme të procesit. Faqe 34	qasje në kohën e tillë, shpalosje publike të listave të çmimeve, si dhe vendosje të kufirit në sasinë e kohës së emetimit që transmetuesi mund t'ia shesë secilit subjekt politik gjatë fushatës zgjedhore.			Këshilli i Evropës, Rekomandimi për Masat lidhur me Mbulimin Mediatik të Fushatave Zgjedhore Masat lidhur me mediat e transmetuara, para. 5 “Në Shtetet Anëtare, ku partive politike dhe kandidatëve u lejohet të blejnë hapësirë reklamimi për qëllime zgjedhore, kornizat rregullatore do të duhej të sigurojnë që të gjitha palët garuese kanë mundësinë e blerjes së hapësirës reklamuese sipas kushteve të barabarta dhe tarifave të njëjta të pagesës. Shtetet Anëtare mund të konsiderojnë futjen e një dispozite në kornizat e tyre rregullatore për të kufizuar hapësirën e reklamimit politik dhe kohën që mund ta blejë partia ose kandidati i caktuar.”
21	Gjatë fushatës zgjedhore, mediat e transmetuara në mënyrë të përsëritur shkelën LZP dhe aktet nënligjore për mediat. KPM nuk ka sanksionuar ose korrigjuar asnjë shkelje gjatë fushatës zgjedhore, duke pretenduar se e ka për detyrim të kryejë procedura të gjata të brendshme që nuk e lejojnë të reagojë me kohë. Faqe 32	Të rishikohet procesi i vendimmarrjes në KPM në mënyrë që të adresojë shkeljet dhe ankesat me kohë, veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore, dhe të zbatojë sanksione dekurajuese.	D - Rregullat dhe procedurat e brendshme të KPM LP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	KPM Kuvendi i Kosovës	SUNDIMI I LIGJIT Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB për të Drejtat e Njeriut 19/36, 2012, para. 16 [Këshilli i të Drejtave të Njeriut] “u bën thirrje Shteteve të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të promovuar demokracinë...” VC CGP para. 2.3 “Barazia e mundësive duhet të garantohet si për partitë ashtu dhe për kandidatët...”
22	Anëtarët e Bordit të RTK-së zgjedhen me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi i Kosovës, gjë që mund të çojë	Të merret në konsideratë forcimi i pavarësisë së transmetuesit publik nga ndërhyrjet e mundshme	LP – Ligji për RTK	Kuvendi i Kosovës	LIRIA E MENDIMIT DHE E SHPREHJES ICCPR, neni 19, HRC GC 25 para 16. «Shtetet Palë do të duhej të sigurojnë që shërbimet e transmetimit publik funksionojnë në mënyrë të pavarur. Veprimet

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	në një bord të emëruar nga shumica në pushtet në Kuvend, bashkëbiseduesit gjithashtu shprehën shqetësime lidhur me procesin e përgjithshëm të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit. Përveç kësaj, transmetuesi publik kryesisht mbështetet në buxhetin që ndahet nga Kuvendi, gjë që pengon më tej pavarësinë e tij të plotë. shpërbërja. Faqe 29	politike, duke rishikuar procesin e përzgjedhjes së bordit të tij, si dhe sistemin e tij të financimit.			<i>për të siguruar pavarësinë mund të përfshijnë përcaktimin e mandatit të këtyre transmetuesve me ligj dhe dhënien e garancive legislative për pavarësi dhe liri editoriale, si dhe dhënien e fondeve në një mënyrë që nuk e cenon pavarësinë.”</i>
23	KPM kreu monitorim të plotë të veprimeve të mediave vetëm gjatë fushatës zyrtare zgjedhore dhjetëditore. Sidoqoftë, organi rregullativ është gjithashtu përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore që u kërkojnë transmetuesve të ofrojnë mbulim korrekt dhe të ekuilibruar editorial në çdo kohë dhe që ua ndalojnë transmetimin e përmbajtjes politike me pagesë jashtë fushatës zgjedhore. Mungesa e mbikëqyrjes efektive nga	KPM të forcojë mbikëqyrjen e akteve nënligjore ekzistuese për mediat për të siguruar që transmetuesit ofrojnë mbulim të ekuilibruar dhe nuk transmetojnë përmbajtje politike me pagesë jashtë periudhës së fushatës zgjedhore.	Të përforcohet monitorimi i mediave nga KPM jashtë periudhës së fushatës zgjedhore për të mbikëqyrur pajtueshmërinë e mediave me aktet nënligjore të KPM, siç janë Kodi i Etikës dhe aktet nënligjore të komunikimit	KPM	LIRIA E SHPREHJES, TRANSPARENCA DHE QASJA NË INFORMACION ICCPR, neni 19, HRC GC 25 para 11 <i>“... për të garantuar të drejtën e lirisë së shprehjes, përfshirë të drejtën për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacione dhe ide... Kjo e drejtë përfshin diskursin politik, komentimin e çështjeve vetanake dhe publike...”</i> VC CGP para. 2.3 <i>“Barazia e mundësive duhet të garantohet si për partitë ashtu dhe për kandidatët...”</i>

NR.	KONTEKSTI (përfshirë referencën për faqen përkatëse në RP)	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI QË DUHET NË KORNIZË LIGJORE: ¹⁷²	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS RELEVANT	PARIMI - ZOTIMI – LEGJISLACIONI KOMBËTAR RELEVANT NDËRKOMBËTAR - RAJONAL (përfshirë tekstin e dokumentit përkatës të cituar)
	KPM për veprimet e mediave para fillimit të fushatës zgjedhore minoi masat mbrojtëse në kuptim të parimit të fushë-lojës së barabartë përpara zgjedhjeve. Faqe 32		audio-vizual komercial.		



Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian Kosovë* 2019

Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare – 6 tetor 2019

SHTOJCAT I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË CERTIFIKUARA

Votues të regjistruar	1,937,868
Numri i votuesve që kanë votuar në vendvotime	826,916
Fletëvotime me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta	26,825
Fletëvotime të votimit jashtë Kosovës	20,191
Pjesëmarrja (%)	44.56%
Fletëvotime të vlefshme	841,275
Fletëvotime të pavlefshme	20,897
Fletëvotime të zbrazëta	12,374
Fletëvotime të përdorura	873,997
Fletëvotime të papërdorura	853,257
Fletëvotime të dëmtuara	1,599

Subjekti politik	Vota	% e votave	Ulëse	% e ulëseve
Lëvizja Vetëvendosje	221,001	26.270%	29	24.166%
Lidhja Demokratike e Kosovës	206,516	24.548%	28	23.333%
Partia Demokratike e Kosovës	178,637	21.234%	24	20%
AAK - PSD Koalicioni 100% Kosovë	96,872	11.515%	13	10.833%
Srpska Lista	53,861	6.402%	10	8.333%
Nisma Socialdemokrate - Aleanca Kosova e Re - Partia e Drejtësisë	42,083	5.002%	6	5.002%
Koaliciaja Vakut	7,075	0.841%	2	1.666%
Kosova Demokratik Türk Partisi	6,788	0.807%	2	1.666%
Partia Liberale Egjiptiane	4,887	0.581%	1	0.833%
Nova Demokratska Stranka	3,935	0.468%	1	0.833%
Partia e Ashkalinjëve për Integrim	3,113	0.370%	1	0.833%
Fjala	2,852	0.339%	-	-
Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës	1,963	0.233%	-	-
Samostalna Liberalna Stranka	1,859	0.221%	-	-
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës	1,755	0.209%	1	0.833%
Partia Euroatlantike e Kosovës	1,173	0.139%	-	-
Jedinstvena Goranska Partija	1,159	0.138%	1	0.833%
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës	1,078	0.128%	1	0.833%

*Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe mendimin e GJND për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Stranka Demokratske Akcije	834	0.099%	-	-
Partija Kosovskih Srba	816	0.097%	-	-
Građanska Inicijativa Gore	785	0.093%	-	-
Pokret za Gora	695	0.083%	-	-
Sloboda	672	0.080%	-	-
Esmir Kasi	577	0.069%	-	-
Kosovaki Nevi Romani Partia	289	0.034%	-	-

SHTOJCAT II: SHKURTESAT

Emri i plotë	Shkurtesa
Agjencia e Regjistrimit Civil	ARC
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;	UDHR
Formulari i Përputhjes së Rezultateve	FPR
Formulari i Rezultateve të Kandidatëve	FRK
Këshilli i Vendvotimit	KVV
Komisioni i Pavarur për Media	KPM
Komisioni Komunal i Zgjedhjeve	KKZ
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	KQZ
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollat e saj;	ECHR
Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave	CEDAW
Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara	CRPD
Korporata Energjetike e Kosovës	KEK
Kryeministri	KM
Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008	Kushtetuta
Ligji nr. 03L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme i vitit 2008, i ndryshuar në 2010	LZP
Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	LZP
Lista e Votuesve	LV
Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë	UNMIK
Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollat e tij;	ICCPR
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	PZAP
Personat me aftësi të kufizuara	PAK
Personat me nevoja dhe rrethana të veçanta	PNRRV
Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve	QNR
Votimi Jashtë Kosovës	VjK

Emri i plotë - origjinal	Emri i plotë - në gjuhën angleze	Shkurtesa
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	Alliance for the Future of Kosovo	AAK
Aleanca Kosova e Re	New Kosovo Alliance	AKR
Partia Fjala	“The Word” Party	Fjala
Građanska Inicijative Gore	Citizens’ Initiative of Gora	GIG
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës	New Democratic Initiative of Kosovo	IRDK
Jedinstvena Goranska Partija	United Gorani Party	JGP
Kosova Demokratik Türk Partisi	Turkish Democratic Party of Kosovo	KDTP
Kosovaki Nevi Romani Partia	The Kosovar New Romani Party	KNRP
Lidhja Demokratike e Kosovës	Democratic League of Kosovo	LDK
Nova Demokratska Stranka	New Democratic Party	NDS
Nisma Socialdemokrate	Social Democratic Initiative	Nisma
Partia e Ashkalinjve për Integrim	Ashkali Party for Integration	PAI
Partia e Drejtësisë	Justice Party	PD

Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës	Democratic Ashkali Party of Kosovo	PDAK
Partia Demokratike e Kosovës	Democratic Party of Kosovo	PDK
Partia Euroatlantike e Kosovës	Euro-Atlantic Party of Kosovo	PEK
Pokret za Gora	Movement for Gora	PG
Partija Kosovskih Srba	Kosovo Serb Party	PKS
Partia Liberale Egjiptiane	Egyptian Liberal Party	PLE
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës	United Roma Party of Kosovo	PRBK
Partia Socialdemokrate	Social Democratic Party	PSD
Stranka Demokratske Akcije	Party of the Democratic Action	SDA
Koalicija "Sloboda"	"Freedom" Coalition	Sloboda
Samostalna Liberalna Stranka	Independent Liberal Party	SLS
Koalicija Vakati	The Coalition Vakati	Vakati
Lëvizja Vetëvendosje	Self-determination Movement	VV (aka LVV)

PAN – koalicioni parazgjedhor i përbërë nga PDK, AAK dhe Nisma i cili doli i pari në zgjedhjet parlamentare 2017

SHTOJCAT III: MONITORIMI I MEDIAVE

REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE NGA EU EOM Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, Kosovë 2019

HYRJE

EU EOM bëri monitorim sasior dhe cilësor të mediave me një mostër të mediave të transmetuara gjatë fushatës zgjedhore dhjetëditore për zgjedhjet e 6 tetorit (25 shtator - 4 tetor 2019).

Mediat e audio-vizive u monitoruan nga ora 17:00 deri në 01:00 çdo ditë, dhe mostra e përzgjedhur përbëhej nga kanalet e mëposhtme televizive:

- ✓ **RTK1**, kanal televiziv publik (në gjuhën shqipe)
- ✓ **RTK2**, kanal televiziv publik (në gjuhën serbe dhe gjuhët e komuniteteve jo-shumicë)
- ✓ **KTV**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **RTV21**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **KLAN KOSOVA**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **T7**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)


Gjithashtu, monitorimi i mediave përfshiu edhe edicionet kryesore të lajmeve të përditshme në dy kanale televizive lokale që transmetojnë në gjuhën serbe, **TV MOST** dhe **TV PULS**.

Në monitorimin cilësor nga EU EOM u përfshi “toni” i përdorur nga transmetuesit për të mbuluar subjektet institucionale dhe politike, por meqë “toni” ishte kryesisht neutral, rezultatet statistikore nuk janë përfshirë në këtë përmbledhje. Sidoqoftë, duhet të theksohet se pati përjashtim në rastin e TV MOST dhe TV PULS, kanale televizive lokale në gjuhën serbe, të cilat shfaqën mbulim mjaft pozitiv për Srpska Lista dhe mbulim negativ për partitë e opozitës serbe: Sloboda, PKS dhe SLS. Përveç kësaj, disa kanale televizive në gjuhën shqipe, pavarësisht se ishin neutrale në raportimin e tyre të lajmeve, herë pas here shfaqën përmbajtje lajmesh dhe konteksti që lidhej me subjektet politike duke hapur kështu udhën për shqetësim se nuk ishte zgjedhur bazuar në vlerën e lajmit, por për të përçuar mbulim pozitiv ose negativ të subjektit politik.

EU EOM gjithashtu bëri monitorimin e të njëjtave media audio-vizive gjatë dhjetë ditëve para fillimit të fushatës zgjedhore (15 - 24 shtator 2019) duke u përqendruar në mbulimin e lajmeve, si dhe në vërejtjen e shkeljeve të mundshme të ndalimit të transmetimit të reklamave politike ose programeve me pagesë nga subjektet politike jashtë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore.

Tutje, u bë gjithashtu monitorimi kualitativ i një mostre të mediave online të lajmeve dhe mediave sociale (faqet në Facebook). Në faqet në vijim, jepet përmbledhja e rezultateve për monitorimin sasior të mediave të transmetuara.

MBULIMI POLITIK DHE I ZGJEDHJEVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE





173

	RTK1	RTK2	TV21	KTV	KLAN KOSOVA	T7
LAJME	17%	32%	17%	4%	8%	7%
DEBATE ZGJEDHORE/ EMISIONE DISKUTIMI	52%	42%	38%	33%	5%	47%
REKLAMIM ME PAGESË	5%	0	14%	9%	6%	9%
PROGRAME TË SPONSORIZUARA	18%	0	28%	52%	36%	37%
INFORMIM PËR VOTUESIT	8%	15%	3%	2%	0	0
KOHË EMETIMI FALAS	0	11%	0	0	0	0


	Totali i mbulimit politik dhe të zgjedhjeve
RTK1	51 orë, 45 minuta dhe 5 sekonda
RTK2	7 orë, 44 minuta dhe 5 sekonda
TV21	36 orë, 19 minuta dhe 7 sekonda
KTV	40 orë, 51 minuta dhe 18 sekonda
KLAN KOSOVA	58 orë, 49 minuta dhe 45 sekonda
T7	55 orë, 49 minuta dhe 26 sekonda

¹⁷³ Reklamim politik: pikat reklamuese politike nuk janë më të gjata se 120 sekonda, siç përcaktohet nga LZP. Me “Programe politike me pagesë”, ne i referohemi çdo forme tjetër të përmbajtjes së paguar nga subjektet politike dhe të transmetuar nga transmetuesit. Për shembull, mbulimi i drejtpërdrejtë i ngjarjeve të fushatës ose videove promovuese të prodhuara nga subjektet politike. Me “Kohë emetimi falas” i referohemi blloqeve kohore të ofruara për subjektet politike dhe të cilat nuk janë nën kontrollin editorial të transmetuesit.

REKLAMAT POLITIKE DHE PROGRAMET POLITIKE ME PAGESË GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE





**MBULIMI ME LAJME NË KANALIN TV PUBLIK KOMBËTAR
PARA DHE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE**





174

¹⁷⁴ Me “Mbulimi me lajme” i referohemi kohës totale të dedikuar nga transmetuesit për subjektin institucional ose politik, përfshirë fjalën e drejtpërdrejtë.


MBULIMI ME LAJME NË KANALET TV PRIVATE KOMBËTARE PARA DHE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE



MBULIMI ME LAJME NGA KANALET TV PRIVATE KABLLOVIKE PARA DHE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE



MBULIMI ME LAJME NGA KANALET TV PËR KOMUNITETET JOSHUMICË GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE



MBULIMI TV I KANDIDATËVE SIPAS GJINISË GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

